

Shkurt 2019
Numri: 131
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Kandili *i* Zemrës





revistaetika



progresibotime

TË
RËNJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*



“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten...” (Enfal, 2)

Rëndësi të veçantë ka edhe përmendja e Esmau'l-Husnasë, pra Emrave të Bukur të Tij si: Rrahman/i Mëshirshëm, Rrahim/Mëshirëbërës, Latif/i Butë, Aziz/i Plotfuqishëm, Kerim/Bujar... Allahu Teala nuk ka nevojë për asgjë, ndërkohë që çdo gjë ka nevojë për Allahun (xh.xh.). Në gjendje të tilla sinqeriteti, gjuha dhe zemra takohen në një harmoni sublime.

Ne zhytemi në detin e mëshirës sa herë që themi “Allah, Allah”... Pastaj, arrijmë te pragu i takimit me Zotin (xh.xh.). Sa herë që zemra jonë thotë “Allah”, ne zhvishemi nga bota materiale dhe e kuptojmë më mirë dobësinë dhe nevojën tonë të përhershme për Krijuesin e gjithësisë.

Përmendja e Zotit (xh.sh.), është një ndjenjë që duhet të jetë e vazhdueshme në zemrën tonë. Ashtu siç rrotullohen pa pushim Toka, gjithësia dhe çdo gjë që gjendet në këtë botë, që nga grimcat e deri te yjet madhështore, ashtu edhe zemra duhet të ketë në qendër të saj përmendjen e Allahut.

Çdo krijesë e përmend Allahun sipas natyrës së saj. Përmendja e Zotit (xh.xh.), është harmonia e gjithësisë. Çdo krijesë që e formon këtë harmoni, merr pjesë me zërin e saj në përmendjen e Allahut. Deti e bën dhikrin me zërin e dallgëve. Pemët e bëjnë dhikrin me fëshfëritjen e gjethëve. Erërat e bëjnë dhikrin me fërshëllimën e tyre. Malet dhe gurët e bëjnë dhikrin me gjuhën e heshtjes. Pra, çdo gjë e përmend Allahun e Madhëruar.

Në këtë mënyrë bota jonë shpirtërore përfshihet nga mëshira dhe bu-tësia. Atëherë shpirti ynë fluturon nga një luginë në tjetrën. Me ndjenjat sublime që na kaplojnë, kalojmë kodrat dhe malet. Sa më shumë që zemra jonë të thotë “Allah”, aq më fort toka e qiejt e shoqërojnë ritmin e dhikrit tonë.

Allahu (xh.xh.), na fton ta përmendim, ta pohojmë dhe ta madhërojmë Qenien e Tij. Ai thekson se dhikri më i madh është Kurani Fisnik. Përveç të tjerash, thotë se zemrat tona mund të gjejnë prehje shpirtërore vetëm me dhikër. Pastaj na urdhëron ta përkujtojmë, në mënyrë që edhe Ai të na kujtojë.

Çdo gjë e lavdëron Atë, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Për këtë arsye, çdo fjalë e Kuranit Fisnik është dhikër. Namazi është dhikër. Haxhi është dhikër. Xhahadi është dhikër. Të jetuarit pa e harruar Atë, qoftë edhe për një çast, dhe pa rënë në shkujdesje ndaj Tij, është dhikër.

Zemra jonë për çdo rrahje të saj duhet të thotë “Allah”, në mënyrë që të arrijmë ta lexojmë Librin e Gjithësisë dhe ta zhvillojmë botën tonë shpirtërore. Emri fisnik “Allah” duhet të jetë ngjyra, shpirti, kënaqësia dhe çdo gjë e jona...

Shkurt 2019

VITI: XIII
NUMRI: 131

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



10

Kandili i zemrës
Salih Zeki Meriç



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



14

20

Ebu Hejtheme El Ensari
Mustafa Erish



- 5 E lehta, e vështira
Mehmet Dinç
- 6 Dobësimi i personalitetit
Dr. Adem Ergyl
- 8 Të ringjallemi me Islamit
Ali Riza Temel
- 14 Meditimi
Dr. M. Kazim Kara
- 16 Përmendja e mirësive të Allahut (xh.xh.)
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 18 Çfarë do të thotë "mbrojini nga zjarri"?
Xhafer Durmush
- 22 Kur humbësit kthehen fitimtarë
Nuredin Nazarko
- 24 Të ekzistosh apo të jetosh?
Edison Çeraj
- 25 5 Këshilla
Ferudun Ozdemir



40

- Ajaz Pasha, kryeveziri i palodhur
që vdiq nga murtaja
Dr. Ardian Muhaj
- Historia e pikës së ujit
Urtësi
- Një Ajet-Një Hadith
32

El-Latif
Ilir Hoxha

Muhamedi (a.s.), i lartësuar në Kuran
Imam Muhamed B. Sytari

Duajeni Profetin
Ferit Piku

Shembuj të moralit të lartë
Fatma Nur Xhihan

28

Umeti më i mirë
Doç. dr. Harun Emysh



Në Islam nuk ka rracizëm
Ibrahim Shakir

46



E LEHTA E VËSHTIRA

— Mehmet Dinç —

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë të fitojë pëlqimin e prindërve, t'i kënaqë ata, të përpiqet të bëjë çdo gjë që t'ua rifitojë zemrat nëse ua ka thyer në ndonjë mënyrë, t'ua plotësojë edhe kërkesat që i duken të pakuptimta dhe t'i durojë fjalët, qortimet dhe kritikën e thëna në momente zemërimi. Zgjidhja e lehtë është që njeriu ta vazhdojë jetën ditore, pa u shqetësuar aspak për ta, por kjo ka pasojë vështirësinë e ditëve të ardhshme kur njeriu t'i kujtojë ditët e festave që ka pas përjetuar në të kaluarën, dhe të thotë: “Ah sikur prindërit të ishin gjallë dhe të qëndroja pranë tyre pa u zemëruar aspak, edhe pse mund të thoshin ndonjë fjalë të rëndë!”

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të formojë me bashkëshorten një marrëdhënie të mbështetur të dashurisë, respektit dhe sakrificës. Gjithashtu, nuk e ka aspak të lehtë ruajtjen e këtyre vlerave, pa ia lëkundur themelin. Zgjidhja e lehtë është që të lësh në një qoshe mendjen e durimin, dhe të shkosh në drejtimin në të cilin të zvarrisin dëshirat vetjake. Ndërsa vështirësia vjen kur nuk ngopet dot zemra, kur detyrimisht ha ndonjë gjë krejt pa oreks në ndonjë lokal modest, në mbrëmjen e një dite të ftohtë.

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të gjejë kohë për fëmijët, të përpiqet t'i kuptojë ata dhe të mundohet të gjejë pika të përbashkëta, në mënyrë që të ndajë

me ta disa gjëra. Zgjidhja e lehtë është t'i lësh fëmijët në botën e tyre dhe të vazhdojë jetën në botën tënde, ndërsa e vështira është që të përpiqesh për fëmijët, në mënyrë që të ndjesh ngrohtësinë kur fëmija të përqafohet dhe të thotë me gjithë zemër: “Babi!”

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të jetë i informuar për hallet dhe gjendjen e miqve apo shokëve të tij, në mënyrë që të përpiqet t'ua lehtësojë hallet atyre, të mundohet t'ua plotësojë nevojat dhe të bëjë sakrificë materiale e fizike për ta, kur të jetë e nevojshme. Zgjidhja e lehtë është që njeriu t'i formojë marrëdhëniet sipas interesave, të qëndrojë pranë të fortit dhe të gjendet larg të dobët, ndërsa e rëndë është që njeriu të mos ketë askënd që mund ta vizitojë kur të bjerë i sëmurë në spital.

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të përpiqet përgjatë gjithë jetës që t'i kënaqë njerëzit, të mundohet të bëjë mirë me të gjitha mundësitë, të mos bëjë keq nëse nuk mund të bëjë mirë, dhe të shfaqë ndjeshmërinë e kujdesin më të madh në marrëdhëniet me nënën, babanë, bashkëshorten, fëmijët, miqtë dhe të afërmit. Zgjidhja e lehtë është që njeriu ta vendosë veten në qendër dhe të formojë marrëdhënie me njerëzit vetëm për nevojën e tij, ndërsa e rënda është që njeriu të mos ketë askënd që ta përcjellë dhe të derdhë lot pas tij, kur të shkojë në Botën tjetër.



DOBËSIMI I PERSONALITETIT

— Dr. Adem Ergyl —

Në periudhën e kalifatit të Ebu Bekrit (r.a.), një grup njerëzish nga Jemeni shkuan në Medinetu'l-Munevvera. Kur dëgjuan leximin e Kuranit Fisnik në Mesxhidu'n-Nebevi, ata filluan të qanin. Kalifi i të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekri (r.a.), pasi vërejti situatën, tha: “Edhe ne dikur kështu reagonim. Pastaj zemrat na u ashpërsuan...”¹

Ai me këto fjalë shprehte keqardhjen për ndjesinë e pakësimit të ndjeshmërisë në zemrën e tij dhe njëkohësisht nënkuptonte këtë ajet fisnik:

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur.” (Hadid, 16)

Pakësimi i emocionit apo ngrirja e ndjeshmërisë shpirtërore, ndaj të vërtetave të fesë me kalimin e kohës, në ajetin fisnik tregohet si shenjë e një rreziku të madh. Ajeti u kujton besimtarëve se një çast e më parë duhet të marrin masa serioze, nëse ky rrezik bëhet evident.

Kjo ndjeshmëri ishte e lartë te brezi i sahabëve, të cilët mund t'i quajmë prijësit e ummetit Islam. Gjendja e tyre shpirtërore kishte një nivel që vazhdimisht i bënte ta kontrollonin veten kundrejt kufrit, shirkut dhe hipokrizisë, sepse ata e dinin që njeriu nganjëherë mund të largohet nga rruga e drejtë pa e kuptuar, ndërkohë që veten akoma mund ta konsiderojë prej të mirëve.

Përmes kësaj ngjarje mund të përsiatemi mbi thellësinë e vetëllogaritjes dhe ndjeshmërinë që ata kishin në kontrollin e nefsit:

Një ditë Ebu Bekri (r.a.), u takua me Hanzalanë (r.a.). Pasi u pyet për gjendjen, Hanzala (r.a.), u përgjigj me keqardhje dhe shqetësim të madh:

“Hanzala është bërë hipokrit, o i singertë!”

Ebu Bekri (r.a.), i tha: “Subhanall-llah! Çfarë është kjo fjalë kështu, o Hanzala?”

Ky njeri i ndjeshëm e vazhdoi fjalën e tij:

“Kur gjendemi në kuvendet fetare pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ai na e kujton Xhenetin dhe Xhehemin, dhe ne i përjetojmë aq shumë fjalët e tij, a thua se jemi duke i parë me sytë tanë ngjarjet. Kur largohemi nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe fillojmë të merremi me obligimet e jetës sonë të përditshme dhe me hallet e

1. Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq. 82.

fëmijëve dhe familjes, harrojmë shumë nga ato që kemi dëgjuar. (Domethënë, tashmë po e humbasim frymëzimin dhe përsëritjen që marrim në kuvendet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).”

Ebu Bekri (r.a.) pohoi: “Për Zotin, edhe ne kemi të njëjtën gjendje!”

Pas kësaj bisede të shkurtër, të dy bashkë shkuan tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, dhe i rrëfyan për përjetimet e tyre. Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), u tha këtyre dy njerëzve të mrekullueshëm:

“*Betohem tek Allahu, i Cili më ka në dorë jetën, se në qoftë se ju do të ruanit vazhdimisht gjendjen shpirtërore që përjetoni kur gjendeni pranë meje, do të ishit përherë duke bërë dhikrin e Zotit dhe do t’u kishin rrokur melekët si kur të gjendeshit në shtrat, ashtu edhe kur të ecnit rrugës!*” (Pastaj, duke e përsëritur tri herë, tha):

“*O Hanzala! Zemra e njeriut nuk është dy herë njëlloj!*” (Muslim, Tevbe, 12.)

Edhe pse njeriu e ka të pamundur mbajtjen e një gjendjeje konstante kundrejt baticave dhe zbatimit të jetës, e rëndësishme është që t’i kuptojë momentet e rënies. Kur njeriu ndjehet i kënaqur me pjekurinë që ka në nënshtrimin dhe adhurimin ndaj Zotit (xh. xh.), duhet të tregojë kujdes sepse mundet që kjo gjendje të jetë shenjë e pëlqimit të vetes, e prapambetjes në përparim e përmirësim shpirtëror, dhe madje e ngrirjes spirituale.

Kontrolli i vazhdueshëm i zemrës, veprave, moralit, qëndrimeve dhe sjelljeve tona, nën dritën e rregullave hyjnore e profetike, në të vërtetë është shenjë e zgjuarsisë, gjallërisë shpirtërore dhe përpjekjes së madhe në këtë drejtim. Qëndrimi larg një kontrolli dhe vetëllogarë të tillë, është shenjë e shkujdesjes, mëkatit dhe mungesës së përpjekjes në fe.

Nëse një besimtar përjeton rënie deri në pikën sa të nënvlerësojë namazin për shkak të preokupimeve të kësaj bote, ndërkohë që më parë ka pasur ndjenjën e frikë-respektit dhe prehjes në namaz; nëse ka arritur deri në atë gjendje sa që të mos falë namaze nafie krahas namazeve farz; nëse bëhet fjalë për humbjen e marrjes së kënaqësisë nga adhurimi; nëse ky besimtar është dobësuar në çështjen e ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit; nëse rregullat islame në lidhje me ngrënien, pirjen dhe veprat ka filluar t’i anashkalojë; nëse i janë ngrirë ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë; nëse ka arritur deri në atë gjendje shpirtërore sa që të mendojë vetëm për veten e tij; nëse kanë filluar t’i pakësohen shqetësimet në lidhje me përgatitjen për Ahiretin dhe sikundër kësaj nëse preokupimet dhe punët e dynjasë kanë filluar të jenë çështja kryesore e tij; nëse kanë filluar t’i shfaqen shenjat e lodhjes, ftohjes, largimit dhe madje indiferentizmit kundrejt sakrificave dhe shërbimeve që bëhen për hir të Allahut Teala; nëse ndjen rënie në emocionin dhe përpjekjen për të arritur pjekurinë

që meriton miqësinë e Allahut (xh.xh.), përgjatë procesit të përparimit në besim; pra nëse shfaqen këto dobësi dhe gjendje të tjera të ngjashme, do të thotë se rreziku i ashpërsimit të zemrës, në të cilin Zoti (xh.sh.), nuk dëshiron të biem, ka arritur në dimensione serioze. Nëse nuk merren masa, bota shpirtërore do të shndërrohet në errësirë dhe jeta e përhershme do të rezultojë pashmangshmërisht me humbje.

Duhet domosdoshmërisht që herë pas here ta peshojmë personalitetin tonë në peshoren e vlerave hyjnore dhe profetike, në mënyrë që të mos biem në gjendjen për të cilën një poet thotë: “Sa më shumë që të poshtërohen, pandehin se po lartësohen.”

Nëse në fund të këtij peshimi dhe vlerësimi, rezultati është i mirë, duhet ta falënderojmë dhe lavdërojmë Allahun e Lartësuar. Por nëse rezultati është dobësi dhe sëmundje, duhet t’i drejtohem pendimit dhe kërkimit të faljes kundrejt Zotit (xh.sh.).

Diagnostifikimi i hershëm është i rëndësishëm edhe për sëmundjet shpirtërore, si për çdo sëmundje tjetër. Pasi sëmundja të thellohet dhe ta kaplojë të gjithë njeriun, kthimi pas në normalitet nuk është i lehtë. Prandaj, kontrolli i gjendjes shpirtërore për çdo vit, për çdo muaj, madje edhe për çdo ditë, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shëndetin e pjekurisë shpirtërore.

Është detyrë e natyrshme e zemrës së një besimtari korrekt, matja dhe vlerësimi në peshoren e Kuranit Fisnik dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i çdo gjëje që sytë shikojnë, që veshët dëgjojnë, që gjuha thot, që gjymtyrët bëjnë, dhe i botës së ndjenjave të zemrës.

Shpesh herë njeriu nuk e mat dhe kontrollon dot veten. Siç është i rëndësishëm diagnostifikimi dhe mjekimi nga mjekët specialistë për sëmundjet fizike, qartazi duket edhe nevoja që ka njeriu për miq të sinqertë dhe mjekë shpirtërorë, domethënë, për dijetarë dhe njerëz të urtë, që mund t’ia zbulojnë dhe mjekojnë dobësitë e personalitetit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “*Besimtari është pasqyrë e besimtarit.*”² Ky hadith fisnik tregon se besimtarët kanë përgjegjësi për delirjen dhe drejtimin e njëritjetrit në mirësi.

Përfundimisht mund të themi: Kontrolli i herëpashershëm i gjendjes së besimit, ndërkohë që vazhdon udhëtimi i jetës, mbart një rëndësi jetike, në mënyrë që të mos devijojmë nga pikësynimi dhe të përparojmë të qetë në këtë udhëtim. Kjo gotë uji e mbushur me pikat e jetës, duhet të mbetet e pastër dhe e delirë. Prandaj, duhet të shfaqim kujdes, përpikëri dhe ndjeshmëri të madhe, në mënyrë që ajo të mbetet e tillë.

2. EbuDavud, Edeb, 49.

TË RINGJALLEMI me Islamin

— Ali Riza Temel —

Besimi është jetë. Islami është një thirrje për ringjallërim, së cilës Allahu i Lartësuar urdhëron që t'i përgjigjemi: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!..”** (Enfal, 24)

Ne jetojmë me frymën e Islamit. Të mos marrësh frymë, do të thotë të vdesësh. Shpallja hyjnore është frymë dhe jetë. Kjo frymë, që është fryrë nëpërmjet të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i dha jetë të gjithë botës dhe mundësoi lindjen e një civilizimi të mbështetur tek mirësitë dhe vlerat e vërteta humane.

Termi “jetë”, që cilësohet në ajetin fisnik të mësipërm, nënkupton një stil jetese që e kthen qenien njerëzore në njeri, që e lartëson atë në gradën e mëkëmbesit të Allahut (xh.xh.), dhe që e bën krijesën më sublime. Pra, në këtë ajet nuk flitet për jetën biologjike, e cila është gjendja fiziologjike e të gjitha gjallesave. Gjithsesi nuk duhet anashkuar fakti se të jetuarit në përputhje me thirrjen hyjnore është e dobishme dhe e nevojshme edhe nga aspekti biologjik, sepse largimi nga gjërat që Islami ka ndaluar, është domosdoshmëri për shëndetin e mendjes, shpirtit dhe trupit.

Zbatimi i Islamit është pranverë, ndërsa refuzimi është dimër. Bahçja islame në pranverë i mundëson të gjithë njerëzimit lule të shumëllojshme, ngjyra marramendëse, erëra magjepsëse dhe tablo të pasqoqë e të mrekullueshme. Por kur rojet e kësaj bahçeje zhyten në gjumë, ajo sulmohet dhe plaçkitet nga kopetë e derrave, ujqërve, hienave, dhelprave, çakejve dhe sorrave. Pavarësisht shkatërrimit dhe plaçkitjes, toka e kësaj bahçeje ka aftësinë për të çelur lule dhe për të dhënë fruta, përsëri. Kjo bahçe e shndërruar në shkretëtirë prej erërave helmuese që fryjnë nga perëndimi, mund të shpërthejë përsëri dhe të arrijë madhësinë që ka pasur në të kaluarën, me diellin e qiellit dhe shirat e reve të saj.

Kjo bahçe që gjallërohet me shirat e Shpalljes Hyjnore dhe diellin e besimit, edhe më parë ka qenë e shkretë dhe jopjellore. Ky fllad i këndshëm që fryu mbi rërat përvëluese të gadishullit Arabik dhe shkretëtirat në të cilat nuk mbinte as bari, i

shndërroi ato në kopshte të pasqoqë. Kjo frymë që iu dha beduinëve dhe skllëvërve agresorë që jetonin në këto shkretëtira, përgjatë një kohe dhjetë- vjeçare, i bëri njerëz shembullorë dhe personalitete model në këtë botë. Kjo frymë mundësoi që disa fise të dobëta e të varfra, të mposhtnin dy perandoritë më të mëdha të asaj periudhe, që ishin perandoria Bizantine dhe perandoria Perse. Kjo frymë bëri që këto fise t'i shpëtonin masat e gjera të popujve në lindje dhe perëndim, nga padrejtësia e perandorëve, mbretërve, klerikëve zoroastrianë, priftërinjve, feudalëve dhe agallarëve.

Kjo reformë, që u realizua nëpërmjet të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, është reforma më madhështore e historisë. Muhamedi (a.s.), i cili ishte predikuesi dhe zbatuesi i Shpalljes Hyjnore, edukoi burra shumë të mëdhenj. Po të vinin një mijë filozofë në shkretëtirën e Arabisë, nuk do ta edukonin dot një burrë si Omeri (r.a.), sepse është e pamundur të arrihet jeta dhe iluminimi i vërtetë, pa frymën gjallëruese dhe dritën e shpalljes hyjnore që ndriçon zemrat. Burimi i vetëm, që i jep kuptim dhe i vendos synim jetës dhe kësaj bote, është Shpallja Hyjnore, pra, Islami i vërtetë dhe gjithëpërfshirës.

Islami është fe e natyrshmërisë. Ajo që është e përshtatshme me Islamin është një jetë normale dhe e natyrshme. Të jetuarit larg Islamit është shmangie nga rregulli dhe natyrshmëria. Allahu (xh.xh.), thotë në Kuranit Fisnik:

“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monotëiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Rum, 30)

Jeta që bëhet në përputhje me natyrshmërinë, është jetë organike; ndërsa ajo që bëhet në kundërshtim me natyrshmërinë është një jetë artificiale. Ajo që është hyjnore, është e natyrshme. Pikërisht natyrshmëria është ajo që kërkohet dhe për të cilën kemi nevojë.

Të bëhesh mysliman do të thotë të integrohesh

në hierarkinë e gjithësisë dhe t'i dorëzohesh vullnetit hyjnor, sepse përveç njeriut, çdo gjë tjetër vepron në përputhje me sistemin hyjnor me një nënshtrim të plotë. Harmonia dhe sistemi në gjithësi, janë shprehjet më të qenësishme të këtij nënshtrimi. Kusht themelor i ekzistencës është pikërisht ky nënshtrim. Allahu Teala shprehet në ajetin fisnik:

“A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përulën të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!”
(Al ‘Imran, 83.)

Njeriut i është mundësuar vullneti, ngaqë është në sprovë. Ai është lënë i lirë për sa i përket çështjes së besimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.). Ndjekja e sistemit hyjnor dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit, siç veprojnë edhe krijesat e tjera, mundëson përfshirjen në sistem; ndërsa largimi çon në ngeljen jashtë tij. Ky është terrori më i madh që mund të ekzistojë.

Të gjithë të dërguarit e Zotit (xh.xh.), i kanë thirrur dhe ftuar njerëzit te Allahu dhe te rruga e Tij. Edhe thirrja e fundit është e njëjtë: ***“Thuaj (o Muhamed): “Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij (Allahut) i përulemi.”***
(Al ‘Imran, 84.)

Këtë thirrje për ringjallje, pas pejgamberëve e kanë vazhduar ata që kanë ndjekur rrugën e profetëve dhe dijetarët e prijësit që kanë marrë prej moralit të të dërguarve. Thirrja e tyre ngjan me Surin e Israfilin (briri që do t'i fryjë ky engjëll). Këto thirrje duhet të vazhdojnë pareshtur, në mënyrë që gjithmonë të jemi vigjilentë. Thirrësit për tek rruga e Allahut janë udhërrëfyesit dhe dritat e kësaj rruge, ndërsa ata që ftojnë në rrugë të devijuara janë përfaqësuesit e shejtanëve. Rruga e parë të shpie në Xhenet, ndërsa e dyta të shpie në Xhehenem.

Përgjatë gjithë historisë, kanë dalë thirrës dhe heronj që i kanë ftuar njerëzit për rigjallërim. Thirrja e tyre ka vijuar përgjatë gjithë shekujve. Zëri i burrave të mëdhenj si Gazaliu, Mevlana dhe Junusi, jehon nëpër zemra dhe qiej. Edhe në historinë tonë të afërt kanë dalë shumë trima dhe heronj, që kanë flijuar çdo gjë të tyre dhe kanë bërë titur me të gjithë fuqinë që kishin, me qëllim që t'i zgjonin myslimanët që flinin prej narkozës së kolonialistëve. Pra, dolën burra të mëdhenj si Muhamed Ikbali, Mehmet Akif

Ersoji dhe Bediuzzamani, Nexhip Fazëlli dhe shumë burra të mëdhenj si ai, kanë shprehur hallet e umetit, dhe në një lloj mënyre, kanë kryer detyrën e Surit të Israfilin për t'i paralajmëruar dhe zgjuar të tjerët. Në të vërtetë, detyra e paralajmërimit dhe thirrjes është detyrë e çdo myslimani, veçanërisht e çdo intelektualit. Kjo është një përgjegjësi e pashmangshme.

Të jetuarit në një gjendje pasive, duke qëndruar i tërhequr në një qoshe dhe duke mos u interesuar për hallet e njerëzve, të largon nga shoqëria. Ky largim është mëkat. Intelektual është ai njeri që e flijon jetën e tij private për individin, shoqërinë dhe për përpjekjen/luftën mentale.

Thirrja për ringjallje është thirrja për t'i vënë në funksion të gjitha zemrat, ndërgjegjet, mendjet dhe burimet materiale e shpirtërore. Islami është dinamikë. Shehadeti, siç ka thënë edhe Muhamed Ikbali¹, më shumë se një fjalë, është një reformë dhe një pikë fillimi apo nisjeje për ristrukturim. Kurani Fisnik nuk është vëllim, letër, bojë dhe emër. Kurani Famëlartë është jetë, hakikat, mendim, vepër, përgjegjësi dhe xhihad. Puthja e Kuranit Fisnik, mbajtja e Mus’hafit në një vend të lartë, bërja e letrës së tij me shkëlqim, organizimi i garave për leximin e bukur të Kuranit dhe gjëra të tjera të ngjashme me këto, nuk shprehin respektin e vërtetë ndaj Librit të Zotit (xh.xh.). Respekti dhe besnikëria e vërtetë ndaj Kuranit Fisnik, është përsosja e moralit me moralin e tij dhe zbatimi i rregullave të tij që janë burimi i jetës. Ajeti që e kemi përmendur në fillim, shpreh plotësisht këtë që sapo thamë.

Myslimanët, që në ditët e sotme e kanë humbur identitetin dhe personalitetin, duhet t'i përgjigjen Kuranit Fisnik, i cili i fton për ringjallje, dhe duhet t'ia vënë veshin të dashuruarit pas Kuranit.

Ikbali në lidhje me këtë thotë: “Fisnikëria e lindjes dhe perëndimit është në dorën tënde. Merre parasysh shekullin në të cilin jeton, ringjalle shpirtin e Omerit, kaloje shkretëtirën, qytetin e malin, dhe ngrije çadrën në ekzistencën/veten tënde. Mprehe veten si shpatë, pastaj vërja veshin kaderit, madje nënshtroru ndaj kaderit, sepse xhevahiri yt nuk është i keq. Ky i varfër që e ka sfiduar shoqërinë, nuk ka pasur asgjë përveç këtyre dy fjalëve: “La ilahe il-lall-llah, Muhammedun Resulull-llah.”

1. Ikbali ishte burrë i fesë dhe i kësaj bote, i besimit dhe shkencës, i mendjes dhe i ndjenjës, i filozofisë dhe letërsisë, i urtësisë dhe politikës, i Allahut dhe i popullit, i ibadetit dhe xhihadit, i besimit dhe kulturës... Ai ishte burri i të kaluarës dhe të së ardhmes. Ai ishte sulltani i natës dhe luani i ditës.



Kandili i zemrës

— Salih Zeki Meriç —

ALLAHU (XH. XH.), NA FTON T'I BËJMË DHIKËR, TA PËRMENDIM, T'IA PËRKUJTOJMË QENIEN DHE TA POHOJMË MADHËSHTINË E TIJ. AI NËNVIZON SE DHIKRI MË I MADH ËSHTË KURANI FISNIK. PËRVEÇ TË TJERASH, THOTË SE ZEMRAT TONA MUND TË GJEJNË PREHJE SHPIRTËRORE VETËM ME DHIKËR. PASTAJ THEKSON QË NE DUHET TA PËRKUJTOJMË, NË MËNYRË QË EDHE AI TË NA KUJTOJË.

Dhikri/përmendja e Allahut (xh.xh.), është një ndjenjë hyjnore që rrëshqet nga gjuha në zemër, mbështjell krejt njeriun dhe i jep kënaqësi të mëdha që variojnë sipas nivelit të kësaj mbështjelljeje. Dhikri i jep gjallëri zemrës. Përmendja e Zotit e mbush shpirtin me prehje. Dhikri pothuajse e shndërron në bahçe trëndafilash atmosferën tonë shpirtërore. Ai e riparon dhe e zhvillon botën tonë të brendshme, ia rikthen asaj dritën e venitur dhe u jep nur syve tanë që kanë humbur shkëlqimin. Dhikri është si një kandil që qëndron ndezur në zemër. Nëse dëshirojmë t'i hedhim vaj kandilit, duhet ta përmendim vazhdimisht Allahun me gjithë shpirt. Në këtë mënyrë, e ndriçojmë jetën e kësaj bote dhe më pas atë të botës tjetër.

Në sajë të përmendjes së Allahut (xh.sh.), të gjitha gjy-

nahet derdhen prej trupit tonë dhe çdo qelizë e jona pastrohet dhe purifikohet sikur të kishim rilindur.

Sa më shumë që zemra e përmend Allahun, aq më të qarta bëhen ndjenjat tona. Ndërsa gjendja jonë shpirtërore bëhet më sublime. Si rezultat, edhe fjalët tona marrin vërtetë kuptim.

Fjalët e dhikrit janë të pastra si pikat e shiut dhe të shndritshme si kristal, kanë ngjyrë dhe aromë trëndafil. Ato kanë gjallëri, prandaj u japin jetë zemrave të vdekura, që kanë rënë në shkujdesje kundrejt Zotit (xh.xh.). Ekzistojnë dallime të dukshme mes gjendjes së personave që bëjnë dhikër dhe atyre që nuk e bëjnë. Të parët rendin pas kënaqësisë së Zotit, ndërsa të dytët rendin pas dëshirave vetjake. Në gjuhën e atij që bën

dhikër, gjithmonë gjendet emri “Allah”, që është emri kryesor i Esmau’l-Husnasë, pra emri më i lartë. Sa herë që njeriu thotë “Allah”, toka dhe qielli dëshmojnë. Nëse njeriu fillon të përmend Allahun Teala, me kalimin e kohës e shton përmendjen vazhdimisht: në mëngjes, në mbrëmje, në shtëpi, në rrugë dhe kudo tjetër. Në këtë mënyrë ai respekton urdhrin e ajetit fisnik: **“O ju që keni besuar! Përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje.”** (Ahzab, 41) Si rezultat i kësaj vazhdimësie në dhikër, përmendja e Zotit (xh.xh.), bëhet mjaft e vlefshme.

Dhikri që të jep më shumë kënaqësi shpirtërore, është dhikri që bëhet në vende të qeta. Pra, përmendja e Zotit duhet të bëhet veçanërisht në një kohë të caktuar të natës dhe sidomos në kohën e para agimit. Dhikri është mirë që të bëhet me vetëdije dhe së bashku me të devotshmit e të sinqertët. Sa më shumë që zemra e njeriut e përmend Zotin, aq më shumë çelen sytë e saj. Shoqërimin me njerëzit e mirë, të largon nga gjynahet. Syri i ballit shikon anën e jashtme të kësaj bote, ndërsa syri i zemrës shikon anën shpirtërore.

Besimtarët që e përmendin me gjithë shpirt Allahun, Ai i cilëson si njerëz të mençur dhe me potencial të lartë perceptimi: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, të cilët e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës** (duke thënë:) **“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh** (nga çdo e metë)! **Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”** (Al Imran, 191.)

Sa më shumë që zemra e njeriut e përmend Allahun, aq më shumë frikësohet prej Tij. Atë e kap një drithërimë në të cilën gjendet dashuria që ai ndien për Allahun (xh.xh.).

Allahu i Madhëruar i përkufizon besimtarët e vërtetë, përmes këtij ajeti:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten...” (Enfal, 2)

Rëndësi të veçantë ka edhe përmendja e Esmau’l-Husnasë, pra Emrave të Bukur të Tij si: Rrahman/i Mëshirshëm, Rrahim/Mëshirëbërës, Latif/i Butë, Aziz/i Plotfuqishëm, Kerim/Bujar... Allahu Teala

nuk ka nevojë për asgjë, ndërkohë që çdo gjë ka nevojë për Allahun (xh.xh.). Në gjendje të tilla sinqeriteti, gjuha dhe zemra takohen në një harmoni sublime.

Ne zhytemi në detin e mëshirës sa herë që themi “Allah, Allah”... Pastaj, arrijmë te pragu i takimit me Zotin (xh.xh.). Sa herë që zemra jonë thotë “Allah”, ne zhvishemi nga bota materiale dhe e kuptojmë më mirë dobësinë dhe nevojën tonë të përhershme për Krijuesin e gjithësisë.

Përmendja e Zotit (xh.sh.), është një ndjenjë që duhet të jetë e vazhdueshme në zemrën tonë. Ashtu siç rrotullohen pa pushim Toka, gjithësia dhe çdo gjë që gjendet në këtë botë, që nga grimcat e deri te yjet madhështore, ashtu edhe zemra duhet të ketë në qendër të saj përmendjen e Allahut.

Çdo krijesë e përmend Allahun sipas natyrës së saj. Përmendja e Zotit (xh.xh.), është harmonia e gjithësisë. Çdo krijesë që e formon këtë harmoni, merr pjesë me zërin e saj në përmendjen e Allahut. Deti e bën dhikrin me zërin e dallgëve. Pemët e bëjnë dhikrin me fëshfëritjen e gjetheve. Erërat e bëjnë dhikrin me fërshëllimën e tyre. Malet dhe gurët e bëjnë dhikrin me gjuhën e heshtjes. Pra, çdo gjë e përmend Allahun e Madhëruar.

Në këtë mënyrë bota jonë shpirtërore përfshihet nga mëshira dhe butësia. Atëherë shpirti ynë fluturon nga një luginë në tjetrën. Me ndjenjat sublime që na kaplojnë, kalojmë kodrat dhe malet. Sa më shumë që zemra jonë të thotë “Allah”, aq më fort toka e qiejt e shoqërojnë ritmin e dhikrit tonë.

Allahu (xh.xh.), na fton ta përmendim, ta pohojmë dhe ta madhërojmë Qenien e Tij. Ai thekson se dhikri më i madh është Kurani Fisnik. Përveç të tjerash, thotë se zemrat tona mund të gjejnë prehje shpirtërore vetëm me dhikër. Pastaj na urdhëron ta përkujtojmë, në mënyrë që edhe Ai të na kujtojë.

Çdo gjë e lavdëron Atë, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Për këtë arsye, çdo fjalë e Kuranit Fisnik është dhikër. Namazi është dhikër. Haxhi është dhikër. Xhiahadi është dhikër. Të jetuarit pa e harruar Atë, qoftë edhe për një çast, dhe pa rënë në shkujdesje ndaj Tij, është dhikër.

Zemra jonë për çdo rrahje të saj duhet të thotë “Allah”, në mënyrë që të arrijmë ta lexojmë Librin e Gjithësisë dhe ta zhvillojmë botën tonë shpirtërore. Emri fisnik “Allah” duhet të jetë ngjyra, shpirti, kënaqësia dhe çdo gjë e jona...

Ebu Bekrin (r.a.), mund ta shohim si njeriun më të lartë të ummetit tonë dhe më të madhin e sahabëve, të cilët ishin shembulli më i shkëlqyer për njerëzit. Ai e filloi këtë kauzë si i madh dhe e përfundoi si i tillë. Gjithmonë është sjellë si i madh. Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Ai ka qëndruar njëzet e pesë vite si mysliman në këtë botë. Këto njëzet e pesë vite i ka jetuar me madhësi.

Padyshim se nuk ka qenë vetëm ai i tillë. Si ai ka pasur edhe shumë të tjerë të mëdhenj, të cilët janë krenaria jonë. Ata bënë punë të mëdha dhe arritën rezultate të shkëlqyera, arritën kënaqësinë e Allahut Teala, që është fitorja më e madhe. Madhështia u kishte hije atyre, por edhe ata i kishin hije madhësisë. Lum për ata! Lum edhe për ata që përpiqen t'i ndjekin gjurmët e tyre!

Ne mund të vazhdojmë ta marrim për shembull Ebu Bekrin, (r.a.). Atë e kemi të pamundur që ta kalojmë në madhësi dhe në përpjekjen për arritjen e asaj madhësitie. Ai tha: “Jam unë.”, në një kohë kur askush nuk guxonte ta thoshte këtë. Kjo ishte madhështia e tij! Kur ishte e nevojshme pasuria, ai e dha pasurinë e tij pa vënë asnjëherë kufi. Edhe kjo ishte madhështia e tij! Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po kërkonte një burrë për të qarë hallet, Ebu Bekri (r.a.), i qau hallet me të. Në këtë mënyrë, e shfaqti të plotë madhësinë e tij. Kur Pejgamberi (a.s.), pati nevojë për një shok që ta shoqëronte përgjatë rrugës, Ebu Bekri (r.a.), mori rrugën bashkë me të. Kur rruga i çoi te shpella, ai hyri aty i pari. Ebu Bekrit (r.a.), iu vendosën heshtat para syve, por ai nuk bëri asnjë hap prapa, nuk u dorëzua dhe nuk u lodh kurrë. Edhe përgjatë qëndrimit në shpellë, atë e shoqëroi madhështia. Ebu Bekri (r.a.), ishte i madh edhe kur kërkoheshin zemra për t'u dridhur para ajeteve të Kuranit Fisnik. Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Ai e filloi këtë kauzë si i madh dhe jetoi si i madh. Edhe jetën e përfundoi si më i madhi i të mëdhenjve. Ebu



PORTRETI I EBU BEKRIT DHE...


Koha e Madhësisë

— Nuredin Jëlldëz —

Bekri (r.a.), ishte njeriu më i madh i këtij ummeti madhështor, pas të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Cilido segment që mund të merret nga kjo jetë e madhe e tij, përbën një madhësi më vete, dhe tregon cilësinë e të gjithë asaj jete, pikërisht siç tregojnë dy-tri pika gjak gjenden e krejt trupit. Kjo madhësi gjithmonë ka qenë me Ebu Bekrin (r.a.), kur preokupohej me ibadet, kur interesohej për gjendjen e ndonjë vëllai besimtar, kur përkujdesej për familjen e tij, kur luftonte me shpatë në dorë dhe kur printe me asketizmin kundrejt mirësive të kësaj bote. Me lejen e Allahut, Ebu Bekri (r.a.), do të kujtohet si një njeri që e filloi këtë kauzë me madhësi, jetoi me madhësi dhe ndërroi jetë po me madhësi.

Cila ishte madhështia e tij më e madhe ndërmjet të gjitha madhështive, e di vetëm Allahu Teala. Dikush prej nesh mund ta shohë si veprimin më madhështor, atë që shfaqti në shpellë. Ndërsa ndonjë besimtar tjetër mund ta shohë veçorinë e të qenët burri i parë që besoi, si aspektin më të madh të tij. Por edhe bujaria e paarritshme e tij në dhurimin e pasurisë, mund të konsiderohet ndër veprat më të mëdha. Të gjitha këto nuk janë gjë tjetër përveçse bindjet tona. Allahu është Ai që do të gjykojë për këtë. Ne thjesht hamendësojmë dhe formojmë bindje. Veprat e mëdha të Ebu Bekrit (r.a.), që qëndrojnë para nesh si madhështia e tij, mund t'i ndajmë në dy grupe: në vepra që konkretisht kanë të bëjnë vetëm me Ebu Bekrin (r.a.), dhe në vepra që kanë lidhje edhe me ne, edhe pse çdo vepër e këtij sahabi ndikon te ne në ndonjë mënyrë. Për shembull, të qenit



"Mos u
mërzit,
se Allahu
është vërtet
me ne!"
(Teube-40)

e tij burri i parë që besoi, ka të bëjë më shumë me vetë atë. Edhe shoqërimi dhe mbrojtja që i bëri të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në shpellë, ndikon te ne, por gjithsesi ky është një veprim që lidhet direkt vetëm të.

Ebu Bekri, Zoti qoftë i kënaqur me të, ka bërë edhe një punë të madhe dhe tepër të rëndësishme, e cila e ka mbartur Islamit deri në ditët e sotme nga aspekti i shkaqeve të jashtme, me lejen e Allahut (xh.xh.). Ndoshta ai ishte në kohën më të përshtatshme për ta shfaqur këtë madhësi. Prandaj, edhe ai u rrit me punë të mëdha dhe madhësinë e mbarti në pikën kulmore.

Të gjithë e dimë shumë mirë ditën kur i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, u shpërngul për te Zoti i tij. Medina e ndritur dukej sikur ishte mbuluar nga errësirat. Të gjithë i kishte kapluar pikëllimi. Edhe Omeri (r.a.), që ishte prej burrave të mëdhenj, pothuajse ishte dërrmuar i tëri. Allahu qoftë i kënaqur prej tyre! Ata nuk mund ta pranonin fakti që Pejgamberi (a.s.), nuk gjendej më ndërmjet tyre dhe ndjeheshin sikur kishin mbetur të rrethuar ndërmjet qiellit dhe tokës. Medina u shndërrua në një vend kaosi, edhe pse mund të themi se kjo situatë zgjati vetëm për pak kohë. Tashmë ishte momenti më i përshtatshëm për një punë të madhe.

Përsëri në skenën e punëve të mëdha shfaqet Ebu Bekri (r.a.). Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Ai si një burrë që e filloi me madhësi jetën dhe jetoi po me madhësi, shfaqti edhe një madhësi tjetër. Ai tha një fjalë të madhe ndërmjet sahabëve të nderuar, të cilët ishin brezi i Kuranit, por që në ato momente ishin kapluar nga pikëllimi për shkak të humbjes së madhe: "Kushdo që ka adhuruar Muhamedin, le ta dijë se Muhamedi ka vdekur. Ndërsa Allahu është i Gjallë dhe i Përhershëm." Madhështia që duhej shfaqur në ato momente, ishte të shprehurit me zë të lartë të kësaj fjalie. Ebu Bekri (r.a.), këtë bëri. Ai u kujtoi njerëzve një të vërtetë që të gjithë e dinin dhe e besonin. Të gjithë njerëzit i thirrën mendjes. Djallit të mallkuar i iku mundësia për të futur përçarje në vatrën e Islamit. Kjo ishte një madhësi që e rriti edhe ummetin, krahas faktit që i solli njerëzit në vete përgjatë atyre momenteve. Ebu Bekri (r.a.), përdori fjalinë më të

vështirë në kohën më të vështirë. Ai me këtë shprehje pozicionoi çdo gjë në vendin e duhur.

Pastaj puna që bëri për të mos ngelur e zbrazur pozita e liderit, që deri atëherë e pati kryer i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte një madhësi tjetër. Kur që e domosdoshme për të bërë një zgjedhje ndërmjet xhenazes së bekuar të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe zgjedhjes së liderit të ummetit, përsëri shfaqti një madhësi tjetër. Ai i dha përparësi zgjedhjes së liderit të ummetit. Në këtë mënyrë, Ebu Bekri (r.a.), shkatërroi njërin prej kërcënimeve më të mëdha, i cili mund ta shpërbente ummetin. Si rezultat i kësaj madhësie që ai shfaqti atë ditë, ne sot ekzistojmë si ummet.

Reagimi që shfaqti kundrejt atyre që bënë kryengritje kundër shariatit të Allahut, dhe qëndrimi me vendosmëri duke shqiptuar fjalën e tij të famshme që fillon në formën: "Edhe nëse më copëtojnë ujqërit në Medinë...", është prej arsyeve të jashtme të mirësisë së Islamit, që ne e përjetojmë sot. Allahu e zgjodhi atë për këtë madhësi. Edhe ai e shfaqti madhësinë e tij. Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Edhe sot po vijmë kohëra dhe po përjetojmë ngjarje në lidhje me të cilat të gjithë besimtarët mund të shfaqin madhësinë e tyre. Të gjitha kohët që do të vijmë deri në Kiamet, do të jenë të mbushura me ngjarje që kërkojnë të mëdhenjtë e tyre. Ne, si domosdoshmëri e besimit tonë, duhet të bëhemi të mëdhenj aq sa ta vlerësojmë mundësinë për t'u rritur dhe për të qëndruar të mëdhenj, ose do të poshtërohemi. Shembujt për këtë janë të shumtë. Koha në të cilën po jetojmë dhe në të cilën e gjithë bota na është vënë kundër, është koha për të jetuar si të mëdhenj dhe për të mbetur të tillë.

Allahu qoftë i kënaqur me ty, o Ebu Bekr! Sa madhështor ke qenë! Sa madhësi të mrekullueshme ke shfaqur! Ti u bërë dritë dhe shembull për ne.

Meditimi

— Dr. M. Kazim Kara —

Allahu i Lartësuar thotë: *“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.”* (Al ‘Imran, 190.)

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Meditoni rreth krijesave të Allahut.”*

Kurani Fisnik bën thirrje për meditim rreth 137 herë. Allahu (xh.xh.), dëshiron që robi t'i shndërron në meditim rrymat e madhështisë hyjnore që gjenden në gjithësi.

Zemra gjithmonë duhet të jetë në gjendje meditimi. Edhe urdhri i Allahut Tealá: *“Lexo!”*, i drejtohet vetë zemrës dhe synon leximin e gjithësisë dhe krijesave.

Në të vërtetë leximi është shikim, vlerësim, ndijm, dhe përkthim i këtyre gjendjeve. Shikimi përfshin çështjet si vëzhgimin, hulumtimin dhe studimin. Krahas vëzhgimeve që bëhen drejtpërdrejt me organet e shqisave dhe indirekt duke përdorur mjete të ndryshme, bëhet fjalë edhe për hulumtim dhe studim/kërkim, si dhe vlerësimin e rezultateve të tyre. Termi vëzhgim, që përdoret në shprehjen e mësipërme, përfshin edhe përdorimin e ndjeshmërisë. Çështja e ndjeshmërisë, që ka lidhje me aspektin shpirtëror të njeriut, është një specifike që qëndron mbi vëzhgimin, madje edhe mbi shikimin. Faktorët shpirtërorë që përbëjnë esencën e njeriut, së bashku me zemrën, janë shumë më të rëndësishëm se pjesët fizike. Nisur nga kjo, perceptimet që arrihen nëpërmjet esencës së njeriut, u japin formë atyre që arrihen me anë të faktorëve fizikë, duke i dhënë njeriut vlera të veçanta. Edhe civilizimet islame, në të kaluarën kanë arritur pikat kulmore në sajë të këtyre metodave.

Në të vërtetë, meditimi është çelësi i besimit.



Në sajë të besimit, njeriu arrin një pjekuri të lartë shpirtërore. Si rezultat, arrihet një frymëzim dhe përshtirje e lartë në jetën dhe adhurimet e tij. Sadi Shirazi thotë: “Qoftë edhe një gjethe peme është një koleksion madhështor për ta njohur Atë.” Me të vërtetë, kur të studiohet një gjethe, do të shihet qartazi kjo bindje e Shirazit, sepse gjetheja është organi i sistemit tretës, organi i sistemit të frymëmarrjes dhe madje faktori më i rëndësishëm i sistemit të qarkullimit të ushqimit të pemës.

Aktivitetet metabolike që u përkasin gjallesave, tek pemët kryhen nëpërmjet gjetheve. Uji, që pemët e marrin nga toka nëpërmjet rrënjëve, arrin te gjethet nëpërmjet trungut dhe degëve. Ndërsa nëpërmjet hapjeve mbi sipërfaqen e gjetthes, merret nga ajri dioksidi i karbonit, i cili konvertohet në komponime të karbonit (fotosintezë) nga rruga metabolike, prej rrezeve të diellit. Këto komponime të karbonit, që kthehen në formën e karbohidratit, sheqerit dhe vajit, arrijnë deri te frutat, nëpërmjet damarëve të gjetheve dhe degëve. Ja pra, edhe të gjitha gjallesat e tjera e sigurojnë nga këto komponime energjinë për të cilën kanë nevojë metabolizmat e tyre. Përveç të tjerash, edhe burimet e energjisë që përdoren në formë aktive sot, formohen nga këto komponime. Bimët madhështore që kanë ekzistuar para miliona vitesh, janë shndërruar në qymyr nën tokë. Edhe kafshët e mëdha, që e kanë siguruar nevojën e energjisë nga këto bimë, janë shndërruar në gaz apo lëndë djegëse të tjera.

Baza e të gjithë vargut të këtyre shndërrimeve është dielli.

Dielli, i cili me sa kuptohet do të vazhdojë deri në Kiamet, pa e pakësuar aspak energjinë e vet, prej të cilës përfitojnë ngrohtësi e rreze të gjitha gjallesat me në krye njeriun, dritën e merr nga Allahu Teala. Gjithashtu, të gjitha krijesat e ndritura, me në krye njeriun, dritën e marrin nga Allahu (xh.xh.). Domethënë, dritën e dukshme dhe dritën shpirtërore, galaksisë sonë ia jep Allahu.

Si rezultat i aktiviteteve biokimike që formohen në gjethe, përveç të tjerash del në pah edhe oksigjeni. Oksigjeni që hidhet në ajër nëpërmjet hapësirave të gjetheve, përbën burim jete për të gjitha gjallesat e tjera. Ndërsa lëndët e tjera kimike që formohen në gjethe për shkak të fotosintezës, nxirren jashtë si djersë nga hapjet e gjetheve nëpërmjet ujit, sepse gjethet përveç frymëmarrjes bëjnë edhe djersitjen.

Nëse shohim harmoninë e ngjyrave që formohen në natyrë përgjatë periudhave të ndryshme të vitit, do të kemi edhe një mundësi tjetër të veçantë për të medituar.

Përmendja e mirësive të Allahut (xh.xh.)

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Festimet për javën e lindjes së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), natyrisht që kanë në qendër vetë Pejgamberin (a.s.).

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka lindur para pesëmbëdhjetë shekujsh. Ne e kemi cilësuar si java e lindjes së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), periudhën e ditëlindjes së tij. Që nga viti 1989 e deri më sot, Kryesia e Entit për Çështjet fetare në Republikën e Turqisë ka organizuar festime dhe aktivitete të ndryshme kulturore, brenda dhe jashtë vendit, përgjatë javës në fjalë. Këto aktivitete që janë krejt të natyrshme, shpresohet të realizohen me cilësinë dhe seriozitetin që i takon shenjtërisë së çështjes, pa e lëkundur delikatesën e predikimit.

Për fat të keq, krahas disa personave dhe grupeve që i konsiderojnë këto organizime si “propagandë fetare” dhe përpiqen t'i kundërshtojnë e t'i ndalojnë, ekzistojnë edhe prej atyre që i kundërshtojnë në emër të fesë të gjitha këto akti-

vitete, ndërkohë që pyesin: “Përse e festojmë “lejletu meulidi'n-Nebi” apo natën e lindjes së Pejgamberit? Dikur kjo nuk është bërë.” Cili është kuptimi i këtij kundërshtimi, përmes të cilit synohet diferencimi i të drejtave dhe detyrave të ummetit prej atyre të Pejgamberit? Prandaj le ta lëmë këtë kundërshtim dhe të mos merremi me të, siç e bëjnë shumë mirë vahabitë.

Të mos harrojmë se lindja e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), apo festimi i ditëlindjes së tij, realizohet kur atë e ndjejmë brenda nesh. Ai ka lindur, por nëse dyert e zemrës sonë janë të mbyllura ndaj tij, do të thotë që ne nuk dimë gjë për të, dhe atëherë nuk kemi pse ta festojmë as ditëlindjen e tij.

Programet e televizorit apo të radios mund të jenë shumë të bukura, por nëse ne nuk i ndezim këto aparatura, si do të arrijnë këto programe te ne, apo si do të përfitojmë ne prej këtyre programeve? Fakti që ne nuk ndezim televizorin apo radion, a nuk do të thotë se këto programe nuk ekzistojnë për ne? Po ashtu, nëse dita ka zbardhur dhe dielli ka lindur, ndërsa ne i mbajmë të mbyllura dyert e dritaret, do të thotë që për ne dita nuk ka zbardhur dhe dielli nuk ka lindur. Domethënë, për perceptimin e festimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), çështja është tek unë, çështja është te ti, pra, çështja jemi ne. Perceptimi i festimit të ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe arritja e vetëdijësimit në lidhje me të, fillojnë pikërisht këtu, pra në pikën ku atë e ndjejmë brenda nesh.

Në përkthimin e Kuranit Fisnik, që është bërë në turqisht me titullin “Aziz Kur'an”, i ndjeri Muhamed Hamidullahu (v. 2002), në shënimin mbi ajetin e fundit të sures Duha: **“Dhe fol/shpalli dhuntitë e Zotit tënd.”**, thotë: “Myslimanët bazohen në këtë ajet për festimin e Mevludit, pra ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut, (a.s.).” Pastaj parashtron edhe këtë pyetje: “Cila mirësi hyjnore mund të jetë më e madhe se kjo për një besimtar?”


Mirësitë për të cilat jemi njoftuar se i janë dhënë të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në mënyrë indirekte i janë dhënë edhe ummetit të tij. Veprat dhe punët që i janë kërkuar për t'u kryer Pejgamberit tonë të nderuar, përveç atyre që ishin specifike për të, do të thotë se i janë kërkuar edhe ummetit të tij. Për këtë arsye, pyetja e të ndjerit Muhamed Hamidullahut, që thekson se për ne si ummet nuk mund të ketë mirësi më të madhe se Pejgamberi (a.s.), është mjaft e qëlluar. Përgjatë javës së Mevludit apo javës së aktiviteteve për ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), përpiqemi ta përkujtojmë, kuptojmë dhe shpjegojmë, në një formë më të ngjeshur dhe më të përhapur se çdo herë tjetër, të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i cili është mirësia më e madhe që na është dhënë. Këto aktivitete, nisur nga esenca e tyre, asnjëherë nuk janë një veprim prej bidati, sepse siç shprehet edhe i ndjeri Muhamed Hamidullahu, mbështeten te ajeti fisnik. Pra, këto aktivitete përqendrohen te “të folurit për mirësitë” e Zotit, gjë e cila gjendet brenda kufijve të kuptimit të ajetit të mësipërm. Për këtë arsye, edhe diskutimet tona absolutisht nuk janë mbrojtje ndaj një bidati.

Nëse këto aktivitete, që bëhen për të folur rreth mirësive të Allahut Teala dhe për ta falënderuar Atë, nuk priten me kënaqësi, do të thotë se ekziston një deficit i madh shpirtëror.

A nuk e kemi parë në natën e 15 korrikut 2016 (nata kur u bë tentativa për grusht shteti në Turqi), se dërgimi i salavateve për të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe hapja e zemrës ndaj tij, qenë shumë gjallëruese për ndjenjat e besimtarëve. A nuk ishte një ringjallje kjo kundrejt asaj tentative të ulët për grusht shteti?!

Nëse dikush shfaq mendjemadhësinë për të reaguar duke pyetur: “Përse e festojmë natën e Mevludit apo ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.)?”, atëherë ai duhet të kuptojë se e tija është një pyetje krejt e pavend nga aspekti i marrëdhënies ummet-Pejgamber, një pyetje e pabazë dhe shumë larg konceptit për të folurit rreth mirësive të Zotit (xh.xh.).

Allahumme sal-li ala Muhammedin ue ala ali Muhammed!



MIRËSITË PËR TË CILAT JEMI NJOFTUAR SE I JANË DHËNË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.), NË MËNYRË INDIREKTE I JANË DHËNË EDHE UMMETIT TË TIJ. VEPRAT DHE PUNËT QË I JANË KËRKUAR PËR T'U KRYER PEJGAMBERIT TONË TË NDERUAR, PËRVEÇ ATYRE QË ISHIN SPECIFIKE PËR TË, DO TË THOTË SE I JANË KËRKUAR EDHE UMMETIT TË TIJ.

Çfarë do të thotë "mbrojni nga zjarri"?

— Xhafer Durmush —



Allahu, i Cili është Mëshirues e Mëshirëbërës, thotë në Kuranin Fisnik: **“O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”** (Tahrim, 6)

Gjëja e parë që bie në sy, është fakti se një paralajmërim i tillë u bëhet veçanërisht atyre që kanë besuar. Duket sikur secilit prej nesh i thuhet: “O ti që ke besuar! Mbroje veten dhe familjen tënde nga zjarri!” Kjo mbrojtje mund të realizohet vetëm përmes përpjekjeve individuale të secilit prej nesh, dhe masave që duhet të marrim së bashku si shoqëri. Në ajetin fisnik na kujtohet tmerri i zjarrit dhe ashpërsia e engjëjve që gjenden në krye të tij, në mënyrë që ta kuptojmë seriozitetin e çështjes.

Kur zbriti ky ajet fisnik, sahabët e nderuar e pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.): “O i Dërguari i Allahut! Ne mund ta mbrojmë veten nga zjarri, por njerëzit e familjes si mund t’i mbrojmë?” I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, u përgjigj: **“Urdhërojini ata që të bëhen robër të Allahut, t’i binden Atij dhe ta adhurojnë Atë. Gjithashtu, ndalojini prej kundërshtimit të Allahut dhe prej kryerjes së mëkateve. Ja, kjo është mbrojtja ndaj atyre.”** (Alusi, Ruhul-Meani, XXVIII, 156.)

Ajetin fisnik mund ta kuptojmë siç vijon: Zoti (xh.xh.), po na paralajmëron. Ndër të tjera na njofton se ata që nuk ua vënë veshin paralajmërimeve hyjnore, mund të dërgohen në zjarrin¹ e përgatitur për mohuesit. Po ashtu na thotë se duhet të marrim masa për t’u mbrojtur nga ndëshkimi, për sa kohë ende e kemi mundësinë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na mëson se cilat janë masat që duhet të marrim.

Hadithin fisnik mund ta shpjegojmë në këtë formë: Së pari, mos harroni se jeni robër të Allahut Te-ala. Pastaj kryejini detyrimet e nevojshme. Kryerja e tyre tregon bindjen ndaj Allahut (xh.xh.), e cila realizohet duke zbatuar urdhrat dhe duke u larguar nga gjërat e ndaluara. Adhurimet duhet të realizohen me të njëjtën vetëdije dhe nuk duhet as të kundërshtohet Allahu (xh.xh.), dhe as të insistohet në mëkat. Këto gjëra së pari duhet t’i bëni vetë, në mënyrë që fjala juaj të ketë ndikim te të tjerët. Pas kësaj etape, të njëjtat gjëra duhet t’u mësohen edhe pjesëtarëve të familjes. Ndërkohë duhet të shfaqet durim për t’i bindur që të ushtrohen në praktikimin e tyre.

Në lidhje me hadithin fisnik mund të themi se në të njëjtën kohë, ai është përgëzim për ata që mund t’i qëndrojnë besnikë këtyre detyrimeve, sepse ata do të ruhen “nga zjarri, lënda djegëse e së cilit janë njerëzit dhe gurët”. Ndërsa e kundërta e kësaj, është afrimi hap pas hapi tek ndëshkimi, siç shprehet ajeti fisnik. Bazuar në këtë ajet, dijetarët myslimanë kanë thënë: “Ata që do të ndëshkohen më ashpër ditën e Kiametit, do të jenë ata që nuk i kanë plotësuar përgjegjësitë në lidhje me familjet e tyre.”

Ajeti fisnik tregon se “bi’l-ma’ruf/urdhërimi për të mirë”, duhet të fillohet nga pjesëtarët e familjes dhe të afërmit. Nëse bëhet fjalë për ndonjë kundërshtim të qartë ndaj Islamit, nëse shkelet qartazi ndonjë urdhër apo nëse veprohet diçka që është e ndaluar, atëherë gjithçka duhet të rregullohet sipas mënyrave të caktuara. Nëse fëmija ynë ka marrë rrugën e Xhehenemit prej mungesës së besimit, apo veprimeve dhe sjelljeve të gabuara, atëherë duhet ta ndalojmë duke i shpjeguar rezultatit final të këtyre sjelljeve, pra humbjen e përhershme.

1. Shik. SurjaBakara, 2/24; Surja Al Imran, 3/131.

Ne sigurisht që duhet të përpiqemi ta përgatisim fëmijën tonë për të ardhmen dhe duhet të bëjmë plane në lidhje të, e pastaj duhet të ndjekim realizimin e tyre, për të parë se sa seriozisht merren nga fëmijët. Por gjëja më e rëndësishme është të menduarit për të ardhmen e përhershme të fëmijës, pra të bërit të përpjekjeve serioze që ata të mos bëhen lëndë djegëse e zjarrit të Xhehenemit.

Duhet të theksojmë se urdhri “për ta mbrojtur veten dhe familjen prej zjarrit”, nuk është i kufizuar dhe i kushtëzuar me periudha të caktuara të ditës/vitit, siç janë kryerja e namazit, mbajtja e agjërimit, dhënia e zekatit dhe shkuarja në haxh. Përkundrazi, ai është i vazhdueshëm, pra është një urdhër që shpreh vijueshmëri. Për këtë arsye, ne duhet të përpiqemi të jemi të gatshëm për ta zbatuar deri në frymën e fundit.

Ndërkohë që janë në pah ndikimet e jashtme, të cilat ua shkaktojnë ndjenjat të rinjve dhe i largojnë ata nga përshpirtja, askush prej nesh nuk e ka luksin të thotë se “ç’është duhet mua nëse ka rënë zjarr në mëhallë”. Siç thuhet edhe në një hadith fisnik: “*Të gjithë jemi barinj dhe përgjegjës për ato që ruajmë.*” (Shik. Buhari, Ahkam, 1.) Të gjitha fushat e përgjegjësiive tona janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Përgjegjësia në kuptimin individual, nuk është e pavarur dhe e palidhur me jetën shoqërore. Prandaj, edhe problemet që nuk rregullohen në jetën sociale, ndikojnë në jetën personale...

Bazuar në ato që thamë më sipër, mund të shprehemi: Ky ajet fisnik gjithmonë duhet të jetë në rendin e ditës, madje duhet të jetë i pari, sepse ai na kujton masat që duhet të merren kundër lëvizjeve që mund ta shndërrojnë udhëtimin e kësaj bote në një humbje të përhershme. Për këtë arsye, ky ajet na tregon se së pari duhet të

shohim jetën tonë dhe pastaj duhet edhe të interesohemi për njerëzit e afërt, duke filluar që nga pjesëtarët e familjes.

Ky ajet fisnik dhe hadithi që e shpjegon atë, janë një recetë shpëtimi për në Botën e Përtejme, dhe një burim prehjeje në këtë botë, për ata që veprojnë sipas tyre.



KRIPA E TEPËRT

Në suren Bekare thuhet: “*Kur Taluti u nis për luftë bashkë me ushtrinë, u tha atyre: ‘Allahu do t’ju provojë me një lumë. Kush pi ujë në të, nuk është ushtari im. Ndërsa kush nuk pi ujë në të ose kënaqet vetëm me një grusht ujë, është ushtari im’. Por të gjithë pinë, përveç një pakice...*” (Bekare, 249.)

Kur ta lexojmë komplet këtë ajet fisnik, do të vëmë re një tablo mësimdhënëse që i kujton njeriut se është në sprovë në çdo moment, sepse në vazhdimin e ajetit thuhet se ata që pinë ujë nga lumi, jo një sasi të vogël me dorë apo me diçka tjetër, por duke vendosur gojën derisa u ngopën, thanë: “*...Ne sot nuk kemi fuqi të luftojmë me Xhалutin dhe ushtrinë e tij.*” Pastaj njoftohet se ata që iu bindën urdhrit duke besuar në takimin me Allahun, thanë: “*...Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit.*”

Siç thuhet edhe në tefsir, arsyeja e kësaj sprove ishte nxjerrja në pah e atyre që e kishin nijetin e sinqertë, ndaj atyre që nuk e kishin të tillë. Gjithashtu motiv ishte edhe ndarja e besimtarëve të sinqertë nga ata që nuk ishin të sinqertë, sepse te besimtarët shfaqen shenja dobësie, kur ndërmjet tyre hyjnë edhe ata që nuk e kanë nijetin e sinqertë. Kjo situatë sjell humbje totale.

Ata që pinë ujin dhe ata që nuk e pinë, janë edhe simbol i dynjasë me njerëzit, sepse njeriu që bën kujdes me përpikëri ndaj interesit të kësaj bote, arrin prehjen shpirtërore; ndërsa atyre që kanë oreks për të rendur pas interesit, oreksi vazhdimisht vjen duke iu shtuar. Për këtë arsye, kjo botë është krahasuar me kripën dhe është thënë: “Sa më shumë që të rendësh pas saj, aq më shumë të shtohet etja.” Edhe në hadithin fisnik thuhet: “*Nëse njeriu do të kishte dy lugina me florinj, do të kërkonte të tretën.*” (Buhari, Rikak, 10.)

Tashmë dëshiroj të theksoj që Islami nuk e ka parë si të papëlqyeshëm posedimin e pasurisë, përkundrazi thuhet: “*Besimtari i fuqishëm është më i mirë se besimtari i dobët.*” (Muslim, Kader, 34.)

Çështja e papëlqyeshme këtu është tamahu me këmbëngulje për të marrë një mirësi, e cila është lejuar të merret vetëm në një masë të caktuar, në mënyrë që të matet bindja dhe nënshtrimi ndaj Zotit (xh.xh.). Ja pra, për këtë arsye edhe uji që e shuan etjen në kushte normale, e shton këtë të fundit kur pihet pa masë.

EBU HEJTHEME EL ENSARI

- (R.A.) -

I PRIU USHTRISË ISLAME DERI NË UHUD

— Mustafa Erish —

Ebu Hejtheme el-Ensariu (r.a.), ishte një sahab i famshëm dhe njihej ndërmjet shoqërisë për sjelljen e tij në luftën e Tebukut!.. Ai ishte një fatlum, që shpëtoi nga shkatërimi duke e arritur ushtrinë islame dhe duke u bërë pjesë e saj, pasi që nuk e pati bërë këtë që në fillim!.. Ai ishte një sahab i nderuar që i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka përgëzuar duke i thënë: *“O Ebu Hejtheme! Për pak do të shkatërroheshe.”*

Ebu Hejtheme (r.a.), ishte sahabi hero, që i priu të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe ushtrisë islame deri në Uhud. Ai ishte nga Medina dhe i përkiste fisit Hazreth. Ngaqë ishte i njohur me llagapin e tij, është mjaft e vështirë për t’ia gjetur emrin e vërtetë. Në libra të ndryshëm emri i tij thuhet se është Abdullah ibn Hejtheme dhe Sa’d ibn Hejtheme. Ndërsa emri

i njohur i tij transmetohet si Ebu Hejtheme Malik ibn Kajs ibn Hejtheme el-Ensari (r.a.).

Në lidhje me jetën e tij nuk ka shumë të dhëna. Edhe pse nuk është e sigurt nëse ka marrë pjesë në luftën e Bedrit, dihet se ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që nga ajo e Uhudit. Ebu Hejtheme el-Ensariu (r.a.), i ka prirë të Dërguarit të Allahut, (a.s.), kur po shkonte në Uhud. Rrëfëhet se ngjarja është zhvilluar si më poshtë:

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, u tha sahabëve të nderuar: *“Kush mund të na prijë dhe të na çojë deri te politeistët nga një rrugë e afërt pa na parë ata?”*

Ebu Hejtheme el-Ensari (r.a.), tha: *“Ju çoj unë, o i Dërguari i Allahut!”* Ai e kaloi ushtrinë islame



nëpërmjet tokës së Beni Harithes dhe e çoi në Uhud.

Ebu Hejtheme el-Ensariu (r.a.), u njoh dhe u bë i famshëm në Medinetu'l-Munevvera, më së shumti për shkak të qëndrimit të tij në lidhje me luftën e Tebukut. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i pati urdhëruar sahabët që të përgatiteshin për këtë luftë. Atë kohë ishte periudha më e nxehtë e vitit. Gjithashtu, ushtria sapo ishte kthyer nga lufta e Taifit dhe disa sahabëve akoma nuk u kishte kaluar dot lodhja e rrugës.

Ndër të tjera, edhe hipokritët përpiqeshin dhe bënë propagandë që t'i ndalonin myslimanët dhe t'i bindnin që të hiqnin dorë nga kjo luftë. Disa prej sahabëve të nderuar u ndikuan nga këto propaganda dhe nuk morën pjesë në të, por qëndruan në Medine. Njëri prej këtyre sahabëve ishte Ebu Hejtheme el-Ensariu (r.a.).

Pasi ushtria islame u nis për rrugë, në një moment kur familja e tij po e priste, ngaqë kishte shtruar sofrën nën hije dhe kishte përgatitur ujë të ftohtë e ushqime të shijshme, Ebu Hejtheme el-Ensariu, (r.a.), erdhi në vete. Ai e kuptoi atë që kishte bërë dhe filloi të mendonte. Për një moment para syve iu duk sikur pa të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe mendoi për vuajtjet që po hiqte i Dashuri i Allahut. Ai nuk e konsideroi të drejtë që vetë të ulej në një vend të rehatshëm dhe të hante ushqimin, ndërkohë që i Dërguari i Allahut, (a.s.), kishte marrë rrugën për të shkuar në luftë nën diellin e nxehtë e përvëlues, edhe pse i kishte të falura të gjitha mëkatet e kaluara dhe të ardhme. Zemra nuk ia pranoi kurrë këtë veprim dhe këtë sjellje. Ai mori rrufeshëm një

vendim, kapi armën dhe i hipi kalit. Kështu mori rrugën drejt Tebukut. Ebu Hejtheme (r.a.), shkoi në Tebuk së bashku me Umejr ibn Vehb el-Xhumahinë (r.a.), i cili gjithashtu kishte vonuar në marrjen e këtij vendimi.

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, u mërzi jash-tëzakonisht që Ebu Hejtheme el-Ensari (r.a.), nuk mori pjesë në luftë. Kur Pejgamberi (a.s.), u njoftua se dikush po vinte nga larg, shpresoi fort që personi në fjalë të ishte Ebu Hejtheme el-Ensari (r.a.).

Pastaj e shprehu si më poshtë dashurinë që ndjente ndaj tij: *"Ah sikur të jetë Ebu Hejtheme ky që po vjen!"*

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, u soll me mirësi dhe u lut për Ebu Hejtheme el-Ensariun (r.a.), i cili mori pjesë në luftë me një vonesë prej dhjetë ditësh. Mosmarrja pjesë në një përpjekje obligative në rrugën e Allahut, mund të shkaktojë edhe shkatërrimin shpirtëror të njeriut.

Ebu Hejtheme (r.a.), të cilit i kalon emri si poet në literaturë, nuk dihet saktësisht se kur ka ndërruar jetë. Ai në një poezi ka folur për ngjarjen e Tebukut dhe në një tjetër ka folur për vuajtjet që ka hequr Zejnebja, (r.a.)a, vajza e Pejgamberit tonë të dashur, kur shkoi në Medine pas luftës së Bedrit.

Allahu qoftë i kënaqur me Ebu Hejthemenë (r.a.)! Zoti (xh.xh.), na largoftë nga veprimet që na shkatërrojnë! Gjithashtu, na mundësoftë që të veprojmë me largpamësi dhe mendjemprehtësi! Po ashtu, na bashkoftë në Xhenet me Ebu Hejtheme el-Ensariun (r.a.)! Amin!



KUR HUMBËSIT KTHEHEN FITIMTARË



— Nuredin Nazarko —

I humbur! I fituar! Shpesh e më shpesh vërtiten diskutimet mbi këto dy gjendje. Njeriu e ka të vështirë të pranojë humbjen. Në çdo situatë kujton se ka fituar. Është një ecejake mes të qënies i humbur dhe i fituar.

I humbur! I fituar! Po çfarë na thonë njerëzit për atë që është i humbur apo i fituar? Nuk është e thënë që të ketë unanimitet. Do t'i referohemi ashtu siç e shpreh një pjesë e mirë e njerëzve perceptimin mbi të qënies i humbur apo i fituar. Çdo mosarritje është një humbje.

Mospasurimi. Nuk ke arritur të kesh një shtëpi të bollshme, moderne, të arëduar sipas shijeve më të fundit.

Je rrëzuar në provime.

Nuk i ke nxjerrë të gjitha notat dhjeta.

Nuk ia ke dalë të fitosh intervistë pune.

Nuk je renditur i pari në konkurs apo në garë.

Nuk ke dalë i pari klasës, shkollës.

Nëse ke patur pozicion të mirë pune dhe nuk ke ngjyer duart, je humbamento që nuk bën dot prokopi.

Nuk ia ke hedhur klientëve në peshë dhe në masë, nëse je tregëtar.

Të gjithë zunë nga një qoshe dhe u sistemuan, ti

ende vërtitesh pa gjë nëpër duar.

Sa mirë janë rregulluar ata që ikën jashtë vendit. Po bëjnë prokopi. Para. Punë. Shtëpi. Jetojnë si mos më mirë. Janë shumë mirë atje ku janë. Ju mbetet këtu. Vuani tani se nuk patët kokë.

Po nuk ndryshuat e të veproni si të gjithë nuk kini të ardhme.

Këta dhe plot përcaktime të tjera janë tregues i perceptimit të shumë syresh mbi: I humbur! I fituar! Për njerëzit thelbi që ndan këto dy gjendje është zotërimi material. Nuk zotëron – je i humbur. Zotëron – je i fituar. Dy përcaktime krejt të ngurta, para të cilave përcaktuesit nuk lëshojnë pe.

Përcaktimi i rezultatit final, i humbur – i fituar, ka detyruar shumë syresh që jetët e tyre t'ia nënshtrijnë pikërisht këtyre përcaktimeve. Kjo ndodh sepse për këtë pjesë opinionin e njerëzve është shumë i rëndësishëm. Ka një varësi të theksuar nga mendimi i të tjerëve. Çfarë do të thonë ata për ne? Si do të na përcaktojnë? Në cilën kategori do të na vendosin?

Shqetësimi i madh se si ne do të përcaktohem shtrydh energjitë tona në diskutime, debate, të cilat përveç shtrydhjes së energjisë pa bereqet nuk nxjerrin asgjë në dritë. Debate, diskutime të panevojshme për opinionin e shumicës që ndryshon bashkë më shpejtësinë e lëvizjes së ajrit. E nëse

opinionin nuk mbështetet në asnjë parim të mirfilltë moral, a ka ende vend që ne të lëshohemi në shtrydhje energjie?

Ndërkohë që tendenca në rritje e mënyrës së të jetuarit nën diktatin e zotërimit material po arrin nivele shqetësuese në dëm të mënyrës së të jetuarit nën hijen e parimeve dhe shkakësive parake, shumica vazhdon të ngrejë në nivele të reja trysninë ndaj të jetuarit ndryshe. Pakica që ka si qëllim një jetë ndryshe, shndërrohet në tabelë qitje. Kur themi jetë ndryshe nuk lidhet aspak me detajet e parëndësishme të një mënyre jetese. Të jetuarit ndryshe nuk lidhet as me grupe shoqërore minorancash. Nuk lidhet as me ndryshime të elementëve sipërfaqësorë të të jetuarit. Veprimet jetësore janë të njëjta. Punë. Lodhje. Të ardhura. Shpenzime. Mbijetesë. Po çfarë e bën të ndryshme jetesën e pakicës?

Ata që jetojnë ndryshe, janë ata që frymojnë ndryshe. Nëse punojnë, përpiqen të jenë të përgjegjshëm dhe profesionistë.

Në çdo lloj profesioni që ushtrojnë përpiqen të jenë korrektë, të drejtë, dhe afër shqetësimeve njerëzore, duke i udhëzuar ata që janë nën përgjegjësinë e tyre udhës që duhet të shkojnë, për jetë të virtytshme.

Janë ata që më shembullin personal, edhe pse në periudhë të vështirë, na tregojnë se të jetosh virtytshëm, nuk është e pamundur.

Janë ata që më sakrificën e tyre i thonë të kundërtën atyre që e konsiderojnë humbje jetesën e drejtë, të ndershme dhe pa përdredhje gjarpërore.

Janë ata që edhe pse të varfër nuk e shtrijnë dorën e lypjes dhe as nuk merren me tregëti trupash për pesë aspra.

Janë ata që edhe pse me kufizime të caktuara nuk reshtin së përpjekuri për të qenë të virtytshëm në sigurimin e jetesës, pa iu bërë kujt barrë në emër të kufizimit që kanë.

Janë ata që edhe kur janë në pozita të vështira gjejnë kurajo të përçojnë besim dhe shpresë për kalimin e vështirësive.

Janë ata që edhe kur retë ngjishen në grinë e tyre të errët dijnë të gjejnë rrugën për tek dielli.

Janë pikërisht këta që vendosen në kategorinë i


humbur, nga shumica që e vendos veten në kategorinë, i fituar. Pse kjo? Sepse i fituari nuk mund të besojë që i humburi ka fituar në një tjetër dimension. Nuk e njih këtë dimension. Njih vetëm dimensionin e zotërimit material. Për shumicën, nëse nuk je rritur në nivelet e zotërimit je i humbur. Nëse je i humbur, je i shpërfillur. I parëndësishëm. I vakët. Njeri për të ardhur gjynah. Pa prestigj. I rëndomtë. I pamësuar me lajelujet e sërës që i shkëlqen gëzofi apo peliça dhe që nuk harron të grijë ndonjëherë thonjtë me dhëmbë. As gëzofi e as peliça nuk mundën t'ia shqitnin këtë zakon njerëzish të rëndomtë. Të rëndomtë sipas tarafit të sërës së ngritur mbi pirgjet e zotërimit material. Këta janë "fisnikët" që përçmojnë njerëzoren, vetëm sepse nuk i përshtatet shijeve të tyre.

Nëse jeta e virtytshme konsiderohet humbje nga shumica, mos vallë do të thotë që sasia numerike është kriter i së vërtetës? Kur është parë dhe dëgjuar që shumica të jetë ndonjëherë në anën e virtyteve? Historia njerëzore gjithmonë i ka patur të pakët të virtytshmit. Tash a do të ketë ndryshim? Nuk kanë rëndësi perceptimet e shumicës. Fjalët e tyre. Sulmet. Shpifjet. Fyerjet. Tek e fundit veprojnë atë që dijnë të kryejnë më mirë. Për ta mjafton të kesh xhepat plot dhe je padroni ndaj të cilit duhet të nënshtrohesh. Por jo me të gjithë ndodh kjo që presin të ndodhë. Ka syresh që edhe pse vendosen në kategorinë, i humbur, nuk demoralizohen. Nuk jepen. Nuk përkulen. Nuk i largohen skrupujve. Nuk merakosen për fshikullimet. Durojnë, sepse jeta e virtytshme nuk mund të jetë e tillë nëse nënshtrohesh ndaj të vetshpallurve fitues.


Koha i jep hakun çdokujt. Rrjedhja e saj është rruga ku ecin, i humburi dhe i fituari. Ndoshta nuk dallojnë shumë, por në çastin e duhur secili do të kuptojë kujt kategorie i përket.

Atëherë me siguri do të dëgjojmë fituesit të thonë: - a këta ishin ata me të cilët talleshim e i vinim në lojë? Çfarë ka ndodhur që sot qëndrojnë në pedestal ndërsa ne me kokë përmbys dhe zemra të ngushta sikur të ngjiteshim në qiell?

Ky është çasti kur humbësit janë kthyer fitues. Paskëndaj nuk ka më zhbërje. Secila palë shijon frytet e fitores.



**ATËHERË ME SIGURI DO
TË DËGJOJMË FITUESIT
TË THONË: - A KËTA
ISHIN ATA ME TË CILËT
TALLESHIM E I VINIM NË
LOJË? ÇFARË KA NDODHUR
QË SOT QËNDROJNË NË
PIEDESTAL NDËRSA NE ME
KOKË PËRMBYS DHE ZEMRA
TË NGUSHTA SIKUR TË
NGJITESHIM NË QIELL?**





Të ekzistosh apo të jetosh?

— Edison Çeraj —

Shumë njerëz e ngatërrojnë të qenurit kontradiktor me hipokrizinë. E para, sipas çdo gjase, është pjesë e natyrës njerëzore (në jetën e kafshëve nuk ka kontradikta, as në atë të alienëve); ndërsa e dyta, jo se nuk është, por nuk duhet të jetë.

Një njeri që nuk ndryshon asnjëherë, që noton gjithnjë në të njëjtët ujëra, që bën një jetë të ashkuajtur lineare, që është i sigurt dhe i qartë për çdo gjë, që karakterizohet nga një gjendje pothuajse e njëjtë emocionale rezulton të ketë bërë vetëvrasje shpirtërore, pasi në një mënyrë apo në një tjetër ka flijuar botën e tij të brendshme.

Krahasimi i personazheve të Dostojevskit me tipat psikologjikë të Jung-t na tregon shumë në këtë drejtim: të parët janë të veçantë, të papritur, spontanë, dramatikë, me dilema, pasionantë e kështu me radhë; ndërsa të dytët janë të gjithë një prerje, të ftohtë, sikur janë bërë në laborator. Dallimi është themelor, po aq dhe paralajmërues.

Dostojevski na kumton se natyra njerezore është e paparashikueshme, dhe çdo përpjekje apo ambicie për ta parashikuar dhe përkufizuar është hapi i parë drejt dhunimit të lirisë.

Në fakt, te shumë shkrimtarë pas Dostojevskit, si Kafka, Joyce, Beckett-i, Camus, Zamjatin, Huxley, Orwell, Kavabata etj., një vend qendror në veprën e tyre zë pikërisht rrjedhoja e dhunimit të kësaj lirie përmes pushtetit të dijes racionale apo shkencore (në dhjetëra disiplina) për t'i vënë një emër të dytë njeriut, pra, për ta përkufizuar, për t'i treguar rrugën, për t'i dhënë një manual përdorimi të vetes.

Nëse romani i shekullit XIX, ndër të tjera na paralajmëronte se çfarë mund të bëjë një person që është i sigurt në vetvete, që nuk ka asnjë mëdyshje, që ndihet superior ndaj të tjerëve, që beson pa kushte në idhuj abstraktë si progresi¹, romani i shekullit pasardhës, ndër të tjera, u fokusua edhe te pasojat e mosmarrjes parasysh të këtij paralajmërimi.

Kështu, romani na ndihmoi dy herë: njëherë duke na paralajmëruar, herën tjetër duke na treguar se

çfarë ndodhi me ne, meqë nuk e morëm seriozisht herën e parë.

Trashëgimia e dishepujve të progresit sot është rënia e vazhdueshme e diversitetit gjithandej dhe një botë gjithnjë e më e zbrazur nga qëllimi, dhe për pasojë gjithnjë e më e përqendruar te funksioni. Natyrisht, njeriut po synohet t'i hiqet qoftë dhe funksioni, pasi në skenë kanë filluar të zënë vend me ngulm robotët e zgjuar, kopjet e menjëhershme të njeriut, që në një fazë më të zhvilluar do të arrijnë të shkruajnë edhe poezi (pa poezi), ashtu siç po bëjnë kafe pa kafeinë.

Kopjet e menjëhershme të njeriut do arrijnë të pëmbushin çdo funksion, derisa njeriu ta ketë të gjithë kohën e lume në dispozicion për të bërë asgjënë e përsosur, për t'u çliruar më në fund një herë e mirë nga çdo orvatje për kuptim, pasi kjo asgjë e përsosur do të jetë në gjendje të përpijë çdo kuptim si të ishte një vrimë e zezë.

Një botë që funksionon vetvetiu, pa patur nevojë për një qëllim, pra pa ne.

Në një mbretëri të tillë librat e shenjtë, letërsia dhe arti nuk do të kenë se çfarë të thonë, dhe misioni i tyre do të konsiderohet i mbyllur. Do të jetë si të jetosh pa pasqyrë, domethënë pa ndërjegje. E mira dhe e keqja do të zënë vend nëpër muzetë e së ardhmes, si në librat distopikë, dhe ndër të tjera do të jenë stimuj me orar për të qeshurën, natyrisht nëse do të ekzistojë e qeshura.²

Duke perifrazuar Wilde-n, njerëzit nuk do të jenë në gjendje të jetojnë (personazhet e Dostojevskit), por vetëm të ekzistojnë (tipat psikologjikë të Jung-ut). Ajo që shumë vetëm e etiketojnë sot si “mirëqenie”³, nuk është gjë tjetër vetëm se një *work in progress* që po na imponohet (ngaqë vetë po e kërkojmë) për të kapur stadin e atyre që ekzistojnë, pa qenë në gjendje të jetojnë.

Ata që vetëm ekzistojnë nuk i durojnë dot ata që jetojnë.

2. Nuk është fjala për rastin kur nxirret një zë i ndërprerë, duke e lëshuar pjesë-pjesë ajrin nga gryka dhe duke lëvizur gojën e muskujt e fytyrës, siç e shpjegon fjalori.

3. Paradhoma e lumturisë, sipas tyre.

1. Mjafton të kujtojmë romane si *Të mjerët*, *Perënditë kanë etje*, *Vëll-zërit Karamazov*, *Djajtë*, *Karriera e Rugonëve* etj..

5 Këshilla

— Ferudun Ozdemir —

Një njeri i devotshëm pa në ëndërr sikur iu tha:
“Kur të mbërrijë sabahu, gjënë e parë që të shohësh kapërdije, të dytën fshehe, të tretës plotësoja kërkesën, të katërtën mos e mërzit, ndërsa nga e pesta largohu!”

Erdhi sabahu dhe njeriu doli jashtë. Filloi udhën dhe ç’të shohë, një mal i madh i doli përpara. U habit. Tha me vete:

“Zoti im më urdhëroi ta kapërdij. Ai nuk më urdhëron me diçka për të cilën nuk kam mundësi.” Dhe kështu vendosi ta kapërdinte. Filloi të ecte drejt tij, por sa më shumë që ecte aq më shumë mali zvo-gëlohej. Kur mbërriti ai tashmë ishte sa një kafshatë, e kapërdiu. Shijen e kishte të ëmbël. E falënderoi Allahun e vazhdoi të ecte.

Përballë iu shfaq një govatë që mbiu nga toka. Mendo: “Zoti më urdhëroi që këtë ta fsheh.” Prandaj hapi një gropë dhe e mbuloi atë. Eci më tutje por kur kthehu kokën pas, vuri re që govata kish dalë përsëri mbi faqen e dheut. U kthye dhe e groposi edhe një herë. Eci edhe pak dhe përsëri shikoi govatën të cilën e groposi për të tretën herë. Tha me vete “Unë e bëra detyrën time.” dhe u largua.

Rrugës i doli para një zog që po ndiqej nga një skifter. Zogu i tha: “O ti rob i dashur i Allahut, me fsheh, më ndihmo!” E mori dhe e fshehu atë në gjirin e tij. Më pas foli skifteri: |O ti rob i dashur i Allahut, unë jam i uritur. Jam gjithë ditën në ndjekje të këtij zogu, dua ta kap atë, mos u bëj pengesë e rriskut tim!” Njeriu tha me vete: “M’u urdhërua të plotësoj kërkesën e të tretit dhe e plotësova. M’u tha

të mos mërzis të katërtin. Tani ç’të bëj?” U hutua. Pastaj mori thikën, ndau një copë mish nga kofsha e tij dhe ia hodhi skifterit. Më pas e la zogun të lirë dhe vazhdoi.

Rrugës pa një kufomë që kundërmonte erë të keqe. E la dhe u largua.

Kur erdhi nata bëri këtë lutje:

“Unë iu binda urdhrit Tënd. O Zot, të lutem më trego kuptimin e këtyre punëve.”

Përsëri në ëndërr një zë i tha:

“E para që shikove dhe gëlltite ishte zemërimi yt. Në fillim u duk i madh sa një mal, por me durim, u zvo-gëlua aq shumë sa u bë një kafshatë e ëmbël.

E dyta, ishte puna jote e mirë. Sado që ta fshehësh, ajo ka për të dalë mbi faqen e dheut.

E treta ishte një amanet që të ishte dorëzuar. Mos e tradhto atë!

E katërta ishte kjo: nëse një njeri kërkon diçka prej teje, jepja, edhe nëse është diçka e domosdoshme për ty.

E pesta ishte përgojimi. Largohu nga ata që përgojnë.

Me të vërtetë, vetëm Allahu di më së miri.”

Të fitosh kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut nuk është një punë shumë e vështirë... mjafton të zbatojmë urdhrat e Tij dhe të largohemi nga gjithçka Ai ka ndaluar. Këto urdhëresa dhe ndalesa nuk janë një barrë që nuk mund të mbarten nga njeriu sepse Ai nuk ngarkon askënd përtej mundësive të tij...

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



AJAS PASHA

KRYEVEZIRI I PALODHUR

QË VDIQ NGA MURTAJA

— Dr. Ardian Muhaj —

Ajaz Pasha (Ayas Mehmed Pasha, 1483–1539) me sa duket ishte i biri i një shkodrani të martuar me një delvinjote dhe i lindur në Vlorë. Një raport i vitit 1531 i një agjenti në shërbim të spanjollëve që ia dërgonte Alfonso Kastriotit në Kalabri, pohonte se Ajaz Pasha që në atë kohë ishte vezir i dytë pas Ibrahim Pashës, ishte nga zona e Vlorës dhe se sanxhakbeu i Vlorës ishte i vëllai i Ajazit.¹ U bë kryeministër në 14 mars 1536 pas ekzekutimit të Pargali Ibrahim Pashës dhe e mbajti këtë detyrë deri sa vdiq në vitin 1539.²

Mori pjesë në fushatën e Selimit I kundër sefevidëve më 1514 në betejën e Kaldiranit si Aga i Jeniçerëve. Po ashtu ishte një nga figurat kryesore të fushatës së luftës mes osmanëve dhe memlukëve të Egjiptit në vitet 1516-1517. Një raport i kohës pohon se në dorën e tij u dorëzua mbreti i fundit memluk i Egjiptit, Tumanbej. Në vitet 1520-1521 u ngrit në rangun e qeveritarit të Damaskut dhe të bejlerbeut të Anadollit. Më pas mori pjesë në luftën për marrjen e ishullit me rëndësi të Rodit në Egje, duke drejtuar krahun e djathtë të flotës osmane. Pas ndryshimeve të vitit 1523 që sollën si sadrazam Ibrahim Pashën u ngrit në rangun e vezirit. Ishte po ashtu figurë me rëndësi në betejën e Mohaçit më 1526 që përfundoi me fitoren vendimtare osmane kundër hungarezëve si edhe në rrethimin e parë të Vjenës më 1529.³ Rolin më të rëndësishëm e pati në luftën e Irakut në vitet 1534-1535, duke qenë drejtues i fushatës ushtarake. Siç pohonte bailiu

venedikas në Stamboll, portugezët tashmë po merren në konsideratë nga Sulltani, qoftë për shkak të pranisë së tyre në Oqeanin Indian ashtu edhe për ndihmën që mund t’u jepnin sefevidëve.⁴ Në këtë këndvështrim pushtimi osman i Irakut që përfundoi në 1534 i forcoi pozitat e tyre në Oqeanin Indian. Pak muaj pas hyrjes triumfale të Sulejmanit I në Bagdad, në shoqërinë e Ibrahim Pashës, Sulejman Pashës dhe shqiptarit tjetër Ajaz Pashës, sundimtarë të tjerë nxituan të afrohen me osmanët. Mes tyre ishin emiri Rashid i Basrës, emiri i Bahrejnit dhe ai i Katifit, duke siguruar kështu kufirin detar me portugezët në zonën e Gjirit Persik.⁵

Duke qenë vezir për rreth 13 vite, pas ekzekutimit të Ibrahim Pashës u bë kryeministër.⁶ Edhe pse ishte nga kontingjentet e devshirmesë, pra i larguar për arsim ushtarak që në fëmijëri i mbajti lidhjet me Shqipërinë dhe vendlindjen gjithnjë. Sipas bailiut venedikas në Stamboll Piero Bragadin, ai kishte edhe dy vëllezër të tjerë, ndërkohë që e ëma ishte akoma e krishterë.⁷ Të ëmës ai dërgonte çdo muaj 100 dukatë.⁸ Lidhjet e pashkëputura të tij me vendlindjen i dëshmon një farefis i tij. Në vitin 1535 një person që në dokumentacionin spanjoll paraqitej me emrin Dionisio della Vechia, i propozoi perandorit Karli V një projekt jorealit që pretendonte marr-

4. “Il re di Portogallo viene in considerazione del Signor Turco... per [le cose] dell’Indie, si per l’aiuto che ditto re potesse fare dare al Sofi per quella via, come per l’impresa che potesse il Signor Turco fare a distruzione della navigazione di Portogallo in quelle parti .” Alberi, *Relazioni*, 3: 22.

5. S. Özbaran, “Ottoman Turks,” f. 55; Floor, *Persian Gulf*, f. 156.

6. Danismend, *Kronoloji*, V: f. 16-17; Vernon J. Parry, “Ayas Pasha,” *EL, Second Edition* (Leiden: Brill, 1960-2004).

7. “Il terzo bassà, nome Aias di nazione albanese, nato appresso la Zimera, mostra esser uomo di guerra et aver animo di far guerra et gran cose...sono tre fratelli. Ha la sua matrè Cristiana”. Bragadino shkruante në 1526, kur edhe thotë se ishte 44 vjeç.

8. Hammer gabimisht pohon se ai kishte tre vëllezër murgj. Ndërkohë mbishkrimi në gurvarrin e tij shkruan Ayas b. Mehmed, çka nënkupton se i ati ishte mysliman ose ishte bërë mysliman. V. J. Parry, “Ayas Pasha,” *Encyclopaedia of Islam, Second Edition*, Edited by: P. Bearman, Th. Bianquis, C.E. Bosworth, E. van Donzel, W.P. Heinrichs.

1. “El segundo bascia se chiama Ayas nato in le ville intorno a la Velona et ha un fratello lo quale e sanjacho nel predetto loco. AGS Estado, legajo 635, doc. 108, 29 gusht 1531, fl.4

2. ismail Hâmi Danismend, *Osmanlı Devlet Erkânı*, Türkiye Yayınevi, İstanbul, 1971, f. 15; Ömer Mahir Alper, “Ayas Mehmed Pasa” *Yasamları ve Yapıtlarıyla Osmanlılar Ansiklopedisi*, İstanbul, 1999, vëll. I f. 272; Cavid Baysun, “Ayas Pasa”, *IA*, vëll. II, f.43-47; Bekir Kütükoglu, “Ayas Pasa”, *DiA*, vëll. IV, f. 202-203.

3. Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, I. B. Tauris, 2012, f.21.


jen e Shkodrës e madje përzënie e osmanëve prej krejt Shqipërisë. Sipas fjalëve të tij ai bashkë me vëllanë, që në dokument shkruhet si Joan de la Vecchia, u ofronte spanjollëve dorëzimin e kështjellës së Shkodrës përmes një komploti, duke pohuar se ishin farefis të kryeministrit perandorak, shqiptarit Ajas Pasha. Njëri prej tyre madje kishte banuar në shtëpinë e tij në Stamboll për një farë kohe. Nga ana e tij vetë kryeministri Ajaz Pasha kishte urdhëruar qeveritarin e sapoemëruar të sanxhakut të Shkodrës që të mbështesë dhe privilegjojë axhën e tij Dionisin.⁹ Natyrisht që kryeministri nuk ishte në dijeni të pretendimeve të Dionizit për të shfrytëzuar farefisninë me të për të paraqitur projekte pa asnjë mundësi realizimi në oborrin spanjoll. Ajo që del nga ky raport e përforon mendimin se ai kishte farefis si në zonën e Sanxhakut të Vlorës nga ishte e ëma, ashtu edhe nga Sanxhaku i Shkodrës, prej nga kishte të atin. Në vakëfnamen e tij del se ka lënë vepra bamirësie në shërbim publik përveç se në vendet e shërbimit në administratë, si Stamboll, Edirne, edhe në vendlindje, si në Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Delvinë, Janinë.¹⁰

Nën kryeveziratin e tij osmanët ndërmorën fushatën e vitit 1537 me qendër në Vlorë dhe që fillimisht synonte që në bashkëpunim me francezët të merrnin Italinë e Jugut nga spanjollët. Sulejmani i Madhërisëm kur mbërriti në Vlorë përmes Elbasanit e gjeti tashmë flotën osmane të grumbulluar në portin e Vlorës, por jo atë franceze. Për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm mes tyre, objektivi i fushatës ndryshoi dhe forcat osmane në praninë e Sulltan Sulejmanit I iu drejtuan Korfuzit venecian. Megjithë përpjekjet e Ajas Pashës për të shmangur përfshirjen e Venedikut në luftë kundër osmanëve, Senati venedikas vendosi të shpallë luftën. Kjo edhe përkundër faktit që mes dy shteteve marrëdhëniet kishin qenë paqësore që prej fillimit, dhe kishte 35 vite që mes tyre kishte pasur një paqe të qëndrueshme, shumë e rrallë kjo në Europën e kohës. Përmes bailiut dhe ambasadorëve Ajas Pasha u përpoq të hapte një kanal komunikimi përpara se të ishte vonë dhe të zgjidheshin mosmarrëveshjet me bisedime. Pjesë e tensioneve ishte edhe një shumë prej tetë mijë dukatesh ari që një tregtar italian i kishte borxh vetë kryevezirit Ajas Pasha.¹¹ Sipas kronistit osman Haxhi Halife, vendimi për ndërmarrjen e kësaj fushate ishte ndikuar nga kryeministri Ajas Pasha, që ishte vetë nga kjo krahinë. Këtu kishte

9. AGS, E 1310, fols. 76 (29 nëntor 1533) dhe 195-197; E 1312, fols. 121-122 (11 Maj 1536). AGS, E 1312, fol. 161 (8 Shtator 1536) Gürkan, "Espionage in the 16th Century Mediterranean", f. 174.

10. H. Ahmet Arslantürk, "Sadrazam Ayas Pasa'nın Vakfiyeleri ve Bir Sınırnâmesi", *Osmanlı Arastırmaları / The Journal of Ottoman Studies*, XXXVII (2011), f. 165-180.

11. Kenneth Meyer Setton, *The Papacy and the Levant (1204-1571)*, Volume III. *the Sixteenth Century*, 1976, f. 407-408.



edhe prona siç dëshmohej jo vetëm nga vakëfnamja e tij, por edhe nga fakti që në 1524-1525 ambasadori venedikas në Stamboll i pagoi Ajas Pashës 150 dukatë për vreshat që ia kishte marrë me qera në kazanë e Argosit në Peloponez.

Në këtë fushatë që u mbyll me fitoren osmane në betejën detare të Prevezës të vitit 1538, në krye të flotës osmane ishte Lufti Pasha edhe ky shqiptar nga kjo zonë. Ishte flota më e madhe që osmanët kishin mobilizuar ndonjëherë prej 280 anijesh. Për t'u theksuar është se edhe pse Hajredin Barbarosa ishte edhe ai i pranishëm në krye të 130 anijesh, në këtë rast drejtimi i flotës i besohet vendaliut Lutfi Pasha.¹² Edhe gjatë rrethimit të Korfuzit, Hajredin Barbarosa ishte nën komandën e Lutfi Pashës. Të dy këta në fakt nuk ishin dakord me vendimin e Sulltan Sulejmanit dhe kryevezirit Ajas Pasha për të hequr rrethimin dhe për t'u tërhequr. Megjithëse ushtria tokësore u tërhoq Lutfi Pasha dhe vartësi i tij Hajredin Barbarosa ndërmorën një sulm mbi Qefaloninë duke marrë plaçkë të madhe luftime.¹³ Me këtë rast u ndërtua kalaja e Vlorës, e cila ishte një nga kështjellat më të forta të ndërtuara nga osmanët në Ballkan. Po ashtu me këtë rast u krijua Sanxhaku i Delvinës, që u nda nga ai i Vlorës, në të cilin përfshihej deri atëherë.

Ajas Pasha e mbajti detyrën e kryeministrit pa ndërprerje deri sa vdiq në Stamboll nga epidemia e murtajes në 13 korrik të vitit 1539. U varros në xhaminë Sulltan Ejup të Stambollit. Pas Ajas Pashës që vdiq nga epidemia e murtajes erdhi në krye të qeverisë osmane shqiptari tjetër Lutfi Pasha, kontingjent i devshirmesë, ka të ngjarë nga zona e Vlorës. Sipas kronistit Mustafa Ali, Ajaz Pasha pati një jetë familjare shumë aktive. Thuhej madje se la pas vetes njëzet fëmijë.¹⁴

12. *The History of the Maritime Wars of the Turks*. Translated from the Turkish of Haji Khalifeh by James Mitchell, London, 1831, f. 55.

13. Haji Khalifeh, *The History of the Maritime Wars*, f. 58.

14. Leslie P. Pearce, *The Imperial Harem: Women and Sovereignty in the Ottoman Empire*, Oxford University Press, 1993, f. 304.



Umeti më i mirë

— Doç. Dr. Harun Emysh —

Kurani Fisnik i cilëson ithtarët e fesë që ka sjellë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), si “umeti më i mirë”¹, sepse ata i besojnë Allahut Teala dhe dispozitave që Ai ka urdhëruar të besohen dhe e zbatojnë parimin el-emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munker, domethënë, i urdhërojnë njerëzit për të mirën dhe i ndalojnë ata nga e keqja.²

el-Emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munker është një parim shumë përfshirës dhe i gjithanshëm. Ky parim siç përfshin thirrjen e njerëzve për mirësi dhe zbatimin e dispozitave të ndëshkimeve, përfshin edhe ndalimin nga e keqja me anë të rrugëve ligjore. Për këtë arsye ky parim është farz kifaje, domethënë, nëse një pjesë e umetit e kryen, të tjerëve u bie përgjegjësia apo nëse askush nuk e kryen, atëherë të gjithë konsiderohen mëkatarë. Kjo për arsye se ky parim është prej çështjeve që kërkojnë dije dhe autoritet, të cilat nuk i ka çdo individ i umetit. Nëse njerëzit e paditur dhe ata që s'kanë autoritet tentojnë ta kryejnë këtë punë, mund të shkaktojnë gabime të parikuperueshme dhe kaos. Prandaj, pjesën e kësaj pune në lidhje me gjuhën duhet ta kryejnë dijetarët dhe pjesën në lidhje me autoritetin duhet ta kryejnë autoritetet. Në disa ajete para këtij ajeti që e lavdëron umetin, thuhet:

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të

1. Al Imran, 3/110.

2. Çdo vepër që dihet se është e mirë me mendje apo shariat është maruf, ndërsa e kundërta është munker. Shik. Ragib, Mufredatu elfazi'l-Kur'ani'l-Kerim, lënda «arf».

jenë të shpëtuarit.” (Al Imran, 104)³ Megjithëkëtë, ata njerëz që nuk kanë dije dhe autoritet nuk do të thotë që të mos ndalojnë nga e keqja. Edhe këta të paktën duhet ta urrejnë me zemër të keqen, duhet të mbajnë qëndrim kundër saj dhe duhet ta bëjnë të qartë anën e tyre. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith fisnik që është i njohur për ne të gjithë: “*Kushdo prej jush që sheh ndonjë të keqe, le ta rregullojë me dorën e tij! Nëse nuk ka fuqi për ta bërë këtë, le ta rregullojë me gjuhën e tij! Nëse nuk ka fuqi për ta bërë edhe këtë, atëherë le ta urrejë me zemrën e tij! Ndërkohë ky është besimi më i dobët!*” (Muslim, Iman, 78.)

Parimi el-emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munker që mundëson lavdërimin e umetit me cilësinë “umeti më i mirë”, para së gjithash duhet të zbukurohet me mirësinë dhe pastaj dëlirjen nga gjërat e këqija që janë të ndaluara. Nëse dikush urdhëron të mirën ndërkohë që nuk e vepron vetë dhe ndalon nga e keqja ndërkohë që e bën vetë, ai asnjëherë nuk mund të jetë bindës dhe influencues. Ndër të tjera, për ta mbajtur në këmbë këtë parim duhet një shoqëri në të cilën udhëheqësit dhe të udhëhequrit të jenë të bashkuar dhe në të cilën u vihet veshi të diturve, sepse, në ajetet paraardhëse të këtij ajeti që shpreh këtë lavdërim ka shumë specifika që e tregojnë këtë. Ndër këto specifika mund të përmendim: Allahu Teala ua kujton arabëve, të cilët gjendeshin në buzë të greminës së zjarrit për shkak të luftërave ndërmjet tyre, se i shpëtoi nga ai rrezik në sajë të mirësisë së Islamit. Allahu Teala i urdhëron ata që të kapen fort pas fesë së Tij dhe të mos bien në përçarje si umetet e mëparshme. Allahu i Madhëruar i paralajmëron ata se do të marrin dënim të tmerrshëm dhe se do të ndëshkohen në ahiret nëse bien në përçarje, etj...⁴ Për këtë arsye, shkaqeve që e bëjnë këtë umet të meritojë cilësinë “umeti më i mirë” duhet t'i shtojmë edhe unitetin dhe bashkimin.

3. Shik. Bejdavi, Envaru't-Tenzil ve Esraru't-Te'vil, (Al Imran, tefsiri i ajetit 104.)

4. Shik. Al Imran, 103-107.

Mirë, por si do të sigurohet/arrihet mbajtja e unitetit dhe bashkimit? A nuk do të ketë asnjë që do të mendojë ndryshe në këtë umet? Ndërkohë në themelin e ndarjes gjendet diversiteti në mendime dhe orientime. Përderisa natyrat, mendimet dhe këndvështrimet e njerëzve të jenë të ndryshme, rënia e tyre në kontradikta do të jetë e pashmangshme. Edhe sahabët e nderuar të cilët kanë qenë marrësit e parë të këtij lavdërimi hyjnor dhe të cilët e kanë merituar atë siç shprehet në shumë ajete kuranore⁵, kanë pasur kundërshtime ndërmjet tyre në disa tema. Ndër këto tema, për të cilat kanë rënë në kundërshtime, ka pasur edhe çështje të akides si “ru'jetullah/shikimi i Allahut”. Nisur nga këto që thamë, një pjesë e kundërshtimeve mund të tolerohen. Transmetohet se edhe i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka thënë në lidhje me këtë çështje: “Kundërshtimet (ndërmjet besimtarëve) e umetit janë mëshirë.”

**“Faltoret e Allahut
i vizitojnë dhe i mirëmbajnë
vetëm ata që besojnë
Allahun dhe Ditën e Fundit,
që falin namazin dhe japin
zekatin e që nuk i frikësohen
askujt, përveç Allahut.
Sigurisht që këta janë në
rrugë të drejtë.”**

Ndërsa në krye të kundërshtimeve të cilat i qorton Kurani Fisnik dhe që na ndalon prej tyre janë kundërshtimet me natyrë përçarëse që e shkatërrojnë unitetin dhe bashkimin. Atëherë le ta shtrojmë pyetjen kështu: Si do të arrihet mbajtja e unitetit dhe bashkimit meqë njerëzit bien në kundërshtime për shkak të mendimeve, orientimeve dhe natyrave të tyre?

Kjo pyetje ka një përgjigje të lehtë: Moskonsiderimi i kundërshtimeve, të cilat burojnë nga natyra e njerëzve, si shkaqe ndarjeje, do të thotë të mos i përjashtosh ata që mendojnë ndryshe.

Këtu duhet të kujtojmë edhe një cilësi tjetër shumë të lavdëruar me të cilën është cilësuar umeti: Umeti vasat, domethënë, umeti mesatar. Feja e umetit mesatar është larg ifratit dhe tefritit. Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ka përshkruar këtë fe në formën “feja e pastër tolerante”. Reflektimet më konkrete kundrejt atyre që mendojnë ndryshe i gjejmë në veprimet e Aliut, (r.a.). Aliu, Havarixhëve, që u ndanë prej tij me arsyen se ai pranoi zgjidhjen e gjykatësve

5. Shik. Al Imran, 172-174; Ahzab, 23; Fet'h, 18, 29.

për kundërshtimet ndërmjet tij dhe Muavije ibn Sufjanit, u dha leje të luftonin në ushtrinë e tij kundër qafirëve dhe të merrnin pjesë nga plaçka e luftës. Në këtë sjellje të Aliut (r.a.), shihet qartë përpjekja e tij për ta mbrojtur unitetit e bashkimin politik dhe për të qëndruar larg përçarjes duke e lënë mënjane kundërshtimin mental, sepse rreziku më i madh për një shoqëri është largimi nga uniteti dhe rënia në përçarje. Siç e shprehëm edhe më sipër, edhe sahabët e nderuar kanë pasur tema për të cilat e kanë kundërshtuar njëri-tjetrin. Por kur këto kundërshtime në lidhje me xihadin arritën në një pikë që e lëkundën unitetin dhe bashkimin, atëherë dolën në pah fitne të mëdha si Xhemeli dhe Siffini.

Tani le të shqyrtojmë gjendjen reale të umetit:

Nëse dikush e sheh gjendjen tonë nga jashtë për hir të Allahut, a mund ta pranojë se ky umet është umeti i cilësuar me atributin “umeti më i mirë”? Le ta lëmë mënjane pranimin e kësaj prej dikujt nga jashtë dhe ta shtrojmë pyetjen në këtë mënyrë: Cili prej nesh mund t'i flasë me krenari për këtë cilësi dikujt nga jashtë ndërkohë që ne jemi në këtë gjendje? Mos vallë është përgënjeshttrim i Kuranit Fisnik shtrimi i këtyre pyetjeve? Zoti na faltë!

Umeti që Kurani Fisnik e cilëson “më të mirin” dhe “mesatar”, është umeti që i mbart kushtet të cilat i përmendëm më lart dhe jo umeti që mbart vetëm një emër të thatë. Ne sigurisht nuk mund t'i mbyllim sytë ndaj atyre që po ndodhin dhe ta mohojmë realitetin.

Luftërat e sekteve që evropianët i kanë bërë dhe përfunduar në shekujt e mesjetës, ne po i nxisim përsëri në shekullin e 21-të. Le ta pranojmë: Lufta në Irak, Liban dhe veçanërisht në Siri nuk është gjë tjetër përveçse lufta Sunito-Shiite. Një zënkë që ka ndodhur ndërmjet Ali ibn Ebi Talibit (r.a.) dhe Muavije ibn Ebu Sufjanit (r.a.), po e vazhdojmë me këmbëngulje dhe inat edhe pse kanë kaluar afërsisht katërmëdhjetë shekuj nga vdekja dhe kalbja e kockave të tyre.

Kjo ndoshta mund të kundërshtohet në formën:

“Kjo nuk ka lidhje me fenë, sepse është përplasje me natyrë politike!” Por edhe nëse është kështu, a nuk është e qartë se në esencën e kësaj çështjeje gjendet përsëri përplasia e sekteve? Po, kjo është një e vërtetë aq e qartë saqë nuk mund ta mohojë askush. Pastaj, sa mund të shqyrtohen ndarazi nga njëra-tjetra feja dhe politika në historinë islame? A nuk patën dalë në fillim si lëvizje politike medhhebet e itikadit si Havarixhët dhe Shiizmi?

Myslimanët përgjatë gjithë historisë mendoj se nuk kanë rënë më poshtë se tani, në këtë kohë që po jetojmë. Në këtë gjendje kaq të dobët nuk kanë rënë as në kohën e kryqëzatave, as në kohën e pushtimit mongol dhe as në kohën kur u kolonizua e gjithë bota islame dhe u shkatërrua Shteti Osman... Ne tashmë kemi rënë në një gjendje aq të dobët saqë kërkojmë mëshirë nga ndërhyrja e jomyslimanëve.

Nisur nga ato që thamë më lart, tashmë kundërshtimet ndërmjet nesh nuk duhet t'i lejojmë që të nxjerrin përçarje dhe armiqësi. Tashmë duhet t'i kërkojmë dhe t'i gjejmë mënyrat për ta formuar unitetin dhe bashkimin të cilët janë kusht i domosdoshëm për ta zbatuar parimin elementar bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munker dhe për t'u bërë umeti më i mirë që e meriton lavdërimin hyjnor. Mënyra për ta arritur këtë nuk është që ta bëjmë sunitin shiit apo shiitin sunit. Në të vërtetë, me imponim as suniti nuk bëhet shiit dhe as shiiti nuk bëhet sunit. Tani po jetojmë në një kohë që duhet ta kujtojmë më së shumti se jemi umeti mesatar, se feja jonë është fe e tolerancës dhe se duhet t'i marrim parasysh më shumë se kurrë veprimet e Ali ibn Ebi Talibit (r.a.).

Unë nuk po them se këto cilësi dhe sjellje të mos i kujtojmë edhe për të tjerët, por sipas jush, a nuk ka një ironi të madhe në organizimin e mbledhjes së dialogut ndërfeetar në Katar ndërkohë që në Siri sipas regjistrimeve janë vlarë mbi njëqind mijë njerëz dhe me miliona të tjerë janë detyruar të arratisen nga vendi i tyre për shkak të kësaj lufte mizore apo masakre barbare që akoma vazhdon dhe që në thelbin e saj ka fanatizmin sektar?





HISTORIA E PIKËS SË UJIT

Një pikë uji kishte rënë nga retë në det. Kur kishte parë gjerësinë e detit, ishte turpëruar nga vogëlsia e saj. Më vete kishte thënë:

“Kush jam unë kundrejt detit? Ekzistenca ime nuk merret as në konsideratë kundrejt madhësisë së atij.”

Një sedef perle ia kishte hapur krahët e saj pikës së ujit ngaqë ajo ishte shfaqur modeste. Atë e kishte ndihmuar dhe e kishte mbrojtur. Sedefi e kishte ushqyer atë me dashuri.

Fati e kishte lartësuar dhe e kishte bërë aq shumë të vlefshme atë pikë të vogël uji, saqë e kishte vendosur si një perlë në kurorën e sulltanëve.

Pika e ujit u lartësua ngaqë e pa veten modeste dhe të thjeshtë. Mirë, po ti, si e shikon veten?

NJË THËNIE

“Kurrë nuk bie në pesimizëm, sepse çdo gabim është një hapi i ri i hedhur drejt të ardhmes.”

(Thomas Edison)

NJË LUTJE

“Disa djelmossa u strehuan në shpellë dhe thanë: “O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!”

(Kehf, 10)

FAKTE INTERESANTE

- Ajnshtjani ka filluar të flasë rrjedhshëm vetëm në moshën nëntë vjeçare. Familja e tij pati menduar se ai mund të kishte aftësi të kufizuara mendore.
- Numri më i lartë e fëmijëve që kanë ardhur në këtë botë me një lindje dhe që kanë jetuar është 6.
- Toka rrotullohet me një shpejtësi prej 1670 km/h rreth boshtit të saj dhe me një shpejtësi prej 108.000 km/h rreth diellit.

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni!”

(Huxhurat, 10)

Një Ajet

Çdo pjesë përbërëse e gjithësisë merr pjesë aktive duke luajtur rolin e vet në gjithësi. Në këtë mënyrë të gjithë elementët që përbëjnë gjithësinë janë në harmoni të plotë me njeri-tjetrin. Dimri përgatit pranverën, pranvera lajmëron për verën kurse vera lajmëron për vjeshtën. Gjallesat kanë nevojë për bimë, bimët për tokë dhe toka ka nevojë për ujë.

Ndërsa pjesët e veçanta që përbëjnë natyrën nuk shprehin asgjë të pavarura nga njera-tjetra kur janë të gjitha së bashku krijojnë në panoramë sa të bukur edhe estetike. Në këtë mënyrë të gjithë së bashku elementët përbërëse të natyrës formojnë një strukturë të vetme organike.

Ashtu si universi që përbëhet nga elementë të ndryshëm edhe shoqëria njerëzore përbëhet nga individë me karaktere dhe personalitete të ndryshme. Por që të realizohet uniteti dhe solidariteti në shoqëri duhet që individët që e përbejnë atë të çlirohen nga interesat individuale. Kombe të fuqishme janë ato kombe që kanë bashkuar zemrat dhe mendjet rreth një qëllimi dhe objektivi të caktuar. Bashkimi dhe solidariteti është veçori themelore e besimtarëve që e kanë lidhur zemrën e tevhidin. Kurani i konsideron besimtarët si një shoqëri të përkushtuar ndaj të drejtës dhe që luftojnë së bashku për të vendosur drejtësinë në tokë. Besimtarët ushqejnë dashuri dhe dhembshuri për njëri-tjetrin dhe janë të palëkundur e të panënshtuar përballë jobesimtarëve.

Një herë Pejgamberi a.s ndërsa po qëndronte me sahabët i thotë: “ Në ditën e

gjykimit do të ketë rob të Allahut të cilët për nga afërsia që kanë me Allahut do të lakmohen nga pejgamberët dhe dëshmorët e rënë në rrugë të Allahut.” sahabët pyetën me kureshtje: “ Kush janë ata o i dërguari i Allahut? “ Ata janë besimtarët që e duanë njëri tjetrin vetë për hir të Allahut pa ndonjë interes material apo lidhje fisnore” (Ebu Davud, 76)

Ndjenja e dashurisë dhe harmonisë midis besimtarëve është krejt ndryshe nga dashuria apo harmonia që ekziston në shoqëritë e tjera. Kjo dashuri mbi të gjitha është një dhuratë e Allahut për besimtarët. Allahu i zbut zemrat e besimtarëve duke i bërë vëllezër. (Allahu) **“duke i bashkuar zemrat e tyre (si një zemër e vetme). Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”** (Enfal, 63) Ajeti e vendos vëllazërinë në zemër, në qendrën e dashurisë larg vëllazërisë formale dhe sipërfaqësore.

Dy fiset kryesore të Medines Evs dhe Hazreth deri para ardhjes së Pejgamberi në Medine ishin në luftë të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Luftërat e përgjakshme kishin lënë me qindra viktime nga të dyja palët. Ndjenjat armiqësore dhe hakmarrëse kishin kapluar zemrat e tyre. Por kur i lidhën zemrat pas Islamit dy fiset deri dje armiq të përbetuar të njëri-tjetrit u bënë vëllezër të pandarë me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë u realizua një mrekulli që përveç Allahut dhe besimit hyjnor nuk mund ta realizonte kush tjetër. Zemrat që urrenin njëri-tjetrën u bashkuar për të krijuar një zemër të vetme.

Transmetohet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

"Më premtoni gjashtë gjëra që t'ju premtoj xhenetin: Kur flisni thoni të vërtetën, kur premtoni mbajeni premtimin, kur t'ju jepet një amanet çojeni në vend atë, ruani nderin, ruajuni prej shikimit haram dhe mos bëni padrejtësi.."

(Ahmet b. Hanbel, Musned, 5/323)

Ky hadith i Pejgamberit a.s i transmetuar nga Ubade ibn Samit ndër qindra vepra të mira numëron gjashtë vepra të rëndësishme zbatimi i të cilave e bën këtë botë parajsë kurse në botën tjetër i garanton zbatuesit xhenetin. Në një hadith tjetër të Pejgamberi a.s mos zbatimi i tre të parave pra gënjeshtria, mos mbajtja e premtimit dhe tradhtia e amanetit është konsideruar prej shenjave të hipokrizisë. Prandaj cilësitë e përmendura më sipër janë veçori të besimtarit të mirë.

Këto gjashtë virtyte janë parimet themelore të moralit individual dhe shoqëror. Besimtari i zbaton këto vlera të vyera morale jo nga presioni i shoqërisë por nga vetëdija se janë të mira. Besimtari përvetëson moralin e bukur nga që ai beson se urdhëresat dhe këshillat e Allahut dhe të dërguarit janë të mira. Nga gjashtë vlerat morale të përmendura dy të parat kanë lidhje me gjuhën. Thënia e të vërtetës dhe mbajtja e premtimit janë dy çështje të rëndësishme të cilat nuk po kemi sukses në zbatimin e tyre. Kjo dobësi është konstatuar edhe në periudhën e Pejgamberit a.s "O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!" (Saff, 2-3)

Premtimi i shkelur nga një anë është gënjeshtër nga anë tjetër mos mbajtje fjale. Gënjeshtria është prej mëkateve të mëdha. Mbajtja e premtimit është tregues i cilësisë së besimit prandaj Allahu e ka konsideruar si veçori të devotshmëve. Pejgamberi a.s në një hytbe i urdhëroi besimtarët të respektojnë me rigorozitet të gjitha marrëveshjet e nënshkruara në periudhën para Islame sepse Myslimani e ka obligim qëndrimin mbas fjalës së dhënë. Për këtë arsye Pejgamberi a.s i qëndroi besnik marrëveshjeve

të bëra më politeistët dhe për hir të marrëveshjes bëri shumë sakrifica. Në këtë kontekst mund të përmendim rastin e Ebu Basirit i cili u burgos nga që pranoi Islamit por që arriti që largohej nga Meka për në Medine pas marrëveshjes së Hudejbijes. Sipas marrëveshjes çdo Mekas mysliman që kërkonte strehim në Medine do të kthehej mbrapsht dhe Kurejshët nuk vonuan dhe erdhën për të kërkuar Ebu Basirin mbrapsht sipas marrëveshjes së nënshkruar. Muhamedi a.s iu drejtua Ebu Basirit me këto fjalë " O Ebu Basir siç e di edhe ti ne i kemi dhënë fjalën Kurejshëve dhe në fenë tonë nuk ka vend pabesia. Allahu ty dhe besimtarëve të tjerë si ti do të gjejë një zgjidhje." Pas kësaj e nisi me kurejshët.

Një rast tjetër i ngjashëm është edhe rasti i Ebu Rafiut të cilën Kurejshët e patën dërguar si përfaqësuesin e tyre në Medine por ai sapo kontaktoi me Pejgamberin a.s i lindi dëshira për tu bërë mysliman dhe shprehu dëshirën për të qëndruar në Medine Por Pejgamberi a.s i tha un nuk e prish marrëveshjen. Nga jeta e Pejgamberit mësojmë se mbajtja e fjalës së dhënë qoftë edhe karshi armiqve është prej moralit të besimtarit. Vlerat që përmend hadithi janë vlera që e ngrënë njeriun nga një qenie biologjike në një qenie morale. Identiteti mysliman mund të ruhet vetëm duke i zbatuar këto vlera prandaj të parët tanë kanë thënë "fjala është nder"

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Rëndësia e zbatimit të këtyre gjashtë porosive.
2. Garantimi i xhenetit përmes tyre.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- PJESA III -



PËRGATITJA PËR AHIRET

Njëherë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyet Ebu Dherin:

“Kur dëshiron të dalësh për udhëtim, a përgatitesh?”

Ebu Dheri (r.a.), u përgjigj:

“Po o i Dërguar i Allahut!”

Profeti (a.s.), vazhdoi më tej:

“Mirë, por si do të jetë udhëtimi i ditës së Kiametit? Dëgjomë, a të t'i them ato që do të kenë dobi për ty atë ditë?”

Ebu Dheri (r.a.) me entuziazëm të madh pohon:

“Po o i Dërguar i Allahut! T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im!”

Kësaj here Profeti (a.s.) tha:

“Dita e ringjalljes është një ditë shumë e nxehtë.

Për t'u freskuar atë ditë agjëro që tani!

Për vetminë e varrit fal dy rekat namaz në errësi-rën e natës!

Për ndodhitë e mëdha të Kiametit bëj njëherë haxhin dhe jep sadaka!

Ose fol drejtë, ose pengoje gjuhën nga të folurit fjalë të këqija!” (Ibni Ebi'd-Dunja, Kitabu't-Tehexhjud; Gazali, Ihja, I, 354.)

Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se çfarë ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!” (Hashr, 18.)

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar përdor fjalën **“nesër”** kur flet për Ahiretin. Zoti ynë, i Cili nuk ndikohet nga koha dhe hapësira, në lidhje me vaktin e Kiametit dhe Ahiretit flet për një kohë që



është e afërt sa e “nesërmja”, ndërkaq mohuesve u duket sikur s’do të vijë kurrë, ndërsa indiferentëve u duket larg,

Ndërsa në këtë ajet fisnik, na bëhet e ditur se sa relativ është koncepti i kohës:

“...Një ditë te Zoti yt, është sa një mijë vjet sipas llogarisë suaj.” (Haxhxxh, 47.)

Për të korrur produktin e lumturisë së Ahiretit, që është jeta e pafundme e që në të vërtetë gjendet afër sa e “nesërmja”, nuk duhet të vonohemi e të neglizhojmë mbjelljen e farave të punëve të mira sot në arën e kësaj bote. Ne duhet ta përdorim aq mirë kohën që kemi në dispozicion, saqë edhe po të na lajmërohet që nesër do të vdesim, ne nuk duhet të ndjejmë asnjë nevojë për të ndryshuar diçka në programin e jetës sonë!

Këto këshilla të Shejh Sadi Shirazit, janë shumë domethënëse:

“Furnizimin për në botën tjetër bëje vetë, sepse pasi të kesh vdekur të afërmit e tu mund t’i kaplojë lakmia dhe nuk bëjnë asnjë bamirësi për shpirtin tënd. Floririn dhe të mirat që ke jepi sot sa je gjallë! Pasi të kesh vdekur, këto të mira nuk mund t’i kesh më! Nëse dëshiron të mos vuash, mos i hiq nga mendja të vuajturit! Ndaje shpejt atje ku duhet thesarin, sa e ke në dorë sot, e mos e lër për nesër, sepse nesër çelësat mund të mos i kesh më. Furnizimin dërgoje vetë që sot! Pasi të vdesësh mos prit mëshirë nga gruaja e nga fëmija jot!

Ai që e përgatit vetë furnizimin për në botën tjetër, ka bërë punën më të rëndësishme. Kurrizin tim, vetëm thoi im mund ta kruajë duke menduar për mua, e askush tjetër.

Çfarëdo lloj pasurie të kesh, vendose në pëllëmbë të dorës dhe jep aty ku duhet dhënë! Nëse nuk jep, nesër do të pendohesh dhe do të kafshosh duart.”

Allahu i Madhëruar, në këtë ajet na bën të ditur furnizimin më të mirë që na duhet për udhëtimin e përjetësisë:

“...çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!” (Bekare, 197.)

Allahu i Madhëruar dëshiron të bëhet mik me robërit e Tij. Mënyrat e arritjes së miqësisë i përk-

fizon në urdhrat hyjnorë. Kurse vetë miqësia rrjedh prej gjërave të përbashkëta. Që të bëhesh mik me Allahun e Madhëruar, është kusht që të duash ata që Ai do dhe të braktisësh ata që Ai nuk i do. Furnizimi më i çmuar që mund të çohet në botën tjetër, është **“takua-ja”** (frikë-respekti ndaj Allahut), që nënkupton pajisjen me cilësi të mira që kënaqin Allahun dhe dëlirjen prej cilësive negative, të cilat Ai nuk i do. Për të arritur miqësinë me Allahun, duhet t’i transmetosh një zemër të pastër e të zbukuruar me ndjesinë e **“takua-s”**.

Duke u nisur nga kjo e vërtetë, i nderuari Mevlana, në veprën e tij Mesnevi shprehet:

“Nëse dëshiron të miqësohesh me Allahun e Madhëruar, dije mirë se tek miqtë nuk shkohet duarbosh! Të shkosh duarbosh tek miqtë, është si të shkosh pa grurë në mulli.

Allahu i Madhëruar do t’i pyesë robërit e Tij në ditën e gjykimit:

«Çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit?»

Pastaj do të thotë:

«Ju keni ardhur duarbosh, pa furnizim, të vetmuar dhe nevojtarë ashtu siç ju krijuam në fillim. Na tregoni çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit? Apo ndoshta nuk shpresonit se do të ktheheshit nga dynjaja në Ahiret e do të dilnit para Allahut? A mos ju duk kot lajmi i Kuranit në lidhje me Kiametin?»

O ahsen-i takuim, pra, o njeri që je krijuar me cilësitë më të bukura! Nëse nuk e mohon ditën e Kiametit, si shkel në derën e Atij Miku kështu, duarbosh? Pakësoje gjumin, ushqimin dhe pijen në këtë botë të përkohshme dhe përgatit një dhuratë për kohën kur do të takohesh me Allahun e Madhëruar!..”

Shkurtimisht, dhurata më e bukur që mund t’i çohet Allahut të Madhëruar është pasqyra e një zemre të lehtë e të pastër, ku manifestohen emrat e Tij të bukur.

DOBITË E BESIMIT NË BOTËN TJETËR

Besimtari që jeton me vetëdijen se dynjaja është e përkohshme, ndërsa Ahireti është i përjetshëm, nuk e lidh zemrën e vet me këtë botë, e di se mirësitë e përkohshme janë shkaqe të sprovave hyjnore dhe të gjitha këto mirësi i përdor në përputhje me kënaqësinë e Allahut. Pra, shqetësimi për botën tjetër dhe përpjekja për t’u përgatitur për vdekjen,

luan rolin e një rregullatori të drejtimit të robit. Për rrjedhojë, një besimtar që thotë:

“Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.” (Insan, 10.), është e qartë se ai do të largohet nga gjynahet dhe do të shtojë punët e mira.

Njeriu indiferent jeton sipas qejfit të vet, larg shqetësimit për botën tjetër. E në fakt, ai është i mposhtur nga egoja e tij, por nuk është i vetëdijshëm për këtë dhe mjerimin e vet e pandeh lumturi. Ai e konsumon jetën në një letargji të tmerrshme, sikur të mos ekzistonin fare fazat e frikshme që e presin në varr dhe në Ahiret.

Asnjë ndodhi nuk asgjësohet vetëm prejse dikush nuk e pranon ekzistencën e saj. Për më tepër, deri më sot nuk është dëgjuar asnjëherë që të kenë shpëtuar nga vdekja ata të cilët ikin prej saj dhe prej Ahiretit e Allahut. Po ashtu, frika e thatë ndaj vdekjes nuk ja ka shtyer askujt afatin e saj.

Realiteti i vdekjes dhe Ahiretit, një ditë do t’u dalë përballë edhe atyre që i mohojnë. Lumturia e rreme dhe të qeshurat false që shfaqin sot njerëzit indiferentë, atë ditë do të kthehen në dështim dhe pendim, që të djeg shpirtin.

Besimi në botën tjetër e bën njeriun e mençur të mendojë se një ditë do t’i pritët lidhja me dynjanë, do të përballet me të mirat dhe të këqijat që ka vepruar dhe do të marrë, pa asnjë mangësi, shpërblimin e të gjitha veprave të tij pozitive e negative. Pra, të meditosh në lidhje me vdekjen dhe Ahiretin, bëhet shkak i vetëdijesimit, i prishjes së lidhjes së zemrës me këtë botë, i korrigjimit të veprimeve e sjelljeve dhe i qëndrimit sa më larg gjynaheve.

Mendimi rreth vdekjes, ndërkohë që është mes të mirave dhe luksit, e ruan robin nga ndikimi negativ i pasurisë. Ndërsa mendimi për të, ndërkohë që është i varfër e nevojtar, e bën robin të kënaqur me atë që zotëron, falënderues dhe të qetë në shpirt.

Sprova më e madhe dhe katastrofa më e tmerrshme për njeriun është vdekja. Por më keq akoma është të jetosh indiferent ndaj vdekjes dhe jetës përtej saj, të fshish mendimin për to dhe të konsumosh kapitalin e jetës pa bërë asnjë vepër që meriton kënaqësinë e Allahut. Ajo që i ka hije një njeriu të mençur është përgatitja ende pa i ardhur vdekja. Pikësëpari duhet të pastrohet egoja nga zakonet e këqija, sepse një ego e papërpunuar dhe e paedukuar me kriteret hyjnore, nuk mund ta pra-

nojë kurrë përkohshmërinë dhe vdekjen. Lidhur me egon, Ismail Hakki Bursevi shprehet:

“E si të bëhet myslimane egoja?! Ajo është nëna e mohimit. Madje edhe shejtani u bë mohues për shkak të egos.”¹

Pra nëse nuk frenohet egoja dhe nuk i kufizohen në minimum dëshirat dhe lakmitë, ajo nuk do t’i lejojë hapësirë të menduarit për vdekjen dhe gjithçka ka përtej saj, dhe në frymën e fundit egoja do e mbizotërojë shpirtin, duke u bërë shkak që njeriu të largohet pa besim në botën tjetër (Allahu na ruajt!).

Për t’i shpëtuar këtij rreziku të madh, është e domosdoshme që egoja të edukohet dhe të pastrohet, ndërsa shpirti të përforcohet me adhurime dhe përmendje të Allahut.

I nderuari Shejh Sadi, shprehet kështu në lidhje me nevojën e edukimit të egos para se të vijë vdekja:

“O vëlla, në fund do të bëhesh dhe! Prandaj bëhu modest si dheu para se të bëhesh dhe!”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), urdhëron:

“Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, të mos e shqetësojë fqinjën e vet! Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, le të gostitë mikun! Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, ose të flasë fjalë të dobishme, ose të heshtë!”

(Buhari, Nikah 80, Edeb 31, 85, Rikak 23; Muslim, Iman, 74, 75.)

Një besimtar, që u vë veshin dhe zemrën këtyre porosive profetike, i karakterizon marrëdhëniet e tij ndërnjerëzore përherë me tipare si mëshira, delikatesa, mirësjellja, edukata dhe respekti.

Besimi në botën tjetër forcon ndjenjën e përgjegjësisë në zemra dhe nxit përpjekjet për kryerjen me përpikëri të detyrave dhe përgjegjësive. Dijenia se Allahu vëzhgon vazhdimisht, se veprat regjistrohen çdo çast dhe se në botën tjetër do të merremi në llogari, mundëson që të fitohet ndjenja e ruajtjes nga veprimet e palejueshme, qoftë edhe aty ku nuk na sheh askush. Ndërsa veprat e mira që bëhen larg syve të njerëzve janë më të suksesshme në arritjen e misterit të “sinqeritetit”. Prandaj, kohët dhe rastet e tilla, konsiderohen si mundësi të mëdha për fitimin e kënaqësisë së Allahut. Në këtë mënyrë,

1. - Çiktim Erik Dalina, Istanbul 2012, fq. 60.



njeriu bëhet një krijesë e pastër, të cilit i besohet në çdo lloj situatë.

Nga ana tjetër, Ahireti është një botë, ekzistenca e së cilës është e domosdoshme edhe për shtypësit, edhe për të shtypurit, edhe për të këqijtë, edhe për të mirët. Kjo, sepse nuk ka asgjë më të natyrshme se shpërblimi i të mirëve dhe ndëshkimi i të këqijve. Njëlloj funksionon edhe në kushtet e kësaj bote. Nëse nuk do të kishte vend ku të strehoheshin të mirët dhe burgje ku të burgoseshin të këqijtë, jeta do të bëhej e padurueshme. Madje, vetëm për hir të kësaj urtësie, është i domosdoshëm edhe besimi në ekzistencën e Ahiretit.

Nga një anë, njeriu dëshiron ta ndëshkojë edhe një mizë që e pickon, e nga ana tjetër, një kafë e mban mend për vite me radhë. Prandaj është e kotë të mendosh se sjelljet negative apo pozitive gjatë një jete mund të ngelen pa marrë shpërblimin e tyre tek Allahu i Madhëruar, sepse në këtë botë ekziston mizoria e mizorit, rënkimi i të shtypurit, mohimi i mohuesit dhe besimi i besimtarit. E nëse nuk do të ekzistonte shpërblimi dhe ndëshkimi i këtyre sjelljeve, programi hyjnor që ka vënë gjithçka në shërbim të njeriut do të ishte i pakuptimtë dhe krijimi i njeriut do të ishte i kotë, gjë e cila nuk përputhet aspak me cilësitë e larta të Allahut, “**el-Adl**”² dhe “**el-Hakim**”³. Mirëpo, Allahu i Madhëruar është larg prej çdo të mete dhe për rrjedhojë ai nuk do t’i bënte kurrë padrejtësi robit të Vet dhe nuk do të vepronte asgjë pa një urtësi të caktuar.

Në Kuranin Fisnik shprehet qartë:

“Ne nuk e kemi krijuar kot qiellin, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre. Kjo është hamendja e jobesimtarëve; prandaj mjerë jobesimtarët kur të hidhen në zjarr! A t’i trajtojmë njëlloj ata që besojnë e bëjnë vepra të mira dhe turbulluesit në Tokë?! A t’i trajtojmë njëlloj njerëzit e devotshëm dhe njerëzit e mbrapshtë?!” (Sad, 27-28.)

“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata! Allahu i krijoi qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë,

2. - el-Adl: I Drejti

3. - el-Hakim: I Urtri

në mënyrë që çdo njeri të jetë i shpërbleyer për atë që ka punuar. E, askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.” (Xhathije, 21-22.)

Pra Allahu i madhëruar do t’i shpërblejë të mirët dhe do t’i ndëshkojë të këqijtë në botën tjetër. Po sipas Kuranit:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë” (Zelzele, 7-8.)

Ndërsa në suren Lukman urdhërohet:

“O djali im, Allahu do ta nxjerrë në shesh edhe veprën që peshon sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë. Me të vërtetë, Allahu njuh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.” (Lukman, 16.)

Përveç kësaj, njerëzit, prej zemrave të të cilëve është fshirë mendimi për botën tjetër dhe frikë-respekti ndaj Allahut të Madhëruar, është e sigurt se do të bëhen adhurues të interesave dhe qëllimeve të veta, duke u bërë kështu elementët më të dëmshëm të kësaj bote. Në syrin e njerëzve të tillë, përgjegjësitë fetare, morale e shpirtërore, dashuria për atdheun dhe njerëzit, janë gjëra qesharake. Aftësia dhe talenti më i madh, për këta moskokëçarës, është vetëm mashtrimi i njeriut.

Lidhur me problemet e personalitetit dhe karakterit të atyre që nuk besojnë në botën tjetër, Allahu i Madhëruar na jep këtë shembull në Kuranin Fisnik:

“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit!..” (Bekare, 264.)

Gjithashtu, tentativa për të dobësuar mendimin e fesë dhe të Ahiretit tek njerëzit është një veprim shumë i rrezikshëm që mund t’i çojë shoqëritë drejt shkatërrimit. Shembuj të tillë janë vërejtur shumë, si në të shkuarën e largët, ashtu edhe në të afërtën.

Duhet theksuar se tek besimtarët që i besojnë botës tjetër dhe e rregullojnë jetën e tyre sipas këtij besimi, pavarësisht shqetësimit për dhënien e frymës së fundit me besim, nuk ekziston “frika nga vdekja”. Ideali për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe

për të arritur paqen e përrjetshme, e ndihmon njeriun ta jetojë jetën e tij në mënyrë të plotë dhe i jep edhe forcën për të duruar vuajtjet dhe vështirësitë e kësaj bote. Në fakt, kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote nuk arrijnë ta kënaqin kurrë shpirtin e njeriut, sepse paqja e shpirtit gjendet në kënaqësitë e larta shpirtërore të cilat fitohen në sajë të besimit.

Nisur nga kjo, në shumë ajete lidhur me vdekjen dhe Ahiretin, përdoret fjala, *"lika"* (likauallah, likau'l-ahira), në kuptimin *"takim me Allahun, arritje në Ahiret"*:

"Kush shpreson takimin e Allahut, ta dijë se Dita e caktuar nga Ai do të arrijë. Ai dëgjon dhe di gjithçka." (Ankebut, 5.)

Domethënë se sado që vdekja është një ndarje e hidhur dhe plot mall për ata që mbeten pas, për zemrat besimtare është një shkak që siguron shpëtimin e shpirtit nga kafazi i trupit, kalimin nga e përkohshmja në të përhershmen dhe kthimin prej kurbetit në takimin me të Dashurin.

Gjithashtu, pa përpjekjet për t'u kthyer me shpirt të qetë dhe me nder tek Ai të cilit i takojmë, është e pamundur të flitet për ndonjë sukses në këtë botë. Lidhur me ata që nuk i besojnë Ahiretit, në Kuranin Fisnik thuhet:

"Kush janë më të padrejtë se ata që trillojnë gënjeshtër për Allahun? Ata do të sillen para Zotit të tyre, e dëshmitarët do të thonë: «Këta janë ata që kanë gënjer kundër Zotit të tyre. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët, të cilët pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe përpiqen ta shtrembërojnë atë, ndërsa vetë nuk besojnë në botën tjetër.»" (Hud, 18-19.)

"Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me Allahun! Kur Ora (e Kiametit) t'u vijë papritur, ata do të thërrasin: «Të mjerët ne, sa shumë që e kemi neglizhuar (Kiametin) në jetën e Tokës!» dhe do të bartin gjynahet e veta mbi shpinat e tyre. Eh, sa e shëmtuar është ajo barrë!" (En'am, 31.)

"O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë." (Nisa, 136.)

SI E FTON ALLAHU I MADHËRUAR PARA VETES ROIBN E TIJ?

Allahu i Madhëruar i fton robërit e tij në Daru's-Selam, pra në Xhenetin e Tij, që është vendi i shpëtimin dhe lumturisë. Por sigurisht që çdo ftesë ka edhe kushtet e pranimit sepse çdo mirësi e ka një

çmim. Në Xhenet mund të hyhet vetëm me zemër të pastër, të ndritshme e të purifikuar. Kjo pastërti zemre është viza e hyrjes në Xhenet.

I nderuari Ebu'l-Hasan Harakani thotë:

"Allahu i Madhëruar ju dërgoi të pastër në këtë botë, prandaj mos dilni të papastër para Tij!" (Harakani, Nuru'l-Ulum, fq. 258.)

Megjithëse njeriu e ka burimin nga uji i turbullt, kur lind ai ka aromë të këndshme, sy të përdritur dhe aftësi për të paqtuar zemrat. E gjitha kjo zë fill prej të qenit të tij i pafajëshëm dhe i pastër nga gjynahet. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar dëshiron që ne të mbetemi të dëlirë ashtu siç jemi dërguar në këtë botë, të bëjmë një jetë të pastër, të kemi librin e punëve të panjollësuar dhe të kthehemi përsëri tek Ai me zemër të kulluar.

Në Xhenetin e bukurive nuk mund të hyhet me papastërtinë e gjynaheve. Gjynahet janë njolla që nxijnë zemrën dhe shumimi i këtyre njollave bëhet shkak i verbimit të syrit të zemrës, gjë e cila çon në humbjen e kujdesit ndaj haremeve.

Omer ibn Abdulazizi ka thënë:

"Haramet janë zjarr. Dhe drejt tyre e zgjasin dorën vetëm ata që kanë zemra të vdekura. Nëse ata që i zgjasin duart do të kishin zemra të gjalla, patjetër që do ta ndjenin nxehtësinë djegëse të atij zjarri."

Zemrat të cilat nxihen nga gjynahet janë të verbra edhe ndaj dritës së të vërtetës. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik sqarohet:

"..Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor." (Haxh, 46.)

"Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë." (Isra, 72.)

"Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër." (TaHa, 124.)

"Ai do të thotë: «O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?»" (TaHa, 125.)

"(Allahu) do t'i thotë: «Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato, e po kështu sot do të jesh i harruar.»" (TaHa, 126.)

Shkurtimisht, ata që vijnë vërdallë me fytyra të vrenjtura e të ftohta, duke luajtur me indiferencë në shkollën e sprovave hyjnore brenda së cilës jetojnë, në botën tjetër do të jenë përjetësisht të verbër. Ndërsa ata, të cilëve u është verbuar syri i zemrës nga errësitat e gjynaheve, nuk mund ta gjejnë rrugën e Xhenetit për tek i cili na fton Allahu

i Madhëruar. Është e domosdoshme që para Allahu të dalim me zemër të pastër. Edhe Profeti ynë (a.s.) e ka bërë të ditur rrugën që do t'i bëjë dobi robit në botën tjetër:

“Allahu i Madhëruar nuk shikon pamjen dhe pasurinë tuaj, por zemrat (sinqeritetin dhe devotshmërinë) dhe veprat tuaja.” (Muslim, Birr, 34.)

Gjatë leximit të Kuranit Fisnik do të vërejmë se Allahu i Madhëruar i fton robërit e Vet të dalin para Tij me **“kalb-i selim”, “kalb-i munib”** dhe **“nefs-i mutmainne”**. Më poshtë po sqarojmë pak më gjerësisht keto tre terma:

Kalb-i selim, është zemra e ruajtur nga prirjet egoiste dhe sulmet e tyre, ose e pastruar nga rëndesa e gjynaheve. Në Kuran theksohet:

“Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shu'ara, 88-89.)

Në këtë botë të përkohshme, e cila është ara e mbjelljes së Ahiretit, njeriu duhet të përpiqet të përmbushë kushtin që Allahu i Madhëruar vlerëson më së shumti - “kalb-i selim / zemrën e pastër”, me qëllim që të arrijë shpëtimin e përjetshëm. Për arritjen e nivelit të “kalb-i selim”, pikësëpari është kusht që në zemër të zërë vend një besim i cili përjetohet me dashuri e pasion, sepse vetëm në këtë mënyrë adhurimet mund të kryhen me përkushtim të lartë, në kuadër të harmonisë zemër-trup. Adhurimet që kryhen në këtë mënyrë janë vitamina për shpirtin.

Niveli “kalb-i selim”, të cilin Allahu i Madhëruar ia ka falur njeriut bashkë me natyrën e tij të pastër dhe ia ka lënë amanet, arrihet vetëm me pastrimin e egos dhe dëlirjen e zemrës. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar numëron disa cilësi të besimtarëve të vërtetë që zotërojnë nivelin “kalb-i selim”:

“...Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe ibndjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë!”

Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, fërgëllojnë kur përmendet Allahu dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten!.. (Po ashtu edhe) *Ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë. Njëmend, ata janë besimtarë të vërtetë. Ata do të kenë shkallë përnderimi te Zoti i tyre, falje dhe furnizim bujar (në Xhenet).”* (Enfal, 1-4.)

Kalb-i munib, është zemra që drejtohet përherë nga Zoti dhe në çdo situatë gjen të vërtetën dhe të mirën. Kjo zemër e ndan qartë të mirën nga e keqja, tregon gjithmonë rrugën e drejtë me të cilën është

i kënaqur Allahu dhe vrapon drejt kënaqësisë së Allahut, sa herë që i jepet mundësia. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“(Do t'u thuhet:) «Kjo është premtuar për ju, për këdo që është penduar dhe ruajtur (nga gjynahet), që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga Allahu).»” (Kaf, 32-33.)

Nefs-i Mutmainne, është nefsi/egoja, e cila duke zbatuar siç duhet urdhrat e Allahut të Madhëruar dhe duke u ruajtur me kujdes prej ndalesave të Tij, ka shpëtuar prej sëmundjeve shpirtërore, ka gjetur paqen në besimin e vërtetë e të fortë dhe ka arritur të jetë e qetë dhe e kënaqur. Zemra është dëlirur prej dyshimeve dhe ngurrimeve me anë të begatisë së përmendjes së Allahut dhe në çdo çast falënderon dhe madhëron Allahun.

Në këtë gradë, cilësitë e shëmtuara e të këqija ia lënë vendin moralit të mirë. Po ashtu, në këtë gradë përjetohet mrekullisht, me një kënaqësi të papërshkrueshme, morali i lartë i Profetit tonë (a.s.), i cili përbën majën e pjekurisë së sjelljeve dhe është shembull për të gjithë njerëzimin. Në këtë pikë zemra e njeriut kurorëzohet me durim, mbështetet tek Allahu, dorëzohet dhe kënaqësi.

I nderuari Sami Efendi ka thënë:

“Mundësia e hyrjes në Islam, në kuptimin e plotë të fjalës, varet nga eliminimi i nefsit emmare dhe ndjekja me përpikëri e urdhrave hyjnorë. Islami që pranohet vetëm me zemër, para se të arrihet grada e nefsit mutmainne, quhet “Islam mexhazi/figurativ”, ndërsa besimi që arrihet pas ngritjes së nefsit/egos në gradën mutmainne, quhet “besimi i vërtetë”⁴

Në këtë gradë asgjësohet perdja e trashë njerëzore që pengon shikimin dhe shfaqet drita e së vërtetës.

Nefsi në këtë gradë, ka merituar edhe përmendjen në instancat hyjnore me fjalët:

“O ti nefsi (ego, person, shpirt) i qetësuar!” (Fexhr, 27.)

Siç theksohet edhe në ajetin e mësipërm, për shkak të kënaqësisë së qëndrueshme që ky nefsi ndjen ndaj Zotit të tij, ka fituar edhe kënaqësinë dhe pëlqimin e Zotit të vet. (shih. Fexhr, 28.)

...

4. - M. Sami Ramazanoglu, Musahabe, c. I, 127-129, Istanbul 2008.



EL-LATIF

BAMIRËSI I BUTË

— Ilir Hoxha —

Ky është një prej emrave të mëdhenj të Allahut, i cili nxit të besojmë në fuqinë e Zotit tonë, të vlerësojmë mirësitë e Tij dhe të ndjejmë mirënjohje të thellë ndaj butësisë së Tij. Allahu i Madhëruar kupton ndjenjat tona më të thella, njeh hallet tona më të fshehta, të cilat nuk ia tregojmë askujt dhe, kur bën mirësi, e bën me butësinë më të jashtëzakonshme dhe mënyrat më të paparashikueshme.

Feja madhështore që zbriti Allahu dhe Profeti i Tij (a.s.), janë mirësitë më të mëdha për ne. Po ashtu, çdo njeri me mendje të shëndoshë e di dhe e pranon se, edhe paralajmërimi në lidhje me rrugën mbi të cilën po ecim dhe rreziqet që përmban ajo, është një mirësi e madhe hyjnore.

Shkurtimisht, “el-Latif”, është Ai që ka dijani për çdo gjë dhe bën mirësi në mënyrë të pakufishme. Dhe, besimi i patundur se Ai njeh çdo gjendje tonën, na ndihmon dhe na i largon vështirësitë kur dëshiron dhe se këtë e bën me butësi të jashtëzakonshme, na fal qetësi shpirtërore.

Emri “Latif” kalon shtatë herë në Kur’anin Fisnik. Në pesë vende prej tyre përdoret së bashku me emrin “el-Habir”. (shih. En’am, 103; Haxh, 63; Mulk, 13-14; Lukman, 16; Ahzab, 34.) Arsyeja që në këto ajete pas emrit Latif vjen menjëherë emri Habir (Ai që e njeh çdo gjë me detajet më të fshehta), tregon se sa me vend janë mirësitë e Tij, sepse këto mirësi po i bën Ai që njeh çdo gjë në detaj. Kjo e vërtet na pengon të ndihemi të dëshpëruar dhe të humbasim

shpresat. Siç dihet, një nga kushtet më të rëndësishme të shëndetit shpirtëror, është mbajtja gjallë e shpresës. Kurse dëshpërimi absolut, është pranuar si mohim i Zotit, për shkak se përmban mendim të keq në lidhje me Allahun.

Në historinë e Jusufit (a.s.), tregohet shumë bukur se në çfarë mënyrash të jashtëzakonshme i ndihmon Zoti robërit e Vet. Në pjesën ku gjithçka përfundon dhe Jusufi (a.s.), arrin rezultatit e bukur pas gjithë vështirësive që kishte kaluar, bëhet një lidhje me emrin “el-Latif”. (shih. Jusuf, 100.) Kjo sure, e cila ka zbritur në ditët më të errëta të periudhës së Mekës, gdhend në zemrat e besimtarëve idenë se shpresa tek Allahu nuk duhet humbur kurrë dhe shpales para të gjithëve përmbajtjen e emrit Latif. Nisur nga kjo, ata që kanë pësuar fatkeqësi, në vend që t’i mërzhiten fatit në mënyrë pesimiste, duhet të punojnë sa të kenë mundësi dhe të mos e humbasin shpresën prej mirësisë së Allahut. Jeta e Jusufit (a.s.), është shembull i këtij botëkuptimi nga fillimi deri në fund. Allahu është Latif dhe padyshim se do të bëjë mirë. Por, sipas ligjeve të Tij, kjo mirësi pret që njeriu të vërë në pah përpjekjen dhe orientimin e vet. Ajo që i bën njerëzit të dyshojnë ndaj mënyrës së bamirësisë së Allahut, është fakti se ndonjëherë ato vijnë bashkë me vështirësi e vuajtje. Mirëpo, ata që nuk arrijnë të kuptojnë se në këtë botë në çdo mirësi fshihet një dhimbje dhe se në çdo dhimbje fshihet një mirësi, dyshojnë në manifestimin e emrit el-Latif. Në këtë mënyrë, ata



humbasin në vuajtje dhe nuk arrijnë t'i nxjerrin dot mirësitë prej situatave që përjetojnë.

Nëse ndonjëherë është mirësi të japësh, ndonjëherë është mirësi të mos japësh. Por, të arrish të shohësh mirësinë tek ato që nuk i jep Allahu, është e mundur vetëm në sajë të besimit të plotë ndaj Tij. Kushti i parë i besimit të robit ndaj Zotit të vet, është mos humbja e aftësisë së besimit në thellësi të botës së tij të brendshme. Ndërsa kushti i dytë, është njohja e Zotit të Madhëruar, mundësisht me të gjitha emrat e Tij.

Studiuesit thonë se ajo që e zhvillon, ose e shkatërron kapacitetin e besimit të njeriut, është trajtimi që ai ka marrë prej më të afërmeve në vitet e para të jetës së tij. Ne duhet ta dimë se gabimet që mund të bëjmë ndaj fëmijëve tanë në periudhën e foshnjërisë, mund të bëhen shkak i humbjes së besimit të tyre tek ndaj jetës, njerëzve dhe madje edhe ndaj Allahut, sepse kjo ua shkatërron atyre aftësinë për t'u kapur pas një besimi. Për rrjedhojë, që fëmijët të kenë besim tek mirësitë e Allahut kur të rriten, ata duhet formojnë një marrëdhënie të fortë besimi me prindërit e tyre në fëmijëri.

Siç e thamë edhe më sipër, njerëzit që kanë besim të plotë tek Allahu dhe i janë dorëzuar Atij, i shohin edhe mirësitë e fshehura në hidhërime dhe shkojnë drejt tyre. Pra, siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), ata dinë të dalin të fituar prej çdo situatave.

Në të njëjtën kohë, një besimtar i cili arrin t'i

ndërthurë emrat e Allahut, Latif dhe Habir, e braktis çdo lloj falsiteti dhe përpiket të jetë i singërtë. Kështu, ai që arrin ta pastrojë botën e tij të brendshme karshi Allahut, bëhet një njeri që mendon mirë për të gjithë botën dhe sillet me butësi ndaj të gjithëve. Siç shprehet edhe Gazaliu, ata që e pajisin moralin e tyre me manifestimin e këtij emri, nuk ndjehen, nuk thyjnë zemrat dhe nuk ulin dinjitetin e të tjerëve kur u bëjnë mirësi atyre. Ata sillen me butësi ndaj robërve të Allahut, sidomos kur i ftojnë ata në rrugën e Tij. Në të njëjtën mënyrë, ashtu siç i shpërblen Allahu i madhëruar me xhenet mirësitë e kufizuara që bëhen në këtë jetë të shkurtër, ashtu edhe ata i shpërblejnë në mënyrë të bollshme përpjekjet dhe mundin e njerëzve që kanë në kujdesin e tyre.

Çdo gjë që shohim në gjithësi, bukuria dhe estetika që ndodhet në natyrën e njeriut, janë të gjitha manifestime të emrit hyjnor el-Latif. Për këtë arsye, botëkuptimi Islam ndaj bukurisë, përmban edhe butësinë. Ajo që nuk është e butë, nuk është as e bukur. Ashtu siç manifestohet në fytyrën dhe pamjen e njeriut, butësia manifestohet edhe në fjalët e tij. Për rrjedhojë, fjalët e atij njeriu kanë butësi që ngrohin zemrat.

Si përfundim, çdo krijesë është mirësi e Allahut. Kush dëshiron mirësi prej Allahut, duhet të shohë mirësitë në çdo ngjarje dhe duhet të dijë se çdo gjë që ndodh varet prej butësisë së vet... kjo, sepse kush sillet me butësi, meriton më tepër mirësi.



MUHAMED I

i lartësuar në Kuran

— Imam Muhamed B. Sytari —

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të gjithësisë, i Cili e begatoi jetën tonë me udhëzimin në Islam, nëpërmjet të cilit na bëri vëllezër, kudo qofshim; shqiptarë e joshqiptarë, arabë e axhemë; të gjithë të begatuar me mëshirën dhe bujarinë e Zotit të botëve, i Cili urdhëron e thotë në Kuranin Famëlartë: “E, s’ka dyshim se ata që thanë: “Allahu është Zoti ynë”, dhe ishin të paluhatsëm, atyre u vijën engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos u frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhide xhenetin që u premtohet. Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, kudo të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkoni.”. (Fussilet, 30-31)

“ËSHTË E VËRTETË SE ALLAHU U DHA DHURATË TË MADHE BESIMTARËVE, KUR NDËR TA NGA MESI I TYRE DËRGOI NJË TË DËRGUAR QË ATYRE T’U LEXOJË SHPALLJEN E TIJ, T’I PASTROJË ATA, T’UA MËSOJË LIBRIN DHE URTËSINË, EDHE PSE MË PARË ATA ISHIN KREJTËSISHT TË HUMBUR”.

(AL IMRAN, 164)

Të gjitha salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot e mot, Ma të Mirit e ma të Shtrenjtit, Zotërisë së bijve të Ademit, të dërguarit mëshirë për mbarë botët, për të cilin, Allahu i Madhëruar urdhëroi në Kuranin Famëlartë: “Është e vërtetë se Allahu *u dha dhuratë të madhe besimtarëve*, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi një të dërguar që atyre t’u lexojë shpalljen e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur”. (Al Imran, 164)

A ka vlerësim më të madh, sesa të të konsiderojë Zoti i gjithësisë, si *dhuratë* nga ana e Tij (xh.sh)! Njëkohësisht, i shpalli mbarë universit, me krejt krijesat e tij deri në ditën e gjykimit se, Muhamedi (a.s.) është i dërguar: “mëshirë për mbarë botrat”. (Enbija, 107)

Mbi këtë udhëzim hyjnor, Resulullahu (a.s.) tha për veten e tij: “Unë jam mëshirë e dhuruar”. (Hakimi, nga Ebu Hurejra -r.a.-)

Allahu i Madhëruar, urdhëron dhe thotë në ajetin e katërt të sures Inshirah: “*Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde*”. Është një ajet i shkurtër, në kontekstet e një sureje të shkurtër, që vjen menjëherë pas një sures Duha, në të cilën Allahu i Madhëruar vetëm se i dëshmon botës përkujdesjen dhe dashurinë e Tij të madhe për të Dërguarin e Tij, Muhamedin (a.s.), të cilit i drejtohet me këto fjalë: “*Pasha pa-*

raditen! Pasha natën kur shtrinë errësirën! Zoti yt nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur. Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para. E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh. A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend (të dha përkrahje). Dhe të gjeti të pa udhëzuar e Ai të udhëzoi. Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi. Pra, mos e përul jetimin! As lypësin mos e përzë! E për të mirat që t'i dha Zoti yt, trego (udhëzo njerëz)!” (Duha, 1-11)

Pas kësaj sureje vijoi me shpalljen e sures Inshirah: *“A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd? Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde, e cila shtypte shpinën tënde. Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde? E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi! E kur ta kryesh (obligimin e thirrjes), mundohu me adhurim (Allahut). Dhe, vetëm te Zoti yt përqendro synimin!”*. (Inshirah, 1-8)

Me një vështrim të shpejtë dhe të përgjithshëm, nëpërmjet përmbajtjes së këtyre dy sureve kuptojmë qartë pozitën e lartë të Muhamedit (a.s.) tek Zoti i gjithësisë! Për këtë, i drejtohet në suren Nisa, duke i thënë: “Dhuntia e Allahut ndaj teje është shumë e madhe!”. (Nisa, 113)

Disa prej studiuesve të Kuranit, kanë grumbulluar ajetet ku përmendet emri dhe personi i Resulullahut (a.s.) dhe kanë dalë në rezultatin befasues se, Allahu (xh.sh.) e përmend dhe i drejtohet plot **2672** herë Resulullahut (a.s.) në Kuranin Famëlartë! Allahu Ekber! Vetëm në dy suret e lartpërmendura përmendet 27 herë! 27 herë në 19 ajete!

Kur Allahu i Madhëruar përshkroi Hënën, tha për të në suren Furkan: (*kameren munira*) *“hënë që ndriçon”*. (Furkan, 61) Kur përshkroi Diellin, tha për të në suren Nebe’: (*siraxhen vehhaxha*) *“pishtar që flakëron”*. (Nebe’, 16) Por, kur e përshkroi Resulullahun (a.s.) tha për të në suren Ahzab: (*siraxhen munira*) *“pishtar ndriçues”!* (Ahzab, 46) Pra, bukuri dhe madhështi!

Të ndalemi pak tek ajeti i pestë i sures Inshirah, ku Allahu i Madhëruar i drejtohet të Dashurit të Tij (a.s.) duke i thënë: *“Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde”*. (Inshirah, 4) Të shohim se çfarë kanë thënë komentuesit e Kuranit rreth këtij ajeti dhe kuptimeve të tij të mëdha.

Thotë **Imam Kurtubiu** në tefsirin e këtij ajeti: “Transmetohet nga Dahhaku, nga Ibn Abbasi (r.a.), që thoshte: “Allahu i Madhëruar i thotë nëpërmjet këtij ajeti: *Kudo që të përmendem, do të përmendesh më Mua; në ezan, në ikamet, në teshehud, ditën e xhuma në minbere, ditën e Fitrit, ditën e Kurbanit, në ditët e teshrikut, ditën e Arefatit, tek xhemeratet, në Safa e Merva, në hytben e martesës, në lindje e në perëndim”*.

Dhe dije se, nëse një person e adhuron Allahun e Madhëruar, duke e besuar xhenetin, xhehnemin dhe çdo gjë tjetër, por duke mos dëshmuar se Muhammedi është i Dërguar i Allahut, nuk do të kishte asnjë dobi nga krejt që u përmend dhe do të ishte prej femohuesve!

Poashtu kanë thënë: *E lartësuam përmendjen tënde*, duke të përmendur në krejt librat e shpallur të dërguarve para teje, sikurse i urdhëruar ata që të jepnin sihariq për ardhjen tënde!

...

Poashtu kanë thënë: *E lartësuam përmendjen tënde* tek melekët në qiell dhe në tokë tek besimtarët! Edhe në ahiret do ta lartësojmë përmendjen tënde, duke të dhënë pozitën e lavdëruar dhe shkallët më të larta”.¹

Nga kjo pozitë e lartë, sahabët interesoheshin që të kërkonin nga i Dërguari i Allahut (a.s.) që të lutej për ta dhe të binte salavate bekuese për ta. Transmeton Ibn Ebi

1. Ebu Abdull-llah Muhammed Ibn Ahmed El-Ensari El-Kurtubi (v. 671 h.), *El-Xhamiu li ahkamil-Kur'an*, botimi i dytë, 1996, Kajro, Darul-Hadith, vëll. 20, f. 107.

Shejbe nga Xhabiri (r.a.), që thotë: Na erdhi Resulullahu (a.s.) për vizitë, kur gruaja e ime i tha: Ja ResulAllah, lutu për mua dhe për burrin tim! Ai tha: “*Sal-lAllahu alejki ve ala zeuxhiki*”, pra: “Allahu të bekoftë ty dhe burrin tënd!”²

Imam Neseфи në tefsirin e tij sqaron se prej lartësimit që i është bërë emrit të Muhamedit (a.s.) në Kuran është edhe: “përmendja e tij; Resulullah dhe Nebijull-llah, si dhe përmendja në Librat e mëparshëm”³

Ndërsa **Imam Ibn Ashuri**, teksta shpjegon suren “Inshirah”, ku ndodhet ky ajet, thekson se: “Kjo sure përfshin përmendjen e përkujdesjes së Allahut të Madhëruar ndaj të Dërguarit të Tij (a.s.), me butësinë e Allahut ndaj tij dhe largimin e hallit dhe sikletit prej tij, si dhe lartësimin e pozitës së tij, për ta lehtësuar...”⁴

Pastaj, shpjegon gjithashtu: “Transmetohet nga Hasan Basriu të ketë thënë: Ia hapi gjoksin duke ia mbushur me dije dhe urti! Ndërsa Sehl Tusturiu ka thënë: Ia hapi gjoksin me dritën e Mesazhit!”⁵

“A ka lartësim më të madh sesa ta përzgjedhë Allahu për Mesazhin e Tij, për të shpëtuar njerëzimin nga errësirat në dritë, me lejen e Tij, si dhe t’i udhëzojë në rrugën e Krijuesit Fuqiplotë!”⁶, shkruan **Shejkh Reshid El-Khatib** në tefsirin e tij të këtij ajeti.

Thirrësi i shquar bashkëkohor, **Dr. Ratib Nabulsi**, në tefsirin e këtij ajeti, ndër të tjera shkruan: “Allahu i Madhëruar e lartësoi përmendjen e tij (Muhamedit); në Dy dëshmitë, në ezan, në ikamet, në namaz, ku thua: Eshhedu en la ilahe il-Allah ve eshhedu enne Muhammeden Resulullah, në Kuran, ku thotë: “Binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij”⁷. Pra, kudo ku përmendet Allahu i Madhëruar, përmendet me Madhërinë e Tij edhe i Dërguari (a.s.)! A ka pozitë më të lartë se kjo pozitë? ...

Pas një mijë e katërqind vitesh nga ndërrimi jetë i tij (a.s.), kur afroresh pranë varrit të tij, të rrëqethet trupi dhe e ndjen se vetvetiu të vjen të qash, edhe pse nuk je takuar asnjëherë me të, as e ke parë me sytë e tu, as e ke shoqëruar, por thjeshtë ke

dëgjuar për të dhe plotësinë e tij, për thjeshtësinë e tij, për butësinë e tij, për zemërgjerësinë e tij. Ky është kuptimi i parë i lartësimit (që i ka bërë Allahu i Madhëruar emrit dhe famës së të Dërguarit të Tij): E kam ngjitur emrin tënd me emrin Tim, o Muhamed!”⁸

Teksa e sjell nëpër mend atë që ke dëgjuar e lexuar për të Dërguarin tënd, të mbushet zemra me mallëngjim dhe vetvetiu nis të kërkosh për rrugët që të afrojnë me shembullin e tij, derisa arrin në një gradë, për të cilën, vetë i Dërguari i Allahut thoshte: “Ata, që më së shumti më duan nga ymeti im, janë një popull pas meje. Do të dëshironte ndonjëri prej tyre të jepte familjen dhe pasurinë e tij, vetëm të më shihte”⁹

“Kuptimi i dytë: E lartësuam përmendjen tënde, e bëmë fjalën tënde të shenjtë, të bëmë të interesohesh dhe të jepesh pas gjërave të larta në jetë, jo pas gjërave të vogla! Vini re, se si secili njeri e ka një prirje në jetë, pas së cilës merr edhe famën e tij. Shoqërohu me një person për ca orë; ai do të të flasë për tregtinë, për industrinë, sepse kjo është prirja e tij në jetë! ... Ndërsa i dërguari i Allahut (a.s.) u lartësua mbi krejt prirjet e kësaj bote materiale, e lartësoi Allahu famën e tij, e shenjtëroi fjalën e tij, sepse prirja dhe fjala e tij ishte për Zotin e tij!”¹⁰

Nëse jeni të vëmendshëm, do të gjeni se i dërguari i Allahut, edhe kur është lënduar personalisht, nuk ka mallkuar, porse është lutur, me shpresën që Allahu i Madhëruar të udhëzojë popullin e tij. Për këtë, kemi rastin e ndodhisë në Taif, rastin e lëndimit tekta falej me kokë në sexhde para Qabes së Madhnueshme, rastin kur i kërkuan të mallkonte armiqtë e tij, kur i kërkuan të mallkonte fisin Deus nga Jemeni, etj., pa fund! Në të gjitha rastet, ai u lut për popullin e tij, për armiqtë e tij, për Deusët, por jo vetëm!

Kemi shumë se çfarë të mësojmë nga kjo sjellje e Resulullahut (a.s.), sidomos në marrëdhëniet tona me njëri-tjetrin, si muslimanë, pastaj edhe me pjesën tjetër të shoqërisë, që e kemi për detyrim të dyfishtë t’i dëshmojmë më të mirën e shembullit

2. Abdull-llah Siraxhiddin, *Et-Tekarrubu ilall-llah*, botimi i parë, 1991, Haleb, Mektebetu Daril-Felah, f. 79.

3. Ebul-Berekat Abdull-llah Ibn Ahmed Ibn Mahmud En-Neseфи (v. 710 h.), *Tefsirun-Neseфи*, botimi i shtatë, 2017, Damask-Bejrut, Dar Ibn Kethir, vëll. 3, f. 657.

4. Muhammed Et-Tahir Ibn Ashur (v. 1394 h.), *Et-Tahrir vet-Tenvir*, botimi i parë, 2000, Bejrut, Muessesetut-Tarikh, vëll. 30, f. 359.

5. Po aty, f. 360.

6. Shejkh Reshid El-Khatib El-Meusili, (v. 1400 h.), *Tefsirul-Kur’anil-adhim*, botimi i parë, 2014, Aman, Ervika, vëll. 8, f. 280.

7. Kur’ani, El-Enfal: 46.

8. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi (jeton në Aman të Jordanisë), *Tefsirun-Nabulsi*, botimi i parë, 2016, Aman, Muessesetut-Fursan, vëll. 10, f. 404.

9. Ahmedi në “El-Musned”, nga Ebu Dherri (r.a.) (1060). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Ky hadith është prej mrekullive të tij (a.s.), kur ka folur për të panjohurën... Kjo i ka ndodhur shumë prej sufive të mëdhenj, që janë lartësuar në gradën e shikueshmërisë së tij (a.s.) në vazhdimësi. *Thotë Arif El-Mursi*: “Pasha All-llahun, sikur të fshihej prej meje pamja e Resulull-llahut (a.s.), sa hap e mbyll sytë, nuk do ta konsideroja më veten prej muslimanëve!” - Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 649).

10. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, vep., e cit., vëll. 10, f. 404.

të Resulullahut (a.s.) në sjelljen dhe komunikimin tonë!

“**Kuptimi i tretë** (i lartësimit): Është fakti se, Allahu i Madhëruar e ka marrë përsipër komunikimin për të Dërguarin e Tij, për të cilin thotë: “**Ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kurani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet**”. (Nexhm, 3-4)

Transmeton Ebu Davudi nga Abdullah ibn Amri (r.a.), që thotë: [Shkruaja çdo gjë që dëgjoja nga Resulullahu (a.s.), doja ta mësoja përmendësh. Por, kurejshitet më ndaluan dhe më thanë: A e shkruan çdo gjë që e dëgjon nga Resulullahu (a.s.); ai është njeri, që flet edhe kur është nervoz, edhe kur është i qetë!? Kjo më frenoi nga shkrimi. Pastaj ia tregova këtë gjë Resulullahut (a.s.), i cili bëri me gisht nga gjuha tij dhe tha: “Shkruaj se, pasha Atë që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, nga kjo nuk del, vetëm se e vërteta!”].

Kjo gjuhë e shenjtë nuk flet, vetëm se të vërtetën; në gëzim e në hidhërim, në mërzi e në lumturi, fshehtas e haptas!

Ndërsa **kuptimi i katërt**: Është se, Allahu i Madhëruar e ka bërë Muhamedin (a.s.) derë drejt Tij! ... Natën e Israsë dhe Miraxhitai u fal imam, në krye të krejt të dërguarve të tjerë; ai ishte imami dhe udhërrëfyesi i tyre! Dhe, cilido njeri që i drejtohet Allahut nga një derë ndryshe nga dera e Resulullahut (a.s.), atij nuk i pranohet!”¹¹

Për këtë, i tha një ditë Omerit (r.a.): “... Sikur të ishte Musai gjallë, nuk do gjente rrugë tjetër, vetëm se të më pasonte mua!”¹²

Ndërsa Isai (a.s.) e porositi popullin e tij me këto fjalë, që lexohen në Kuran, deri në ditën e fundit: [Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: «O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Teuratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!»] E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: «Kjo është magji e hapët»]. (Saf, 6)

11. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, vep. e cit., vëll. 10, f. 405.

12. Transmetuar nga Bejhekiu në “Shuabul-Iman”, *hasen*, nga Xhabiri (r.a.).

I dashur lexues,

Allahu i Madhëruar është betuar në Kuranin Famëlartë: “**Pasha jetën tënde (o Muhamed)!**” (Huxhurat, 72), prandaj, edhe sikur shkruan **Hafizi Ebu Shame** (v. 665), mësuesi i Imam Neveviut: “Ndër risitë më të mira në kohën tonë, është edhe ajo që bëhet për çdo vit në ditën përkatëse të Lindjes së tij (a.s.), si ndarja e sadekave dhe shtimi i veprave të mira, shfaqja e zbukurimeve dhe e gëzimit. Kjo nxit dashurinë dhe madhërimin e tij (a.s) në zemrën e atij që e bën këtë vepër, si dhe falënderim ndaj Allahut të Madhëruar për mirësinë e madhe të krijimit të dërguarit të Tij, që e dërgoi mëshirë për krejt botët”¹³

Dhe, mbi të gjitha dhe, sikurse thoshte Shejkh Ahmed Keftaro (1915-2004), që shkruante se: “Vërtetësia e festimit me rastin e Lindjes së Muhamedit (a.s.) është të punojmë bashkarisht, baballarë e nëna, pedagogë e mësues, gazetarë e dijetarë, udhëheqës e masa të gjera, për pastrimin e shoqërisë tonë nga prezenca e helmeve, që kolonialistët përhapën në mendje e shpirta, duke prishur tek disa prej nesh edukatën dhe veprat, si dhe duke dobësuar lidhjet shoqërore në mesin e shumë prej njerëzve!”¹⁴

Dhe në mbyllje, do të citoj Hoxhën e zemrës, H. Vehbi Sulejman Gavoçi, i cili dëshmonte botërisht: “Më përmendni me dua të mirë dhe dëshmoni se unë e dua shumë Pejgamberin (a.s.), aq shumë sa nuk përshkruhet!”¹⁵

A jemi të gatshëm ta deklarojmë të njëjtën dëshmi, nëpërmjet mirësjelljes, besimit, moralit, dijes dhe urtisë, punës dhe sakrificës për ta gjallëruar traditën dhe shembullin e Resulullahut (a.s.) në jetën tonë dhe tek brezi pas nesh?

Kjo është sfidë e madhe për ne, teksa lexojmë ajetin: “**Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde**”. (Inshirah, 4)

13. Botimi i Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Islame, EBA, “Hel nahtefil”, botimi i pestë, Dubaj, 2015, f. 20-21.

14. Shejkh Ahmed Keftaro, “Min hedjil-Kur’an”, Damask, pa vit botimi, f. 214. (Tema me titull: “Lindja e të Dërguarit”, me shënimin: “Ligjëratë e mbajtur më 23/8/1961 - 12/ Rebiulevvel/1381”).

15. Vehbi Sulejman Gavoçi, “Muhammedi alejhisselam - Jeta dhe vepra”, LOGOS-A, Shkup, 2011, f. 359.



NATËN E ISRASË DHE MIRAXHITAI U FAL IMAM, NË KRYE TË KREJT TË DËRGUARVE TË TJERË; AI ISHTE IMAMI DHE UDHËRRËFYESI I TYRE! DHE, CILIDO NJERI QË I DREJTOHET ALLAHUT NGA NJË DERË NDRYSHE NGA DERA E RESULLAHUT (A.S.), ATIJ NUK I PRANOHET!





NË ISLAM nuk ka RACIZËM

— Ibrahim Shakir —

Myslmanët duhet t'i mësojnë urdhrat e Allahut, të Dërguarit të tij, (a.s.) dhe të fitojnë një shpirt vëllazëror sipas tyre, në mënyrë që të shohin se si duhet të jetë vëllazëria islame. Çdo njeri që hyn në rrethin e Islamit, është i detyruar t'i pranojë si vëllezër të tjerët. Kjo është një vëllazëri e tillë, që besimtarët nuk mund ta dëmtojnë njëri-tjetrin, as materialisht dhe as shpirtërisht.

Ata nuk mund të bëjnë klane kundrejt njëri-tjetrit dhe nuk mund të mashtrojnë. Lutën çdo ditë për njëri-tjetrin dhe nuk mund të bëjnë as ligësinë më të vogël. Kur fal namaz një besimtar, në tehiyat thotë: “Rabbena igfirlil ve livelidjeje ve li'l-mu'minin...” Në këtë mënyrë, ai lutet për faljen e të gjithë besimtarëve në ditën e llogarisë. Po ashtu, duke dhënë selam në të dy krahët në fund të namazit, lutet për besimtarët që i ka në të dy anët.

Atëherë, a mund të gjendet ligësi në shoqëri të tilla islame, që bëjnë dua çdo ditë dhe ia duan të mirën njëri-tjetrit? Allahu i madhëruar, thotë:

“Myslmanët janë vëllezër.” (el-Huxhurat 10.)

Myslmanët janë vëllezër. Në këtë mënyrë nuk

mund të bëhet fjalë për ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet tyre. Por për fat të keq, myslmanët janë përçarë shumë në pikën që kanë arritur. Njëri prej shkaqeve të kësaj përçarjeje është përçarja racore. Për shkak të racizmit, myslmanët kanë rënë në armiqësi me njëri-tjetrin dhe kanë ngritur armët. Sigurisht se kjo gjendje po përdoret nga qafirët për t'i përçarë myslmanët.

Myslmanët që janë ndarë prej rrugës së urdhëruar nga Allahu dhe i Dërguari i tij, (a.s.), duke lënë mënjanë vëllazërinë islame e duke formuar vëllazëri me baza raciste, ideologjike, politike dhe interesi, kanë hequr vuajtje të mëdha për shkak të kësaj gjendjeje dhe akoma vazhdojnë të heqin. Ata nuk po shpëtojnë dot nga vështirësitë, për shkak se nuk po bashkohen prej sëmundjes së racizmit, ndërkohë që ndërmjet tyre ka plot ndarje besimi dhe politike.

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), për të cilin themi se i kemi besuar dhe se na ka sjellë Islam, thotë:

“Kush nuk bindet, ndahet nga xhemati (dhe vdes

në atë gjendje), vdes si xhahil. Kush lufton nën një flamur në mënyrë të verbër, zemërohet për shkak të racizmit apo fton e ndihmon racizmin dhe vdes përgjatë kësaj gjendjeje, edhe ai ka vdekur si xhahil. Kush vjen në krye të umetit tim, i godet të gjithë pa bërë ndonjë ndarje ndërmjet të mirit e të keqit, nuk ka respekt ndaj besimtarëve dhe nuk e mban premtimin, ai nuk është prej meje dhe unë nuk jam prej tij.”

Xubejr b. Mutim (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Nuk është prej nesh ai që mbron racizmin, që përpiket ta përhapë dhe që lufton në rrugë të tij.”*

Prejardhja e dikujt, nuk mund ta bëjë epror atë, nëse nuk është i devotshëm ndaj Allahut, edhe nëse ajo mbështetet te pejgamberët apo çfarëdo race qoftë. Allahu nuk i jep përparësi asnjë njeriu për shkak se është nip i ndonjë pejgamberi apo se i përket filan fisi. Kështu, Allahu (xh.xh.), e qortoi pejgamberin Nuh, alejhisselam, që u brengos për birin e tij, Kenanin, duke ia bërë të qartë se ai nuk ishte prej familjes së tij.

Krahas kësaj, edhe xhaxhai i Pejgamberit, (a.s.), Ebu Talibi, u bë prej qafirëve, për shkak se nuk i besoi atij, edhe pse e rriti atë. Domethënë, vlera te Allahu caktohet vetëm me anë të veprave.

Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Nëse dikush i ka lënë veprat e mira, atë nuk e shpëton, nuk e lartëson dhe nuk e përparon dot prejardhja apo soji i tij.”*

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“O Myslimanë! Allahu i ka fshirë gabimet e kohës së xhahilijetit dhe e ka ndaluar mburrjen me baballarët. Njerëzit bëhen ose besimtarë të devotshëm, ose mëkatarë të pashpresë. Ju jeni bijtë e Ademit. Ndërsa Ademi është krijuar nga dheu. Atëherë, lëreni lavdërimin me njerëz të cilët janë lëndë djegëse e xhehenemit. Ata që nuk bëjnë kështu, janë më të ulët se brumbulli që zhytet në papastërti.”*

Vasale Ibnu'l-Eska, (r.a.), tregon:

“E pyeta të Dërguarin e Allahut (a.s.):

-O i Dërguari i Allahut! Çfarë është racizmi/nacionalizmi?

Pejgamberi u përgjigj:

-Të ndihmosh popullin në padrejtesë.”

Khundeb Ibn Abdillahu (r.a.), tregon:

“I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

‘Kush vritet duke i ndihmuar nacionalizmit nën një flamur të zakonshëm (që nuk synon lartësimin e Islamit), vdes si xhahil.’

Me çfarë fytyre do t'i japin llogari Allahut dhe me

çfarë fytyre do të pohojnë se e kanë zbatuar sunetin e Pejgamberit myslimanët që mbartin cilësitë, për të cilat i Dërguari i Allahut ka thënë se nuk janë prej nesh? Të bësh diçka që e ka ndaluar i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe të thuash se e do atë, nuk është gjë tjetër, përveçse një fjalë boshe.

Ai që e do Allahun, mundohet t'i bindet atij aq sa mundet. Ai që e do të Dërguarin e Allahut, (a.s.), përpiket ta marrë shembull atë dhe të bëjë ato që ka urdhëruar ai. Ndërsa sot, ata që bëjnë gjëra që nuk i ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i tij, lavdërohen me orientimin e Kuranit e të sunetit.

Myslimani, i çfarëdo race qoftë, është vëllai i myslimanit tjetër. Nëse kanë besuar, qofshin arabë, turq, kurdë, grekë dhe amerikanë, janë vëllezër me njëri-tjetrin. Ata janë përgjegjës për njëri-tjetrin. Edhe njëra prej dredhive që bëjnë misionarët dhe armiq të e Islamit, është stimulimi i lëvizjeve nacionaliste e raciste për të prishur unitetin e myslimanëve.

Agjenti Hempher, që punoi në kohët e fundit të perandorisë otomane, thotë: *“Ne duhet t'ua tërheqim vëmendjen myslimanëve drejt heroizmave paraislame, duke nxitur ndërmjet tyre racizmin dhe nacionalizmin. Atyre duhet t'ua forcojmë mendimet në lidhje me racizmin dhe nacionalizmin.”*

Si rezultat i këtyre punimeve, u shemb Perandoria Otomane që sundoi në tre kontinente. Radhën e parë të shkaqeve të copëtimit të Perandorisë Osmane e mbajnë përçarjet raciste e nacionaliste.

Kjo është loja që po bëhet mbi myslimanët. Kështu që, myslimanët duhet ta kuptojnë këtë lojë dhe të mos mashtrohen.

EPËRSIA ËSHTË VETËM NË DEVOTSHMËRI

Si mund të mburret njeriu, i cili, që nga lindja e deri në vdekje ka nevojë të rritet, të mbrohet dhe të sigurojë jetesën? Si mund të mburret njeriu kundrejt Zotit, ndërkohë që ka nevojë çdo çast për të dhe për krijimin e tij? Kur njeriu të meditojë rreth trupit, do të shikojë se është një krijesë nevojtare dhe se askush nuk ka nevojë për të.

Është budallallëk që njeriu të mburret e të prete ndojë për epërsi, ndërkohë që në barkun e tij mbart papastërti. Çdo njeri është i njëjtë në aspektin e krijimit. Njeriu i bardhë, i zi, esmer apo i verdhë qoftë, është krijesë e Allahut. Askush nuk ka epërsi kundrejt dikujt tjetër. Epërsia është vetëm në devotshmëri.

Allahu Teala na ka ndarë në popuj, në mënyrë që ta njohim njëri-tjetrin. Zoti e tregon kështu se kush ka epërsi ndaj dikujt tjetër:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam prej një

mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Të asgjë nuk është e fshehtë.” (el-Huxhurat 49/13.)

Ndërsa Mevdudi, shprehet kështu në komentimin e këtij ajeti: “Racizmi, që nga kohët e kaluara e deri më sot, në çdo periudhë e ka detyruar njeriun ta lërë njerëzinë mënjanë dhe i ka vendosur disa korniza të vogla brenda mjedisit të tij. Krijesat brenda këtyre kornizave, njeriu i ka pranuar si të tijat, ndërsa ato jashtë tyre, nuk i ka pranuar. Kjo kornizë nuk është bërë mbi bazën e mendjes, logjikës apo moralit, por mbi bazën e rastësisë së krijimit. Pretendimi i tyre në disa vende, është lindja në një fis apo në një brez.

Ndërsa në një vend tjetër, është lindja e tyre në ndonjë vend gjeografik të rëndësishëm, apo në popuj që mbartin një ngjyrë të veçantë ose kanë një të tillë. Më vonë, ndarja që ka vendosur për të vetin e të huajin, duke u bazuar në këto baza, e ka bërë atë të bashkëpunojë më shumë me të vetin, kurse kundrejt të huajve i ka frymëzuar format më të këqija, si urrejtjen, armiqësinë, poshtërimin dhe lëndimin, madje edhe torturën dhe padrejtësinë.

Në çështjen e racizmit janë formuar shumë filozofi, janë shpikur shumë mendime të ndryshme, janë vendosur shumë tema dhe janë hedhur baza etike. Popujt dhe perandoritë e kanë përdorur këtë përgjatë shekujve, duke e bërë si parim për veten e tyre dhe duke e pranuar si ligj.

Çifutët i kanë pranuar bijtë e Izraelit si robërit e zgjedhur të Allahut, duke u mbështetur në ndjenjat e racizmit. Ndërsa të drejtat dhe gradat e atyre që nuk ishin prej bijve të Izraelit, i kanë pranuar si më të pavlera, edhe pse ishin ithtarë të së njëjtës fe. Për këtë arsye, u formua epërsia e brahmanëve. Të gjithë njerëzit u pranuan si të poshtër e të pistë, kundrejt atyre që ishin prej klasave të larta. Kështu që, klasa e ulët u hodh në greminat e poshtërimit.

Padrejtësitë dhe torturat, që u ka bërë ndarja i bardhë/i zi njerëzve të zinj në Afrikë e Amerikë, nuk është e nevojshme të kërkohe në faqet e historisë. Sot të gjithë mund t'i shohin këto me sytë e tyre.

Torturat e tmerrshme, që u kanë bërë evropianët njerëzve të kuq, kur shkuan në kontinentin e Amerikës, padrejtësitë që u kanë bërë popujve të Azisë dhe Afrikës, gjithmonë i kanë bërë me mendimin se jeta, pasuria dhe nderi i të tjerëve, përveç popullit e racës së tyre, janë hallall për ta. Ky mendim u ka dhënë të drejtë atyre t'i plaçkitin popujt e tjerë, t'i bëjnë robër, madje edhe t'i zhdukin, nëse është e nevojshme.

Racizmi i popujve perëndimorë i ka bërë popujt e tjerë përbindështa kundrejt njëri-tjetrit. Shembujt më të tmerrshëm të kësaj janë hasur në luftërat më të afërta dhe po i hasim akoma.

Veçanërisht, kur të merren parasysh tabllot e tmerrshme që ka shfaqur në Luftën e Dytë Botërore filozofia raciste dhe epërsia e racës gjermane në Gjermaninë naziste, njeriu e kupton lehtë se ky është një devijim i frikshëm dhe i trishtueshëm.

Për rregullimin e kësaj, ka zbritur ky ajet i Kuranit Fisnik. Në këtë ajet të shkurtër, Allahu Teala ka shpjeguar tri baza shumë të rëndësishme, duke iu drejtuar gjithë njerëzisë:

E para: Origjina e të gjithëve është një. Çdo lloj i yni është krijuar nga një burrë dhe një grua. Të gjitha racat që gjenden sot në këtë botë, faktikisht janë degët e një themeli dhe një race, që ka filluar nga një nënë dhe një baba. Në asnjë vend të rrjedhës së këtij krijimi nuk ka asnjë gjë që i mbështet mendimet e klasave dhe të racave të larta/të ulëta, të dhëna pas këtyre ndarjeve dhe pohimeve sakate.

Krijuesi ynë i vetëm është Allahu. Njerëz të ndryshëm kanë bërë zotër të ndryshëm. Të gjithë jemi krijuar nga i njëjti material. Nuk është e vërtetë se disa njerëz janë krijuar nga një lëndë e pastër e disa të tjerë nga një lëndë e papastër. Ne jemi fëmijët e një nëne dhe babai. Njeriu i parë nuk ka qenë në shumë çifte, në mënyrë që prej tyre të dilnin popuj të ndryshëm në vende të ndryshme të botës.

E dyta: Edhe pse ne jemi një nga aspekti i origjinës, ndarja jonë në fise e popuj është një domosdoshmëri e krijimit. Është e qartë se të gjithë njerëzit në tokë nuk mund të jenë një familje. Me shtimin e brezit, u shtuan edhe familjet. Pasi u shtuan familjet, ishte e pamundur të mos dilnin

në pah popujt. Pasi njerëzit u vendos në vende të ndryshme të botës, domosdoshmërisht do të dilnin ngjyrat, format, gjuhët dhe mënyrat e ndryshme të jetesës.

Natyrshtëm, ata që jetonin në një vend, ndjenin më shumë afrimetet ndërmjet tyre, ndërsa ata që jetonin në vende të largëta, nuk kishin edhe aq. Krijuesi i ka sistemuar njerëzit në popuj e në fise, që të njihen dhe të ndihmohen ndërmjet tyre në këtë mënyrë.

E treta: Nëse njerëzit kanë ndonjë epërsi apo virtyt, ajo është vetëm epërsia dhe virtyti moral. Të gjithë njerëzit janë të barabartë nga aspekti i krijimit, sepse krijuesi i tyre është një. Lënda prej të cilës janë krijuar dhe mënyra e krijimit të tyre është një. Të gjithë lidhen te një nënë dhe baba. Nisur nga ky aspekt, asnjë njeri nuk ka ndonjë shkak logjik për të zotëruar epërsi ndaj të tjerëve. Gjëja që e bën dikë më të lartë se të tjerët, është frika që ka ndaj Allahut, largimi nga të këqijat, ndershmëria dhe drejtësia.

LAVDËRIMI ME BABALLARËT ËSHTË ZAKON I INJORANCËS

Njëra prej metodave të lavdërimit, që përdorin më shumë njerëzit, është lavdërimi me babain dhe me farefisin. Njeriu i pëlqen të lavdërohet me farefisin e tij. Për shembull, një njeri, prejardhja e të cilit arrin deri te sulltani, lavdërohet me fisnikërinë e tij, duke thënë se prejardhja e tij arrin deri te sarajet. Disa lavdërohen me heroizmin e baballarëve, disa të tjerë me forcën dhe disa të tjerë me pasurinë. Domethënë, njeriu gjithmonë i pëlqen të lavdërohet.

Njeriu dëshiron t'i përkasë një populli të lavdëruar. Përshembull, populli turk lavdërohet me të drejtë për baballarët, që përgjatë gjithë historisë kanë shfaqur heroizma dhe i kanë prirë Islamit. Ky nuk është lavdërim me epërsi raciste. Kjo është thjesht një ndjenjë gëzimi, për shkak se i përkasim një populli i cili ka shërbyer shumë në lidhje me fenë dhe i ka dhënë shumë dobi njerëzimit. Në këtë mënyrë, një njeri që i përket një populli të mbushur me padrejtësi përgjatë gjithë historisë, kurrë nuk është e drejtë të lavdërohet me të.

Një herë e pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.): “A konsiderohet racizëm e nacionalizëm dashuria që një njeri ndjen ndaj farefisit dhe popullit të tij?”

Pejgamberi (a.s.), u përgjigj:

“Jo. Por nëse ai e ndihmon popullin e tij në padrejtësi, atëherë ai është nacionalizëm.”

“Kush i numëron tetë gjyshër të tij qafirë, me mendimin për të fituar krenari dhe nder, ai do të jetë i nënti i tyre në xhehenem.”

Sidoqoftë, nuk është e drejtë të lavdërohem në padrejtësi apo në mirësi me prejardhjen para Islamit. Nëse një çifut bëhet mysliman, nuk mund të lavdërohet me popullin e tij që ka bërë padrejtësi dhe masakra historike.

Allahu i madhëruar, duke na tërhequr vëmendjen që të mos i marrim për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tanë, që kanë zgjedhur mohimin kundrejt besimit, thotë:

“O ju që keni besuar! Mos i pranoni për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata e duan mosbesimin më shumë se besimin. Kushdo prej jush që i merr ata për mbrojtës, është keqbërës.”
(et-Teube 23.)

Pejgamberi, (a.s.), në një fjalim që mbajti pasi bëri tavaf Qabenë në çlirimin e Mekës, tha: “*Falënderimi qoftë për Allahun, i cili ua mbuloi gabimet e xhahilijetit dhe ua largoi mburrjen. O Njerëz! Të gjithë njerëzit ndahen në dy grupe. Njëri grup bën vepra të mira dhe largohet nga të këqijat. Këta njerëz kanë vlerë te Allahu. Ndërsa grupi tjetër është mëkatar dhe gjynahqar. Këta njerëz nuk kanë vlerë te Allahu. Të gjithë njerëzit janë bijtë e Ademit. Allahu e krijoi Ademin nga dheu.*”

“Do të vijë popuj të tillë, që do të lavdërohen me baballarët e tyre. Ata janë qymyri i xhehenemit. Ata janë më të pavlefshëm te Allahu se brumbulli. Allahu e ka ndaluar të lavdëroheni me kohën para Islamit dhe të mburreni me baballarët tuaj. Njerëzit ndahen në dy grupe: besimtarë të devotshëm ose qafirë të poshtëruar. Të gjithë njerëzit janë fëmijët e Ademit. Ndërsa Ademi është krijuar nga dheu.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Kush nuk bindet, ndahet nga xhemati (dhe vdes në atë gjendje), vdes si xhahil. Kush lufton nën një flamur në mënyrë të verbër, zemërohet për shkak të racizmit apo fton e ndihmon racizmin dhe vdes përgjatë kësaj gjendjeje, edhe ai ka vdekur si xhahil. Kush vjen në krye të umetit tim, i godet të gjithë pa bërë ndonjë ndarje ndërmjet të mirit e të keqit, nuk ka respekt ndaj besimtarëve dhe nuk e mban premtimin, ai nuk është prej meje dhe unë nuk jam prej tij.”

Ai që lufton për një çështje të tillë, edhe pse e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka dalë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Sigurisht se ky kundërshtim, do ta shkatërrojë njeriun.

POSHTËRIMI I DIKUJT PËR SHKAK TË RACËS DHE NGJYRËS

Asnjëri nuk duhet të poshtërohet për shkak të racës, babait, nënës apo ngjyrës së tij. Islami e ka ndaluar një rregull të tillë, në të cilin dominon ky mendim. Para se të vinte Islami, njerëzit ndaheshin

në klasa të ndryshme. Islami doli në një periudhë ku i forti e shtypte të dobëtin dhe vendosi drejtësi shoqërore.

Gjatë haxhit të lamtumirës, Pejgamberi, (a.s.), tha:

“O njerëz! Kini kujdes, Zoti është një. Asnjë arab nuk ka epërsi ndaj dikujt që nuk është arab dhe asnjë që nuk është arab, nuk ka epërsi ndaj një arabi. Asnjë i zi nuk ka epërsi ndaj një të bardhi dhe asnjë i bardhë nuk ka epërsi ndaj një të ziu. Epërsia është vetëm në devotshmëri. Më i vlefshëm te Allahu është ai që e ka më shumë frikë Allahun. Kini kujdes! A ua transmetova?”

Të gjithë thanë: “Po, o i Dërguari i Allahut.” Pastaj i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Atëherë, ata që ndodhen këtu, le t’ua tregojnë atyre që nuk janë.”

Ebu Dherri, (r.a.), transmeton: “(Një herë) u ngatërrova me një burë dhe e ofendova për shkak të nënës së tij. I Dërguari i Allahut, (a.s.), më tha: ‘O Ebu Dherr! A e ofendova për shkak të nënës? (Domethënë), ti akoma qenke një njeri i ngelur në xhahilijet...’ Sipas transmetimit të Velid b. Muslimit, në këtë ngjarje bëhet fjalë për Bilal el-Habeshiun, (r.a.).

Një ditë, Ebu Dherr el-Gifari, (r.a.), ishte mërziur shumë dhe i kishte thënë Bilalit: “Jabnesseuda”, “o biri i zezakes!” Bilali (r.a.), shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Ebu Dherr më ofendoi dhe më tha ‘biri i zezakes’.

I Dërguar i Allahut, (a.s.), i rrudhi vetullat dhe tha: “O Ebu Dherr! Ty akoma të vjen erë xhahilijeti. Ti akoma ke shenja prej xhahilijetit. Si mund ta ofendosh një njeri nga nëna?..”

Sahabiu i nderuar, pasi e mori veten kundrejt këtij qortimi, u betua: “O i Dërguari i Allahut! Për Zotin, unë e ofendova Bilalin. Tani do ta vendos kokën në tokë dhe vallahi nuk do ta ngre, derisa të ma shkelë fytyrën me këmbët e tij!”

Raca nuk mund të jetë shkak për ndarje

Myslimanët kanë gjetur shumë arsye në çështjen e ndarjes dhe të përçarjes. Ndërsa Allahu i madhëruar, në Kuranin Fisnik, i paralajmëron robërit e tij të jenë të bashkuar dhe unikë:

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut ndaj jush, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në

udhën e drejtë.” (Al Imran 3/103.)

“Para Islamit fiset arabe ishin ndarë në kampe armike. Këta kampe bënë luftë me njëri-tjetrin për shkaqe të palogjikshme. Jeta e njeriut e kishte humbur shenjtërinë e saj dhe njerëzit vriteshin në mënyrë të pamëshirshme. Sikur Islami të mos u jepte mirësinë e t’i shpëtonte ata, zjarri i armiqësisë mund të digjte të gjithë Arabinë. Kjo mirësi ishte ashiqare, saqë mund të prekej me dorë në Medine kur zbritën këto ajete.

Fiset Evs dhe Hazrexh, që ishin në armiqësi prej vitesh, që bënë luftëra të përgjakshme dhe që sulmonin njëri-tjetrin në mënyrë barbare, pasi pranuan Islam, u bënë vëllezër me njëri-tjetrin.” Allahu i madhëruar, thotë:

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.” (el-Enfal 8/46.)

Këta urdhra janë obligim për myslimanët. Tashmë, besimtarit i takon të thotë: “Dëgjova dhe besova.” Veprimet jashtë këtyre janë mosbindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij. Ndërsa kjo është shkak për shkatërrimin e përjetshëm të njeriut.

ATA QË E SHPIEN RACIZMIN DERI NË PËRMASAT E SHIRKUT

Disa njerëz shkojnë aq larg në çështjen e racizmit/nacionalizmit, saqë për ta urdhrat e Allahut e të Pejgamberit nuk kanë më shumë rëndësi se kjo. Ku është besimi? Ne sikur thoshim se urdhrat e Allahut e të Dërguarit të Tij janë kurora e kokës sonë? Atëherë, cila është arsyeja për ta tepruar kaq shumë?

Armiqtë e jashtëm dëshirojnë që në vendet tona të bëjnë përçarje dhe t’i ndajnë ato. Por turku, kurdi, shqiptari, arabi janë vëllezër. Siç nuk mund të ndahet mishi nga thoi, edhe ne nuk mund të ndahemi nga njëri-tjetri. Perandoria otomane u shkatërrua për shkak të lëvizjeve raciste e nacionaliste. Përsëri ata duan t’i fusin myslimanët në luftë me njëri-tjetrin, duke përdorur të njëjtën gjë.

Popujt që nuk e kuptuan këtë lojë në të kaluarën, tashmë janë penduar shumë. Këtë dhimbje dhe pendim e ndjen më mirë populli i Palestinës. Nëse myslimanët nuk e kuptojnë këtë lojë dhe bien përsëri në të njëjtin kurth, përsëri do të përballen me të njëjtat padrejtësi dhe pendime. Ata që përvetësojnë këtë lloj racizmi, në përgjithësi përbëhen nga njerëz të padijshëm. Këta njerëz të padijshëm thonë fjalë aq të tepruara, saqë është e pamundur të mos mërziqesh.

Ata që i japin epërsi racizmit kundrejt urdhrave të Allahut, nuk duhet të harrojnë se me këto që po veprojnë, po i bëjnë shirk Allahut. Nëse çështja e racizmit ju urdhëron të bëni të kundërtën dhe ju vepron sipas saj, ndërkohë që Allahu, i cili është ligjvënës, e ka ndaluar atë, do të thotë se i keni bërë shirk Allahut duke vendosur një autoritet tjetër ligjvënës kundrejt urdhrit të Allahut Teala.

Në fe nuk ka imponim. Domethënë, nuk ka imponim për ata që nuk janë myslimanë. Por ai që hyn në rrethin e Islamit, është i detyruar të jetojë sipas ligjeve të tij. Ai është i detyruar të bindet, edhe nëse i vjen vështirë vetes apo nuk i pëlqen asaj.

Disa njerëz injorantë thonë se po bëhet padrejtësi. Në këtë mënyrë bëjnë terror, dhunojnë njerëzit dhe bëjnë përçarje duke menduar se po e bëjnë për popullin. Në shumë ajete kuranore shprehet qartë se në tokë nuk duhet të bëhet përçarje dhe sa gjë e tmerrshme është ajo. Ai që ndjek Pejgamberin, (a.s.), i cili është dërguar për të plotësuar moralin e lartë, nuk mund të bëjë poshtërsi të tilla. Çdo njeri ndaj të cilit bëhet padrejtësi dhe zullum, nuk mund ta marrë të drejtën e tij me dhunë.

Megjithëse Pejgamberit (a.s.) dhe sho-

këve të tij iu bënë padrejtësi dhe tortura të mëdha, ata kurrë nuk i sulmuan politeistët, nuk ua dogjën shtëpitë dhe kurrë nuk i dëmtuan njerëzit e pafajshëm. Islamit e mbrojtën brenda masave të ligjshme. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), dërgonte ushtrinë islame në luftë, urdhëronte që kurrë të mos vriteshin njerëzit e pafajshëm, të mos dëmtoheshin kishat, sinagogat, faltoret dhe ata që kërkonin ndihmë, madje, të mos dëmtoheshin as pemët. Vetëm këtë mund të bëjnë ata që pasojnë Pejgamberin, (a.s.).

VRASJA E NJË MYSLIMANI PËR HIR TË RACIZMIT/NACIONALIZMIT

Allahu dhe i Dërguari i tij kurrë nuk kënaqet prej atyre që i sulmojnë myslimanët nga pas duke bashkëpunuar me jomyslimanët në rrugë të nacionalizmit apo racizmit.

Në ahiret, sigurisht do të jepet llogari për këto

tradhti. Një mysliman kurrë nuk mund ta vrasë një mysliman në emër të atdheut. Për atdheun mund të vritesh dhe të vrasësh sipas rregullave që ka vendosur Islami. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka paralajmëruar ata që u bëjnë kurthe myslimanëve, që tradhtojnë dhe që cenojnë jetën, pasurinë dhe nderin e atyre.

Seleme Ibnu'l-Ekva, (r.a.), tregon: "I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Kush ngre shpatën kundër nesh, nuk është prej nesh."*

Ebu Musa dhe Ibnu Umeri, (r.a.)m, tregojnë: "I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Kush na drejton armën, nuk është prej nesh."*

Ebu Bekri, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Gjaku, pasuria dhe nderi juaj janë haram kundrejt njëri-tjetrit, ashtu si shenjtëria e kësaj dite, këtij qyteti dhe këtij muaji."*

Përsëri, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Gjaku, pasuria dhe nderi i çdo myslimani është haram ndaj një myslimani tjetër."*

Enes b. Malik, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Çdo njeri që fal namazin tonë, që i drejtohet kibles sonë dhe që ha mishin e kafshëve që presim ne, është mysliman. Ai ka*

sigurinë e Allahut dhe të Dërguarit të tij."

Enes b. Malik, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Kur dy myslimanë t'i ngrënë shpatat kundrejt njëri-tjetrit, vrasësi dhe i vrari do të hyjnë në xhehenem."* Sahabët e pyetën: "O i Dërguari i Allahut! Çështjen e vrasësit e kuptuam, por i vrari përse do të hyjë në xhehenem?" Pejgamberi (a.s.), tha: *"Edhe ai dëshironte ta vriste vrasësin e tij."*

Xherir b. Abdullah, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Mos u bëni qafirë, që vrasin njëri-tjetrin pas meje!"*

Si përfundim, le të themi se këto argumente janë të mjaftueshme për njerëzit e mençur. Tani nuk kemi ç'të bëjmë tjetër për atë që vazhdon të mos bindet. Myslimanët duhet të zgjohen dhe t'i kuptojnë lojërat që po bëhen mbi ta. Në të kundërt, pendimi që do të përjetohet, nuk do të ketë dobi.



Duajeni PROFETIN

— Ferit Piku —

Zoti ynë thotë në Kuranin famëljartë: **“Thuaju atyre (o Muhamed): Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë juve, t’jua falë gabimet se Zoti është Falës dhe Mëshirues i madh”.** (Ali Imran: 31).

Pse e do njeriu ujin dhe bukën? Pse e do ditën e ngrohtë e me diell? Pse e do kaltërsinë e detit? Pse e do gjelbërimin e fushës, bardhësinë e borës, erën e lules? Sepse të gjitha këto janë të bukura dhe njeriu e do të bukurën. Pse e do njeriu thjeshësinë e tjetrit? Pse e do bujarinë, urtësinë, zemrën e madhe që ka tjetri? Sepse këto janë cilësi të larta e të bukura dhe njeriu i do cilësitë e bukura. Pse e do njeriu prindin e tij, i cili e ka edukuar dhe ka shpenzuar gjithçka për fëmijën e tij? Pse e do mësuesin, i cili të ka mësuar të shkruash e të lexosh? Pse e do mikun, që të ka dalë krah atëherë kur ke pasur nevojë? Sepse njeriu i do ata që i kanë bërë mirë atij.

Atëherë vëllezër dhe motra dijeni, se profeti Muhamed (a.s.) i ka bashkuar të tria këto së bashku. Ai ka bashkuar bukurinë, cilësitë më të larta dhe kontributin që ka dhënë për ne.

Në qoftë se do të flasësh për bukurinë e tij, dije se është krijesa më e bukur e Allahut (xh.sh.). Me atë fytyrë të butë e të ëmbël, me atë ballë të gjerë, me ato vetulla të hijshme, me ata qerpikë të gjatë, me ato buzë të hijshme, me atë gojë të lezetshme, me ato dhëmbë të bardhë, me ato flokë të buta e të pastërta, me erën e tij prej parfumi, po kush nuk do këtë njeri, profetin (a.s.)!

Nëse e do bukurinë, ai është kulmi i bukurisë, ai është kulmi i hijeshisë. Një çifut kishte dëgjuar për një person, që pretendon se është profet, por i kishin thënë se është mashtrues. Kur profeti (a.s.) arriti në Medine, thonë që sapo ky çifut e pa fytyrën e tij, tha: “Pasha Zotin ky nuk është mashtrues e as

gënjeshtar, kjo nuk është fytyrë gënjeshtari, sepse gënjeshtarit i duket gënjeshtria në sy dhe mashtrimi në fytyrë”.

Vetëm disa prej shokëve të tij e kanë përshkruar fytyrën e profetit (a.s.). A e dini shkaku e kësaj? Kjo ndodhte, sepse pjesa më e madhe nuk guxonin ta shihnin gjatë në fytyrë nga bukuria që kishte profeti Muhamed (a.s.). Ai u krijua siç mund të krijojë Zoti i gjithësisë krijesën e tij më të bukur. Nëse e do bukurinë, duaje profetin Muhamed (a.s.), se është kulmi i bukurisë. Në qoftë se njeriu i do cilësitë e mira, dije se ai ishte kulmi i cilësive më të mira. Ishte ai njeri, që s’e edukoi as prindi, as babai, as nëna, as mësuesja, as shoku, por ishte njeriu që e edukoi vetë Zoti i gjithësisë dhe vetë profeti (a.s.) ka thënë: **“Mua më ka edukuar Allahu dhe i kam përsosur cilësitë dhe moralet e mia”**¹.

Shikoje urtësinë e tij. Ai njeri që ia shtrëngonin fytyrën për ta mbytur, armiqtë e tij dhe thoshte: **“Zoti im, fali këta njerëz, se nuk e dinë se çfarë bëjnë”**².

Profeti (a.s.) ishte ai, të cilin banorët e Taifit e dëbuan dhe e qëlluan me gurë kurse ai tha: **“O Zot, fali këta njerëz e nxirr prej fëmijëve të tyre njerëz, që adhurojnë Allahun (xh.sh.), se nuk e dinë se kanë të bëjnë me profetin e Zotit”**³.

Profeti (a.s.) kishte mëshirë për fëmijët e vegjël, kishte mëshirë për kafshët, kishte mëshirë për shokët e tij. Ai shikonte shokët e tij, se kush është sëmurë, kush ka halle, kush ka borxhe, kush ka problem. Profeti (a.s.) ishte ai njeri, që arriti të nënshtrojë para këmbëve të tij armiqtë e tij të përbetuar, sepse ishte i butë, i thjeshtë e modest. Njëherë një plakë e vjetër u dridh kur e pa profetin (a.s.). Profeti (a.s.) i tha: **“Pse dridhesh o nënë?”** Ajo i tha: **“Jam para profetit të Zotit, para krijesës më të madhe”**. Ndërsa profeti Muhamed (a.s.) ia ktheu: **“Mos u dridh përpara meje o nënë, se unë jam biri i asaj gruaje, që hante bukën thatë në Mekë, unë jam rob i dhe i dërguari i Zotit, nuk jam mbret as diktator”**⁴.

Ishin këto cilësi, që i dhanë jetë shkretëtirës arabe, që i zbutën zemrat e ashpra të armiqtëve të tij, që futën dashurinë tek të gjithë ata, që e panë profetin (a.s.) dhe bënë, që secili prej tyre të jepte shpirtin e tij për figurën dhe për nderin e profetit Muhamed (a.s.). Prandaj duaje këtë njeri, nëse i do cilësitë e

larta, sepse pati përmbledhur në veten e tij cilësitë më të larta, që mund të ekzistojnë tek ndonjë njeri, që ka ecur në shpinën e tokës.

Në qoftë se e do prindin tënd dhe është mirë ta duash prindin tënd, në qoftë se e do mësuesin që të ka mësuar dhe mikun që të është gjendur pranë, dije se profeti Muhamed (a.s.) nuk krahasohet as me prindin, as me mësuesin as me mikun. Është njeriu që ka bërë më shumë për mbarë njerëzimin.

Kush ishte ai njeri që të mësoi ta duash prindin, kush ishte ai njeri që të mësoi ta duash fëmijën tënd, bashkëshorten tënde, mësuesin tënd, mikun që të është gjendur pranë?

Kush ishte njeriu që ta mësoi fjalën **ALLAH**.

Kush ishte njeriu që të mësoi, që ti je njeri? Kush ishte personi që të mësoi, që të futesh në shtëpinë tënde e të thuash fjalën **“Bismilah. O Zot na ruaj nga shejtani dhe xhindët e mallkuar”**?

Kush ishte njeriu që të mësoi, të dalësh prej shtëpisë tënde me fjalën **“Bismilah. O Zot mos më bëj mua njeri të padrejtë dhe largoi të padrejtët prej meje”**⁵?

Kush ishte personi që të mësoi, të ulesh të hash bukë e të thuash **“Bismilah. O Zot, na e beko ushqimin që na ke dhënë”**⁶?

Kush ishte personi që të mësoi, që kur të ngrihesh nga buka, të thuash **“Elhamdulillah”**⁷.

Kush ishte personi, që të mësoi ta nisësh një fëmijë në jetë me fjalën **“Bismilah. O Zot ruaje fëmijën tim nga shejtani i mallkuar”**⁸?

Kush ishte personi që të mësoi, ta presësh fëmijën në jetë me fjalën **“Allahu ekber. O Zot bekoje fëmijën tim”**⁹.

Kush ishte personi që të mësoi të durosh, të mësoi të mëshirosh, të mësoi të falenderosh Allahun (xh.sh.) në çdo situatë ku je?

Kush ishte personi që të udhëzoi, të vish me hapat e tua, të lësh punët tuaja e të vësh ballin në sexhde për Allahun (xh.sh.)? Madje kush ishte personi që të mësoi të hysh në banjo e të dalësh prej saj?

A nuk ishte ai profeti Muhamed (a.s.)? A nuk është ai prindi më i madh, shoku më i mirë, mësuesi më i mirë? Po për Zotin, ai është profeti Muhamed (a.s.).

Prandaj vëllezër duajeni profetin Muhammed

1. Ibn Asakiri, hadithi është i dobët, ndërsa domethënia e tij është e vërtetë.

2. Buhariu.

3. Buhariu.

4. Ibn Maxheh dhe Hakimi që e vlerëson të vërtetë sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit por në vend të plakës bëhet fjalë për një burrë.

5. Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Hadithi është i vërtetë.

6. **Hadith shumë i dobët**. Ibn Sini dhe Ibn Adij.

7. Ibn Hibani dhe hadithi është i pranuar.

8. Buhariu.

9. Buhariu dhe Muslimi si dua të pejgamberit alejhis'salatu ue selam për dy fëmijë të ensarëve.

(a.s.). Kishte bukurinë më të madhe, kishte cilësitë më të larta, ka dhënë kontributin më të madh për mua dhe për ty. Madje edhe tani që është i vdekur, ai na do ne.

Ai ka thënë: **“Zoti i gjithësisë, për çdo ditë të enjte m’i paraqet mua punët e umetit tim, punët e çdo besimtarit. Kur shikoj ndonjë punë të mirë i them: “Faleminderit Ty o Zot që bëre nga pasuesit e mi, dikë që bën punë të mira”. Kënaqet dhe falënderon shumë Allahun (xh.sh.). e kur shikon ndonjë punë të keqe thotë: “Aman O Zot fale robin Tënd, fale për hatrin tim, robin Tënd”¹⁰.**

Shikoje mëshirën e profetit (a.s.) kur thotë: **“Çdo peygamber e ka patur nga një lutje që Zoti nuk ia kthente kurrë mbrapa. Unë akoma s’e kam bërë lutjen time. E kam lënë për jetën tjetër, e kam lënë për gjynaharët e umetit tim”¹¹.**

Gjithashtu profeti (a.s.) ka thënë: **“Ditën e Kijametit të gjithë pa përjashtim do të thonë: “nefsi, nefsi (vetja ime, vetja ime), kurse unë do të them: “Umeti, umeti (populli im, populli im)”¹².**

Prandaj duajeni peygamberin Muhamed (a.s.) siç e deshën shokët e tij, sepse ai nuk dallonte pasanikët dhe të varfërit, të bukurit e të shëmtuarit.

Tregohet, që kur Peygamberi (a.s.) shkoi në Medine, aty jetonte një djalë i ri, por shumë i shëmtuar. Aq i shëmtuar ishte, saqë fëmijët kur e shikonin, trembeshin, ndërsa burrat dhe gratë ndërronin rrugën. Prandaj ai nuk ua tregonte fytyrën njerëzve, që të mos i bënte ata të ndiheshin keq, por u tregon te shpinën. I vetmi person, që e donte këtë njeri, që e përqafoje këtë njeri, ishte profeti Muhamed (a.s.). Thuhet se kur profeti (a.s.) e shikonte Zaherin (kështu e kishte emrin), atë të shëmtuarin, i linte shokët e tij dhe i shkonte nga pas shpine, ia mbyllte sytë dhe i thoshte: **“A e gjen dot se kush jam unë?”**. Kur ai i thoshte **“M’i lësho sytë”**, shikonte peygamberin (a.s.). Pastaj profeti (a.s.) ia vinte dorën mbi sup, kthehej dhe u thoshte shokë-

ve të tij me shaka: **“Kush e blen robin tim”**, por Zaheri thoshte, edhe ai me shaka: **“O profet i Zotit, e kush më blen mua? Unë nuk vlej asnjë qindarkë, ata do të humbasin po më blenë mua.”** Por profeti (a.s.) i thoshte: **“Për Zotin ti je shumë i shtenjtë tek Allahu (xh.sh.)”¹³.** Prandaj edhe shokët e tij e deshën shumë profetin Muhamed (a.s.).

Kur peygamberi (a.s.) ndërroi jetë, në daç më besoni, në daç mos më besoni, ata i luteshin Allahut (xh.sh.), t’ua marrë shpirtin sa më shpejt, që të takoheshin me profetin (a.s.).

Pasi peygamberi (a.s.) ndërroi jetë, kalifi i parë i muslimanëve Ebu Bekri (r.a), urdhëroi muezinin e profetit (a.s.), Bilalin (r.a) të thërrasë ezanin, por nuk ai mundi ta çojë deri në fund.

Kur shkoi tek fjala ESH-HEDU ENNE MUHAMEDEN RESULULLAH, i shpërthyen lotët, e mbyti malli, nuk mundi ta plotësojë ezanin dhe iku nga Medina për disa vite me rradhë. Kur erdhi pas disa kohësh përsëri në Medine, u fut në xhaminë e peygamberit (a.s.), aty ku ishte falur profeti i Zotit dhe pas kaq e kaq vitesh filloi ta thërrasë edhe njëherë ezanin, atë ezan të cilin e kishte thirrur nëpër maja malesh, nëpër lugina, nëpër shkretëtira dhe vetëm ai, Bilali nga Etiopia, thërriste ezanin për profetin (a.s.).

Pasi mbaroi ezanin, u mbyti në lot, qanë edhe sahabët bashkë me të. Në çastet e vdekjes së Bilalit, gruaja e tij qante dhe thoshte: **“I mjeri burri im po vdes”**, por Bilali i thoshte: **“Mos thuaj kështu, por thuaj: “Lum burri im që po vdes. Nesër do të takohet me të dashurit e tij, me profetin (a.s.) dhe shokët e tij”**.

Sahabët e deshën këtë njeri (profetin a.s) sepse jetuan me të dhe e panë se kush ishte ai, panë pastërtinë, moralin dhe bukurinë e tij.

Lus Zotin që të paktën ta shikojmë profetin (a.s.) në botën tjetër, meqë nuk e pamë dot në këtë jetë. Duart tona të cilat nuk e prekën dot butësinë e duarve të profetit (a.s.), të paktën ta prekin atë në botën tjetër dhe inshallah pijmë ujë e Keutherit dora e tij (a.s.). Ne që shtëpitë tona nuk i patëm afër profetit (a.s.) në këtë jetë, i lutemi Allahut (xh.sh.) që të jemi në shoqërinë e tij në botën tjetër.

13. Ahmedi dhe Tirmidhiu në Shemail. Vargu i hadithit është i vërtetë.

10. Bezariu me varg të vërtetë por me fjalë të ndryshme. Për pjesën “Aman o Zot fale robin Tënd”, nuk ka rivajet.

11. Muslimi.

12. Buhariu dhe Muslimi.

Çdo pretendim e ka faktin dhe argumentin e tij. Dashuria për profetin (a.s.) që e themi me gjuhët tona, që e duan zemrat tona dhe inshallah e realizomë në jetën tonë, duhet të ketë fakte. Le të tregojmë se e duam vërtet profetin (a.s.).

Kush e do profetin (a.s.), le të dojë para së gjithash Krijuesin e profetit (a.s.), Allahun (xh.sh.), sepse profeti (a.s.) e deshte shumë Allahun (xh.sh.) dhe kurrë nuk e prishi zemrën me Allahun (xh.sh.). Kur ishte në vështirësi, e deshte Zotin më shumë se në lehtësi, prandaj duajeni Allahun (xh.sh.), sepse është Ai, që solli për ne profetin (a.s.), mësuesin tonë, edukatorin tonë.

Kush do profetin (a.s.) le t'i dojë jetimet dhe të varfërit, t'i dojë ata që nuk kanë përkrahje dhe t'u dalë në ndihmë. Profeti i donte shumë ata dhe thoshte: **“Unë dhe përkrahësi I jetimit do të jemi në xhennet si këta dy gishta”** dhe bashkonte dy gishtat e dorës së tij¹⁴.

Kush e do profetin (a.s.), le ta dojë shumë thjeshtësisë, sepse ai ishte i thjeshtë, njeri që më shumë se gjithçka i pëlqente emri Abdullah (rob i Zotit). Ai e urrente shumë mendjemadhësinë, prandaj na porositi që edhe ne ta urrejmë këtë ves të ulët. Ai thoshte: **“Pasha Zotin nuk ka për të hyrë në xhennet mendjemadhi, derisa ta pastrojë Zoti”**¹⁵.

Kush e do profetin (a.s.), le ta dojë shumë bashkimin dhe vëllazërinë e ta urrejë përçarjen, sepse ai (a.s.) e donte shumë vëllazërinë, shpenzonte gjithçka, vetëm e vetëm që shokët e tij të mos përçahehin dhe u thoshte: **“Kini kujdes! Pas vdekjes time mos u ktheni në armiq të njëri – tjetrit. Largojeni shejtanin prej jush, sepse ai do përçarjen dhe konfliktin mes jush”**¹⁶. Prandaj duajeni njëri – tjetrin, ashtu siç i deshi profeti (a.s.) shokët e tij.

Kush do profetin (a.s.), le ta dojë butësinë e urtësinë dhe ta urrejë ashpërsinë e vrazhdësinë, sepse ai ishte i butë dhe e urrente ashpërsinë në çdo gjë. Ai thoshte: **“Lehtësoni dhe mos vështirësoni. Përgëzoni dhe mos frikësoni”**¹⁷.

Ishte njeriu që thoshte: **“Kur butësia futet në diçka, sikur hekur të jetë ajo gjë, do të zbutet. Por kur butësia del prej diçkaje, nuk ka gjë që e rregullon problemin”**¹⁸.

Nëse e doni profetin (a.s.) atëherë duajeni familjet tuaja, fëmijët tuaj, nipërit dhe farefisin tuaj. Profeti (a.s.) i deshi shumë familjen dhe fëmijët e tij. Kur vajza e tij Fatimja futej në shtëpi, ai ngrihej në këmbë dhe thoshte: **“Mirë se vjen o pjesë e**

shpirtit tim” dhe ia puthte dorën. E deshi shumë familjen e farefisin dhe shpenzoi gjithçka për ta. Kurrë nuk i mallkoi dhe kurrë nuk i pati urreyer. Prandaj duajeni njerëzit tuaj dhe familjet tuaja, se po deshët familjet tuaja, do ta ndjeni kënaqësinë dhe ëmbëlsinë e po nuk deshe familjen tënde, nuk të bëhet të rrish në shtëpi.

Kush do profetin (a.s.), le ta dojë të mirën për çdo njeri, besimtar apo jobesimtar, musliman apo jomusliman, sepse profeti (a.s.) erdhi si mëshirë për gjithë botët, erdhi si shpirti për trupin, si uji për jetën. Duajeni njerëzit në përgjithësi dhe mundohuni të kontribuoni për ta me sa të keni mundësi.

Nëse e duam profetin (a.s.), atëherë kur të dëgjosh fjalën “Ka thënë profeti (a.s.)”, ndalu pak dhe mendo jo vetëm me veshë por dhe me zemër, sepse ka folur ai që kurrë nuk ka gënjyer, ai që nuk ka mashtruar kurrë. Dëgjoje fjalën e tij, se pasha Zotin ta do të mnrën si në këtë jetë ashtu edhe ne jetën tjetër.

Nëse e duam profetin (a.s.), do t'i duam fjalët e tij, porosinë e tij e punët e tij. S`do të ketë nevojë të na thotë ndokush: “Falu pesë herë në ditë, afroju hallallit, largoju haramit”, sepse ka folur njëherë e mirë profeti (a.s.) dhe na mjafton kjo gjë.

O njerëz!

Duajeni profetin (a.s.), sepse me gjithë mangësitë dhe punët e vogla që kemi, unë shpresoj se me lejen e Allahut (xh.sh.), dashuria për profetin (a.s.) do të na nxjerrë faqebardhë para Zotit të gjithësisë.

Dikush shkon tek profeti (a.s.) dhe i thotë: “O profet i Zotit! Kur do të bëhet Kijameti”? Profeti (a.s.) ia ktheu: **“Pse pyet për të, çfarë ke prgatitur ti për të”**? Personi iu përgjigj: “Vallahi o profet nuk kam bërë ndonjë punë të madhe, as namaz e as agjërim, por diçka e kam me gjithë zemër. Unë e dua Zotin dhe të dua edhe ty”. Profeti (a,s) i tha: **“Atëherë ti do të jesh me atë që do”**¹⁹.

E lus Zotin e gjithësisë që zemrat tona të vogla, t'i zgjerojë me dashurinë për profetin (a.s.), jetën tonë ta jetojmë si muslimanë, ashtu siç deshi profeti (a.s.), ta japim shpirtin si besimtarë, ashtu siç e dha profeti (a.s.) dhe të dalim para Zotit nën udhëheqjen e profetit (a.s.), ashtu siç deshte edhe vetë profeti (a.s.). Lus Zotin që t'i falë gabimet tona, të na dhurojë pak nga moralet e profetit (a.s.), të na mundësojë të pjmë ujin e Keutherit prej dorës së tij (a.s.). E lus Zotin, që të na bashkojë me të dashurin tonë, profetin (a.s.), t'i bashkojë prindërit tanë, fëmijët tanë dhe gjithë besimtarët me Muhamedin (a.s.) në xhennetet e Allahut (xh.sh.).

Amin!..

14. Buhariu.

15. Muslimi pa pjesën “Derisa ta pastrojë Zoti”.

16. Buhariu dhe Muslimi.

17. Buhariu dhe Muslimi.

18. Ahmedi.

19. Buhariu.

Shembuj të moralit të lartë

— Fatma Nur Xhihan —


Kurani Famëlartë është libri i jetës. Ai trajton të gjithë temat që kanë të bëjnë me jetën e njeriut. Ai është dritë për njerëzimin. Na mëson për adhurimet që duhet të bëjmë dhe na flet për marrëdhëniet që duhet të krijojmë me njerëzit. Kurani është një dhuratë hyjnore dhe një burim i pashtershëm mëshire dhe drite.

Në këtë mrekulli të dërguar nga Allahu (xh.sh.), gjejmë edhe shembujt e bukur të edukatës dhe të moralit të shumë njerëzve të lartë. Duke qenë se nuk është e mundur të flas me hollësi për secilin nga ato, jam munduar të tregoj pjesë të vogla nga jeta e tyre.

HZ. MERJEM, ZONJA E TË GJITHË GRAVE TË KËSAJ BOTE

Zonja e Imranit (Hanne) fëmijën që mbante në bark ia kishte kushtuar Allahut që para se të

lindte. Ajo u çudit shumë kur shikoi se fëmija që erdhi në jetë ishte vajzë dhe jo djalë, sepse në atë kohë nuk ishte e zakonshme që një vajzë ta kalonte jetën e vet duke qëndruar në xhami dhe duke bërë adhurime. Ajo donte ta mbante premtimin e bërë dhe i vendosi foshnjës emrin Merjem, që ka kuptimin: “Shërbëto e Allahut, dikush që adhuron Allahun”, dhe e la në xhami nën përkujdesjen e kushëririt të saj të afërt, Zekerjasë alejhi selam. Merjem, fëmijërinë dhe rininë e kaloi në këtë xhami, ajo iu përkushtua krejtësisht adhurimeve. Në vendin ku ajo qëndronte mund të futej dhe të dilte vetëm Zekerija alejhi selam. Ai habitej shumë kur shkonte tek Merjemi dhe shikonte pranë saj fruta nga më të ndryshmet, të cilat ia kishte sjellë Allahu. Për më tepër, ato nuk ishin nga frutat e stinës; në dimër pranë Merje-



mit kishte fruta të verës, kurse në verë të dimrit... Kur e pyeste Merjemin se nga erdhën këto fruta, ajo i përgjigjej që ishin dërguar nga Allahu (xh. sh.).

Një ditë Merjemi shikoi një djalë në mesxhid dhe u tremb nga kjo gjë, ngjarja vijoi në këtë mënyrë:

“Ajo i tha: “Unë kërkoj që të më mbrojtë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh Allahut.”

Ai tha: “Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.”

Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacione?!”

Iu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer.” (Merjem, 17-21)

Pas kësaj ngjarjeje, Merjem mbeti shtatzënë. Kur u afrua momenti i lindjes, ajo shkoi në një vend larg njerëzve. Një dite ishte nën hijen e një hurme dhe po ndjehej shumë e turpëruar, mendoj:

“ Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!” (Merjem, 23)

Allahu e ngushëlloi atë duke e bërë të gjelbëronte hurmën e thatë nën të cilën ndodhej.

Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.” (Merjem, 24-27)

Njerëzit që e shikuan Merjemin me fosh-

njen e vogël në krahë filluan që ta fyenin:

“O Merjem! Ti ke bërë një gjë shumë të shëmtuar! O motra e Harunit! Babai yt nuk kishte grua të pandershme.”

Merjem bëri me shenjë nga fëmija që kishte në krahë. Të gjithë u habitën:

“Do të flasim me foshnjën e vogël?!”

Pas këtyre fjalëve, foshnja në kondak tha:

“Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimit mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallet!” (Merjem, 27-33)

Kështu ka ardhur në jetë Isa. Populli çifut është përpjekur që të shpifë mbi ndershmërinë e Mejremit, kurse të krishterët, duke thënë se Isa ka lindur si një mrekulli pretendojnë se Ai është Perëndi.

Allahu (xh.sh.), i ka përgënjeshtruar të dyja këto teza.

Merjem ishte një grua e virgjër, e ndershme dhe e përkushtuar vetëm ndaj Allahut (xh.sh.). Ajo është një nga gratë më të larta të të gjitha kohërave. Ajo i ka kërkuar ndihmë vetëm Allahut kur ka shikuar në mesxhidin e vet një djalë të panjohur.

Me këtë ngjarje Allahu (xh.sh.), ka dashur të tregojë madhështinë e Tij të pafund dhe të provojë besimin e njerëzve.

Lindja e Isait pa baba i ngjan krijimit të Ademit, i cili ishte pa nënë dhe pa baba. Kjo është diçka e lehtë për Allahun (xh.sh.). **“Allahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. Qoftë i lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të ‘Bëhu!’ dhe ajo bëhet.”** (Merjem, 35)

Në shumë ajete të Kuranit bëhet e qartë se Isai është rob dhe jo perëndi. (shiko: Merjem, 34-36; El-Maide, 116-119; Al-Imran, 47-51; 60-61.) Fatkeqësisht, njerëzit kanë hapur debate në lidhje me këtë çështje dhe të gjitha këto probleme do të zbardhen në Ditën e Gjykimit.

“E megjithatë, sektet u përçanë në lidhje me atë. Mjerë ata që nuk besojnë për takimin e një Dite të madhe (Ditës së Kiametit)! (Merjem, 37)

Dua ta mbyll këtë shkrim me një dua të Pejgamberit tonë të nderuar:

“O Allah! Kërkoj nga Ti: shpëtim, moral të lartë dhe dëlirësi.” (Myslim, Zikir, 72.)



KURA 30 DITORE me qumësht blete

Bletërritësit krahas mbledhjes së mjaltit mbledhin edhe qumësht blete, i cilësuar si shëruesi natyral i shumë sëmundjeve.

E ndërsa tani është pikërisht sezoni i mbledhjes së këtij lëngu mrekullibërës për shëndetin, bletërritësit shprehen për AgroWeb.org se kërkesat për qumështin e bletës janë gjithnjë e në rritje.

Përdorimi i qumështit të bletës çmohet për lehtësimin dhe kurimin e shumë problemeve shëndetësore.

PËRDORIMI I QUMËSHIT TË BLETËS

Kura popullore me qumësht blete rekomandohet që të konsumohet herët në mëngjes me stomakun bosh.

Këshillohet që doza që do të merret fillimisht vendoset poshtë gjuhës, mbahet për 2 minuta dhe më pas kapërdihet.

Rekomandohet të mbahet nën gjuhë pasi aty ka mjaft enë gjaku që bëjnë thithjen e menjëhershme dhe kalimin në gjak.

Zgjatja e kurimit është e ndryshme dhe varet nga shkalla e sëmundjes ose qëllimi për të cilin përdoret, por asnjëherë më pak se një muaj.

Megjithatë, rekomandohet që kjo kurë të zgjasë nga 30 deri në 90 ditë dhe më pas ndërpritet.

Efektet e saj në organizëm nisin pas dy javësh, pra pas 15 ditësh.

NDARJA E DOZAVE DHE SI TA RUANI ATË

Doza ditore vendoset në bazë të moshës dhe peshës trupore.

Për të rriturit, doza që rekomandohet është 1 gram në ditë ndërsa për fëmijët rekomandohet 0.3 deri në 0.5 gram në ditë.

Megjithatë në çdo rast, për përcaktimin e dozës sugjerohet këshilla e mjekut.

Fëmijët që janë me qumësht gjiri rekomandohet ta marrin vetëm në raste specifike me këshillën e pediatrit.

Qumështin e bletës mund ta ruani në frigorifer, në temperaturë 3-5 gradë.

Duhet të ruhet në shishe të errëta dhe i mbështjellë me një letër të errët gjithashtu, pasi nuk duhet të ekspozohet ndaj dritës.

Ruhet në frigorifer për 12 deri në 18 muaj duke ruajtur të gjitha vlerat kurative.

SËMUNDJET QË TRAJTOHEN

Vlerësohet si një super ushqim i fuqishëm për shkak të vlerave që ai mbart.

Qumështi i Bletës përmban ujë, lëndë minerale, yndyrna, proteina, karbohidrate, vitamina etj.

Sipas të dhënave qumështi i bletës përdoret për kurimin e një sërë sëmundjesh si:

Hipertiroidisëm, Diabeti, Hiperkolesterolemi, hipertrigliceridemi (kolesterol dhe trigliceride të larta), sëmundje të zemrës dhe enëve të gjakut, sëmundje kronike të mushkërive, sëmundje të gojës, probleme me mishrat e dhëmbëve, probleme të fytyrës, sëmundje të veshkave, artrite reumatoide, probleme me riprodhimin, ndihmon në periudhat e premenopauzës etj.

Ka efekt qetësues dhe çlodhës, ul nivelin e hormoneve të tiroides.

PASTRUES FANTASTIK PËR ORGANIZMIN NGA TOKSINAT

Ndihmon funksionimin e veshkave, rrit jetëgjatësinë e njerëzve, duke ruajtur rininë e enëve të gjakut.

Zgjeron enët e gjakut, ndihmon në uljen e kolesterolit dhe triglicerideve dhe rrit imunitetin.

Çaj borziloku PËR KOLLË

Ka disa lloje të kollës, por shumë irrituese për organizmin është kolla e thatë. Kolla e thatë njihet si kolla jo prodhuese sepse ajo nuk shoqërohet me sekrecione.

Kjo kollë është shumë acaruese për fytin dhe stërmunduese për kraharonin.

SHKAKTARËT KRYESORË TË KOLLËS SË THATË

Azma

Azma shkakton enjtjen e rrugëve të frymëmarrjes. Kolla e thatë është një nga simptomat kryesore të azmës.

Urthi

Aciditeti i lartë në stomak është acarues jo vetëm për ezofagun por edhe për rrugët e frymëmarrjes. Ai shkakton edhe refleksin e kollitjes që zakonisht shoqërohet pa sekrecione.

Virozat

Sipas të dhënave viruset që shkaktojnë të ftohurën, janë përgjegjëse edhe për kollën e thatë. Ato qëndrojnë në rrugët e frymëmarrjes duke i irrituar dhe bërë ato më të brishta.

Ndotësit mjedisorë

Në këtë term përfshihen: smogu, duhani, toksinat, pluhurat, myku dhe poleni. Kolla e thatë mund të jetë edhe reagim i lëndëve kimike tek pastruesit e shtëpisë.

Duhani

Përthithja e toksinave të cigareve shkakton direkt kollën e thatë. Toksinat strehohen në mushkëri duke shkaktuar inflamacion, të cilin trupi përpiqet ta nxjerrë nëpërmjet kollës.

Ky qumësht ndihmon në formimin e rruazave të kuqe të gjakut, këshillohet në anemi dhe ndihmon në mikrohemorragji.

Në lëkurë, rregullon prodhimin e yndyrës.

Ndihmon në funksionimin e mëlçisë dhe sëmundjet e saj, hepatite dhe rigjeneron strukturën e mëlçisë.



Bronshiti

Bronshiti akut shfaqet tre deri në katër ditë pas gripit ose të ftohurës. Ai fillon me kollë të thatë dhe nëse ajo vazhdon, atëherë shoqërohet me sekrecione. Kolla e thatë mund të kurohet dhe trajtohet me medikamente ose nëpërmjet kurave natyrale të cilat zbusin frekuencën e saj dhe qetësojnë fytin.

Një nga mënyrat më të mira për të trajtuar këtë kollë është pirja e çajit të borzilokut çdo ditë.

Kjo barishte e shëndetshme ofron vlera të panumërta për shëndetin, ku përfshihet edhe aftësia për të luftuar kollën e thatë.

ÇAJI I BORZILOKUT KUNDËR KOLLËS SË THATË

Borziloku është një bimë shumë efikase kundër bronshitit, azmës, sëmundjeve të mushkërive dhe kollës.

Çajin e tij duhet ta pini çdo ditë kundër kësaj kolle acaruese. Zieni 250 ml ujë në një çajnik dhe më pas shtoni 5 deri në 7 gjethe borziloku të freskët ose dy lugë çaji me gjethe të thata borziloku.

Lërinë të ziejnë për 10 minuta në zjarr të ulët dhe më pas hiqeni çajnikun nga zjarri. Lëreni çajin të ftohet për disa minuta dhe më pas kullojeni dhe pijeni të ngrohtë. Për më shumë vlera mund të shtoni një copë të vogël xhenxhefil dhe mjaltë.

Ky kombinim duhet pirë çdo ditë për të patur përfitimet maksimale. Cilido të jetë burimi i kollës së thatë, çaji i borzilokut do t'ju vijë në ndihmë.

IBM PREZANTON KOMPJUTERIN E PARË “KUANTUM”, 3 METRA TË LARTË

IBM prezantoi IBM Q System One, kompjuterin e parë “kuantum” të llogaritur për biznese.

Kompjuterët “kuantum” shihen si teknologjia e re më premtuese, pasi janë të aftë të llogarisin shumë herë më tepër të dhëna se kompjuterët e sotëm.

Kjo do të thotë që faktorët e rrezikut mund të llogariten më shpejt me kompjuter, duke mundësuar bërjen e investimeve më të mira, gjëra që mund të çojnë drejt ndryshimeve të mëdha teknologjike.

Por biznesmenët nuk duhet të presin t'i instaloj-

në në zyrat e tyre, pasi shërbimi që ofron IBM për bizneset është vetëm nëpërmjet sistemit IBM Cloud. Pra, kompjuterët do të vazhdojnë të mbahen nga IBM, por do të përdoren duke u lidhur në rrjet.

Kompjuteri i parë kuantum për biznese është tre metra i lartë, i mbyllur në një kasë xhami që krijon një mjedis të izoluar. Izolimi është i rëndësishëm, pasi këta kompjuterë e humbin fuqinë nëse ndryshojnë kushtet e mjedisit rrotull tyre. IBM shpreson që kjo “thembër Akili” të zgjidhet në të ardhmen.

KAMERIERË ROBOTË SHËRBEJNË NË LOKAL

Mbase nuk është hera e parë që një bar kafe në Japoni ka në stafin e saj robotë, por në kafenenë Dawn Verb situata është shumë më e veçantë. Aty të gjithë kamerierët janë robotë, me gjatësi 120 centimetra dhe që lëvizin lirshëm duke shërbyer në tavolinat e lokalit.

Ajo që e bën akoma më special shërbimin e tyre është fakti se robotët drejtohen në distancë nga njerëz të paralizuar apo me aftësi të kufizuara, kudo qofshin ata, në shtëpi, spitale apo institute të specializuara.

Robotët kamerierë janë krijuar nga një startup i specializuar në robotikë për personat me nevoja të veçanta të quajtur Ory. Domethënë robotët nuk janë një makineri e thjeshtë që flet nëpërmjet kodeve elektronike, por gjithçka ata komunikojnë me klientët në fakt janë mendimet e personave që i drejtojnë.

Ky projekt sigurisht ka një qëllim mjaft human në vetvete, të bëjë të ndihen të dobishëm personat që ndihen të përjashtuar nga shoqëria.

TELEVIZIONIN 219-INÇ NGA SAMSUNG

Samsung zbuloi Micro LED TV, i quajtur "The Wall", në shfaqjen e Consumer Electronics 2019 në Las Vegas këtë javë.

Ky televizion përdor energji më pak se televizorët e tanishëm, por krijon një imazh më të ndritur.

Nëse mendoni se një ekran i tillë është më i përshtatshëm për një stadium sesa për një dhomë të gjallë, po vjen një version modular prej 75 inç.

Samsung nuk ka ndarë ndonjë datë të veçantë të

lëshimit ose detaje rreth çmimit, por ndoshta nuk do të jetë i lirë.

APLIKACIONI QË FLET PËR ATA QË S'KANË ZË

Jeta e Vlastimil Gular ka marrë një kthesë të papritur një vit më parë pasi një operacion i vogël në kordat e zërit, ka rezultuar me kancer të fytit, prandaj i është dashur të largojë laringun. Bashkë me të, ai ka humbur edhe zërin. Mirëpo 51-vjeçari, baba i katër fëmijëve, vazhdon të flasë, duke përdorur zërin e tij në vend të ndonjë zëri robotik, falë një aplikacioni të zhvilluar nga dy universitete çeke. “Më duket shumë i dobishëm”, ka thënë Gular për agjencinë e lajmeve AFP, teksa ka qenë duke shkruar se çfarë dëshiron të thotë dhe më pas me ndihmën e aplikacionit, mesazhi i është kthyer në zë.

“Nuk jam shumë i mirë në përdorimin e protezave zanore”, ka thënë ai, duke prekur vendin ku është bërë operacion në fytin e tij dhe tani është bosh. Proteza, një pajisje e vogël e vendosur në fyt u lejon njerëzve të flasin duke prekur atë me dorë, ashtu që të ketë qarkullim të ajrit dhe të krijohet tingulli. Mirëpo, Gular preferon pajisjen e re teknologjike për zë. Ajo është krijuar për pacientë që humbasin zërin pas largimit të laringut, procedurë me të cilën përballen personat që kanë kancer të fytit.

Projekti i përbashkët i Universitetit të Bohemisë Perëndimore në Pilsen dhe Universiteti i Karlit në Pragë, është realizuar së bashku me dy kompani tjera private dy vjet më parë. Teknologjia përdor incizimet e zërit të pacientëve për të krijuar një fjalim sintetik që mund të përdoret në telefona mobilë, tableta dhe laptopë. Ideale është që pacientët të incizojnë më shumë se 10,000 fjali, në mënyrë që shkencëtarët të kenë material të mjaftueshëm për të prodhuar zërin sintetik. “Ne punojmë me zërat individualë, andaj na duhen shumë fjali”, ka thënë Jindrich Matousek, ekspert që merret me konvertimet tekst-zë, dhe drejton një projekt në Universitetin Pilsen.

“ÇËSHTJE JAVËSH”

Mirëpo, në këtë proces ka edhe disavantazhe, pacientët që përballen me largim të laringut kanë më pak energji për të kryer incizimet për shkak të trajtimit që kërkon kjo sëmundje. “Është zakonisht çështje javësh”, ka thënë Barbora Repova, doktoreshë në Spitalin Motol, e cila punon në projektin e Universitetit të Karlit.

“Pacientët duhet të përballen edhe me çështjet siç është situata ekonomike, jeta e tyre ndërron shumë shpejt kur kuptojnë për sëmundjen dhe gjëja e fundit që dëshirojnë të bëjnë është incizimi i zërit”, ka thënë ajo për AFP-në. Për të adresuar këto vështirësi, shkencëtarët kanë krijuar një tjetër mundësi në aplikacion, që është mbështetur nga Agjencia

për Teknologji në Republikën Çeke.

Duke punuar me më pak fjali, zakonisht 3,500, mirëpo ndonjëherë edhe me 300, kjo metodë përdor modele të avancuara statistikore, siç janë rrjetet artificiale të neuroneve. “Ju përdorni modelet e fjalimeve me parametra të caktuar për të prodhuar fjalim sintetik”, ka thënë Matousek. “Nëse kemi më shumë të dhëna, është më mirë, mirëpo ju mund të arrini kualitet të mirë edhe me më pak të dhëna”.

Këto fjali janë përzgjedhur me kujdes dhe zërat individualë janë incizuar disa herë, pasi fjalitë theksohen ndryshe, qoftë në fillim apo në fund të fjalës përkatëse, ka shtuar ai. Deri më tani, Universiteti Pilsen u ka incizuar zërin 10 deri në 15 pacientëve, sipas Matousek. Përveç gjuhës çeke, shkencëtarët kanë krijuar edhe shembuj në gjuhën angleze, ruse dhe sllovaqe.

“KOMPLIKIMET GJATË INCIZIMIT”

Gular, që aktualisht është i papunë për shkak të sëmundjes, ka incizuar 477 fjali për tre javë, në kohën kur ka kuptuar për sëmundjen e deri tek operimi. Mirëpo, gjatë asaj kohe, ai ka qenë i stresuar dhe nuk është aspak i kënaqur me cilësinë e zërit të tij.

“Pacientët me kancer të fytit zakonisht vuajnë nga të ngjirurit e zërit, andaj në kombinim me mundësi më të paktë për të folur, kjo ndikon që zëri të mos jetë neutral”, ka thënë Repova. Ndërkohë, në një studio në Universitetin Pilsen, sipërmarrësja, Jana Huttova është duke incizuar disa fraza.

Nënë e tre fëmijëve dhe 34-vjeçare, ajo ka humbur zërin e saj pas një intervenimi kirurgjik. “Unë kam fëmijë të vegjël dhe dëshiroj që ata të dëgjojnë zërin tim, jo të një roboti”, ka thënë Huttova.

LIDHSHMËRIA ME TRURIN

Matousek beson se në të ardhmen, pacientët do të jenë në gjendje të përdorin zërin e tyre në shtëpi, duke përdorur një faqe interneti, që do t'i udhëzojë ata për tërë procesin. Madje ai shpreson se një ditë kjo gjë do të bëhet edhe më e madhe. “Versioni përfundimtar është një pajisje tejet e vogël e lidhur me trurin, përkatësisht me nervat që janë përgjegjëse për të folurit, andaj pacientët mund të kontrollojnë pajisjen përmes mendimeve të tyre”, ka thënë ajo. Kjo zgjidhje e avancuar do të kërkojë shumë vjet, ka thënë Repova. “Është reale: mund të mos ndodhë në një vit apo në 10 vjet, mirëpo është e mundshme dhe ne jemi duke punuar në të”, është shprehur ajo.



“Besimtarë të vërtetë
janë vetëm ata,
zemrat e të cilëve,
kur përmendet Allahu,
fërgëllojnë dhe,
kur u lexohen shpalljet e Tij,
u forcohet besimi
dhe vetëm te Zoti i tyre
mbështeten.....”

(Enfal, 2)